

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 396 Nëntor 2023



NAIM EF. TËRNAVA RIZGJIDHET EDHE PËR
NJË MANDAT MYFTI I KOSOVËS

NËNSHKRUESIT E PAVARËSISË SË SHOQPËRISË
DHE UNITETI I QËNDRIMEVE TË TYRE...

STEREOTIPAT E GABUARA RRETH
SHAMISË DHE RRUGËT E EVITIMIT TË TYRE

NAIM EF. TËRNAVA RIZGJIDHET EDHE PËR NJË MANDAT MYFTI I KOSOVËS

Më 21 tetor 2023, Trupi Zgjedhor i Bashkësisë Islame të Kosovës, zgjodhi Naim ef. Tërnavën, kryetar të Bashkësisë Islame – Myfti edhe për një mandat.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë u zgjodh me aklamacion për mandatin e ri në krye të këtij institucionit nga Trupi Zgjedhor, i cili përbëhet nga anëtarët e Kuvendit, kryetarët e këshillave dhe udhëheqësit e institucioneve të BI-së.

Në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi të gjithë për besimin e dhënë dhe për mbështetjen e ofruar në mandatet e kaluara, teksa tha se prioritet në mandatin e ri është edukimi, arsimimi, avancimi dhe fisnikërimi i qytetarëve tonë. “Ndër prioritetet kryesore është edukimi, arsimimi, avancimi dhe fisnikërimi i popullatës sonë për dynja e ahiret, ngritja, zhvillimi dhe avancimi e standardizimi i institucioneve e forumeve tona, në funksion të kërkesave të kohës për të organizuar, përgatitur e mbështetur besimtarët tanë anekënd vendit.”

Myftiu Tërnavë në fjalën e tij po ashtu tha se ka për synim ngritjen profesionale të nëpunësve të BI-së, ruajtjen e besimtarëve nga ekstremizmi, sektarizmi dhe polarizimi i fesë e besimit, e gjithashtu edhe masivizimi i mësim-besimit në të gjithë Kosovën.

Myftiu Tërnavë propozoi dhe më pas u miratuan nga Trupi Zgjedhor tetë anëtarët e Kryesisë: Burhan Hashani – Prishtinë; Shkëlzen Hoxha – Mitrovicë; Musli Arifaj – Pejë; Valon Myrta – Gjakovë; Orhan Bislimaj – Prizren; Sevdair Haxhiu – Ferizaj; Agim Hyseni – Gjilan; Sylejman Fejzullahu – Kosovë Lindore.



- 2 Fjala e Myftiut me rastin e rizgjedhjes së tij për kryetar

EDITORIAL

- 4 Dëlrësia e liridashësve dhe ideali për liri

FETARE

- 7 Atdhedashuria si kërkesë fetaro-islame
Isa Tershani

- 10 Kaptina Jusuf
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

- 14 Mahsheri – Dita e Madhe
Eduart Thartori

- 17 Kërkimi i Zotit sipas metodës së ibrahimit a.s.¹
Enes Kariq

- 20 "Mysliman"
- ç'është kjo?
Hajrudin S. Muja

- 23 Fejesa dhe normat e saj
Nehat Shehu

- 26 E drejta pronësore e gruas dhe burimet e saj
Dr. Ilmije Kuqi

- 30 Natyra juridike e borxhit sipas të drejtës islame
Argjent Xheladini

- 33 Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (2)
Hafir D. Selmani

AKTUALITET

- 38 Gjenocidi ndaj fëmijëve e grave në Gaza në emër të civilizimit bashkëkohor
Mulaim Shehu



FAMILJE & EDUKIM

- 41 Kujdesi i Pejgamberit a.s. për gruan me cikël menstrual
Samire Bilalli

- 44 Stereotipat e gabuara rreth shamisë dhe rrugët e evitimit të tyre
Armida Plumbi

- 48 Transformimi teknologjik i njeriut – transhumanizmi dhe njeriu 2.0
Festim Rizanaj

PERSONALITETE

- 52 Jeta dhe vepra e Imam Kuduriut (v. 428/1037)
Blerton Bahtiri

- 55 Një jetë kushtuar fesë (Islam ef. (Sadik) Pepiq)
Mihana Goga

HISTORI & CIVILIZIM

- 57 Nënshkruesit e pavarësisë së Shqipërisë dhe uniteti i qëndrimeve të tyre në aktin e pavarësisë
Agon Krasniqi

AKTIVITETE

- 66 U konstitua Kuvendi i ri i Bashkësisë Islame të Kosovës



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 396 • viti 37 • Nëntor 2023
• Rebiul-Ahir / Xhumadel-Ula 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.

Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë

Dëlirësia e liridashësve dhe ideali për liri



*“Sa vend i bekuar-
mirë që je e sa i
dashur për mua që je
(oj Meke), dhe sikur
banorët tu të mos më
nxirrnin nga ti, nuk
do të ikja diku tjetër
asnjëherë.”*

(Muhamedi, a.s.)

Etja për liri është e krijuar nga Zoti i Plotfuqishëm në shpirtin e secilit njeri. Ajo nuk lind thjesht vetëm si një nevojë e njeriut për dalje nga robëria, përtej kësaj, ajo buron edhe nga mëria racionale që kemi ndaj atyre njerëzve të cilët shfaqin prirje gllabëruese ndaj trojeve tona, e që kanë pasion nëpërkëmbjen për shpërfilljen e të drejtave tona. Duke qenë një popull që lirinë e ëndërruam gjatë, ne shqiptarët më së miri do të duhej ta kuptojmë vlerën dhe çmimin e lartë që ajo meriton për ta fituar. Epoka e rilindësve shqiptarë, ishte ajo që ka bërë kthesën më të madhe në historinë tonë shqiptare dhe dukshëm që atëherë filloi konsolidimi i mirëfilltë i projektit nacionalist shqiptar. Sigurisht, më vonë edhe u gravura linja që do të shpinte trojet tona drejt mëvetësisimit e sovranitetit.

Kombi, si një projekt politik i të qenët bashkë dhe sovran në vendimmarrje, është ideali që u përvijua mprehtësisht nga rilindësit tanë shqiptarë. Të gjithë ata që erdhën pas tyre, në fakt lëvruan në truallin e ideve dhe projekteve të tyre. Figurat e përndritura patriotike e intelektuale të rilindjes sonë, arritën që idealet për liri t'i shndërronin në një platformë nacionaliste, ku divergjencat fetare apo edhe ato zonale e fisnore të shërbenin thjesht sa për ta qëndisur mozaikun e bukur të një kombi që mëtonte të ecte i mbajtur e në këmbë të veta në rrugën e avancimit e progresit të gjithmbarshëm shoqëror. Idealistët e kombit tonë besuan në kauzën e drejtë për liri, andaj nuk kursyen asgjë për jetësimin e saj. Më 28 nëntor të vitit 1912, ëndrra dhe ideali bëhet realitet. Shqipëria bëhet shtet i mëvetësishtëm dhe shpall pavarësinë e saj. Ata qenë të bindur se liria mbetet sekreti i lumturisë së mbarë kombit tonë, dhe vullneti për ta fituar atë duhet çelikosur mjeshtërisht për të mbetur gjallë gjer në amshim.

Mund të duket absurde linja e analogjisë për dikë, por edhe nëse e kthejmë kokën tonë prapa në historinë e të Dërguarit tonë, Muhamedit a.s., mahnitemi se si ai që i gatshëm të sakrifikoje çdo gjë për hir të lirisë. Lirisë së thënies e përhapjes së të vërtetës. Ai braktisi vendlindjen e tij të shenjtë, Mekën, jo për një jetë komode, luks e rehati, porse aty iu ngulfat fryma e fundit për të kumtuar lirshëm mesazhin hyjnor që e mori nga Zoti i tij. Jo shumë më vonë, u kthye në vendlindjen e shtrenjtë të tij, aty ku të pabesët ia rrëmbyen lirinë, për ta çliruar e për bërë atë sërish një tokë të pëlleshme të lirisë dhe një çerdhe të ngrohtë të fjalës hyjnore. Me një zë dhembshurie e ngushëlles për vetveten, duke u arratisur nga Meka e bekuar pati thënë: “Sa vend i bekuar-mirë që je e sa i dashur për mua që je (oj Meke), dhe sikur banorët tu të mos më nxirrnin nga ti, nuk do të ikja diku tjetër asnjëherë.” Mekën nuk deshi ta braktiste, sigurisht sepse ishte vend i bekuar nga Zoti, por ngaqë aty edhe kishte lindur. I donte edhe kodrat e ngrehinat e thepisura të saj.

E pra, idealistët e liridashësit nuk mund të jenë ndryshe e as nuk mund të dallojnë shumë prej njëri-tjetrit. Ata kanë një mendësi e një motiv gjithandej nëpër botë. Mjetet që zgjedhin për të realizuar ëndrrat e tyre mund të dallojnë, por besimi se kauza e tyre është e shenjtë është skalitur thellë në karakterin e secilit prej tyre.

Diktati poshtërues dhe mizoria e dehumanizuar mbeten ajo hija e zezë që idealistët shpirtëdelirë të çdo populli gjetën guximin për ta flakur dhe ishin tejet të vetëdijshëm se si të çlirohen prej saj. Ata fshihnin një gatishmëri të çuditshme që të harrojnë emrin, trupin e në rastin më tragjik edhe shpirtin e tyre, për të mbijetuar kauza e tyre fisnike. Preferojnë jetën nën dhe, por me lavdi, ndaj asaj mbi të, por të mjeruar e nën mizori. Heronjtë, kudo qofshin ata, nuk u bënë thjesht të tillë pse e derdhën gjakun për tokën e etur për liri, por edhe ngase shpirti i tyre mbajti gjallë shpresat e të shtypurve gjithandej nëpër botë, se mbi këtë tokë ka ende njerëz që ruajnë me zell altruizmin e njerëzinë. Ata, liridashësit e heronjtë e vërtetë pakursyer vënë në shërbim të LIRISË: pasurinë, dijen, djersën dhe jetën e tyre, ani pse, siç do të thoshte Eqrem bej Vlora: “Heronjtë mbesin gjithnjë të keqkuptuar ose martirë të përndjekur padrejtësisht.”

Megjithatë, keqkuptimi i heronjve dhe përndjekja e tyre kudo në botë, janë fakte të gjalla se skena e teatrit të drejtësisë nuk mbaron në këtë botë. Ajo, finalizon drejtësinë në formë të mirëfilltë vetëm në Ditën e Drejtësisë Absolute në Ahiret. Atje na pret i Drejti Absolut.

Kjo për besimdrejtët duket se mjafton.

Mr. Driton Arifi

Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë pas rizgjedhjes në krye të BI-së Kosovës për periudhën 2023-2028

Kërkoj nga ju mbështetje, bashkërendim e koordinim në të gjitha rrafshet ku jemi të angazhuar!

*I nderuari kryetar i Kuvendit të BIK-ut, dr. Ajni ef. Sinani,
Të nderuar anëtarë të Trupit Zgjedhor, kuvendarë, kryetarë
të këshillave të BI-së, drejtues të institucioneve të BIK-ut,*

*Të nderuar anëtarë të deritanishëm të Kryesisë, ju
bashkëpunëtorë të mi,*

*“Thuaji, punoni, se punën tuaj do ta shoh Allahu, i Dërguari
i Tij dhe besimtarët...” (Tevbe, 105).*

Të nderuar të pranishëm!

Më lejoni që t’ju falënderoj për besimin e dhënë për të drejtuar e udhëhequr Bashkësinë Islame të Kosovës edhe për një mandat. Besimi i dhënë nga ju që të jem në mesin tuaj, me ju dhe me gjithë strukturën që është në terren, për mua përveçqë është nder, respekt e vlerësim, për më tepër është së pari amanet e pastaj përgjegjësi para Zotit, besimtarëve e para strukturave të BIK-ut. Me ndihmën e Zotit të Madhërishtëm, me mbështetjen e përkrahjen tuaj, jam i bindur se do ta arsyetojmë plotësisht besimin e dhënë dhe do ta përmbushim misionin që na është besuar, udhëheqjen, qeverisjen, zhvillimin dhe avancimin e Bashkësisë Islame të Kosovës, ku ndër prioritetet kryesore është edukimi, arsimimi, avancimi dhe fisnikërimi i popullatës sonë për dynja e ahiret, ngritja, zhvillimi dhe avancimi e standardizimi i institucioneve e forumeve tona, në funksion të kërkesave të kohës për të organizuar, përgatitur e mbështetur besimtarët tanë anekënd vendit. Bashkësia Islame e Kosovës përgjatë historisë ka ndarë fatin e vet me popullin e vendin, dhe vazhdimisht, me gjithë sfidat e stuhitë me të cilat është përballur, ka arritur të ruajë, plasojë e promovojë misionin e saj. Jemi të përkushtuar që të jemi në nivel të përgjegjësi që na janë besuar, këtë edhe e

kemi dëshmuar katërçipërisht në mandatet paraprake, ku kemi shënuar rezultate të prekshme, konkrete e funksionale.

Më lejoni që të përmendi kalimthi atë që është arritur bashkërisht në periudhën tashmë paraprake,

- kemi sanuar dëmet e luftës,
- kemi ndërtuar xhami në qendrat e vendbanimet ku ka qenë e nevojshme,
- kemi restauruar një sërë xhamish që kanë vlera monumentale, kulturore e historike,
- kemi shtuar vakëfet,
- kemi ngritur infrastrukturë për institucionet administrative të BI-së pothuajse në çdo Këshill.

Rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sistemit arsimor e edukimit. Medreseja tanimë është shkollë e shtrirë në tri qendra të Kosovës, në Prishtinë, Prizren e Gjilan, me klasa për djem e vajza. Fakulteti i Studimeve Islame vazhdon misionin e tij akademik, si në programin bachelor ashtu edhe në atë master e tanimë edhe doktoratë, me kuadrot adekuat e të përgatitur mirë, me rezultate të lakmueshme. Po ashtu rëndësi të veçantë i kemi kushtuar hivzit (mësimi përmendsh të Kuranit) përmes instituteve të hivzit në Prizren e Gjakovë. E veçantë e pesëvjeçarit të kaluar në kuadër të BIK-ut është edhe mësim-besimi nëpër xhamitë e mejtepet anekënd

vendit, ku angazhimi i mualimeve tona është treguar mjaft i suksesshëm dhe rezultatet e arritura janë të kënaqshme, gjë që na obligon që në të ardhmen ta rrisim numrin e mualimeve dhe t’u krijojmë kushte për punë, aty ku është e mundur dhe e nevojshme.

Para dy viteve kemi themeluar Institutin për Hulumtime e Studime Islame (IHSI), institucion



kërkimor e shkencor, i cili do të merret me studimet autoktone dhe tashmë veçse ka dhënë rezultatet e para në fushën e trashëgimisë sonë. Një ndër ndërmarrjet më të mëdha për ne si BIK, s'ka dyshim se është realizimi konkret i projektit të shumëpritur për të gjithë ne, fillimi i punimeve në ndërtimit të Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Arritjet e BIK-ut janë të shumta në çdo pjesë të vendit tonë dhe në të gjitha shtresat e shoqërisë, përse duhen falënderuar të gjithë ata që në çfarëdo mënyre kanë ndihmuar e mbështetur rrugëtimin tonë. Këtu, meritë të veçantë kanë besimtarët tanë të mrekullueshëm, të cilët gjithëherë na janë përgjigjur në thirrjet e aksionet tona, imamët e nëpunësit tanë, që nuk kursejnë asgjë nga vetja që të bëjnë më të mirën për besimtarët e komunitetin. Falënderojmë posaçërisht institucionet tona, të cilat me përgjegjësi e korrektesi kanë bashkëpunuar me Bashkësinë Islame të Kosovës, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Po ashtu, në emër të besimtarëve tanë, të strukturave të BIK-ut dhe në emrin tim, falënderoj të gjithë bamirësitë e donatorët vendor e ndërkombëtar si dhe mërgatën tonë, të cilët na besuan e mbështetën, dhe na përkrahën në vizionin tonë për zhvillimin e rritjen e BIK-ut.

Të nderuar të pranishëm,

Me pak fjalë veçova disa nga të arriturat e BIK-ut deri më tani, ndërsa tani më lejoni që shkurtimisht të theksoj disa nga objektivat ku do të fokusohemi në këtë pesëvjeçar. Rëndësi të veçantë do t'i kushtojmë:

1. Ngritjes profesionale të nëpunësve tanë, duke filluar nga imamët, mualimet, myezinët dhe të gjithë ata që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me besimtarët tanë. Do t'i japim kujdes të veçantë organizimit të kurseve trajnuese dhe programeve të veçanta për ngritjen profesionale.

2. Ngritjes së kapaciteteve të administratës së institucioneve tona.

3. Ruajtjes së besimtarëve tanë, e posaçërisht të rinjve nga ekstremizmi, sektarizmi dhe polarizimi i fesë e besimit;

4. Masivizimit të mësim-besimit gjithandej Kosovës me të gjitha grupmoshat, e në veçanti me grupmoshat e reja;

5. Ruajtjes dhe trajtimin adekuat të trashëgimisë islame, që te ne ka një traditë e histori disa shekulllore;

6. Në bashkëpunim me institucionet, do të angazhohemi që të bëjmë sigurimin shëndetësor të të punësuarve tanë;

7. Ngritjes dhe zhvillimit të vakëfeve si burime ekonomike për funksionimin dhe zhvillimin e BIK-ut;

8. Përgatitjes së literaturës bazike për nevojat e besimtarëve tanë (bibliotekës familjare) në formatin fizik;

9. Realizimit të kërkesave të besimtarëve tanë, si në raport me institucionin tonë, ashtu edhe me ato publike;

10. Bashkëpunimit me institucionet vendore e ndërkombëtare për të realizuar kërkesat dhe nevojat që ka BIK-u dhe besimtarët myslimanë të ne;

11. Ruajtjes dhe kultivimit të unitetit të brendshëm veprues në radhët e Bashkësisë Islame të Kosovës;

12. Bashkëpunimit e bashkërendimit të punëve me bashkësitë simotra në rajon;

13. Kujdesit dhe mbështetjes për qendra tona në diasporë;

14. Bashkëpunimit me bashkësitë e tjera fetare në funksion të mirëkuptimit, tolerancës e harmonisë ndërfaqetare e ndërretnike;

15. Përfundimit të ndërtimit të kompleksit të Xhamisë së Qendrore në Prishtinë, me të cilin projekt vendit do t'i japim një xhami madhështore, reprezentative e përfaqësuese, ndërsa besimtarëve një xhami e kompleks funksional e shumëdimensional.

Për t'i realizuar këto objektiva, kërkoj nga ju mbështetje, bashkërendim e koordinim në të gjitha rrafshet ku jemi të angazhuar, dhe jam i bindur se me ndihmën e Zotit do t'ia dalim.

Të nderuar të pranishëm,

Misioni ynë në këtë botë është që të transmetojmë te njerëzimi mësimet, parimet e konditat hyjnore. Krijuesi i Gjithësisë, Allahu xh.sh., na ka krijuar në formën më të mirë, na ka bërë mëkëmbës në tokë, na ka bërë në fise e popuj që të njihemi mes vete, na ka kërkuar që të jetojmë në paqe e harmoni, pa trazira e konflikte, luftëra e shkatërtime. Kështu na ka urdhëruar feja, këtë e ka kërkuar nga ne Krijuesi i Gjithësisë, kështu na mësoi Muhamedi a.s., i dashuri i Perëndisë dhe ky është misioni ynë si prijës fetarë.

Fatkeqësisht ne në kohën kur po jetojmë, bota po përballet me luftëra, shkatërtime e gjakderdhje, andaj kërkojmë nga të gjithë faktorët që kanë mundësi e ndikim që të angazhohen në ndaljen e luftërave dhe të konflikteve. Është më se domethënëse që të ndalen gjakderdhjet e konfliktet shekulllore në tokën e Palestinës dhe që atje të mbretërojë paqja, siguria e mirëkuptimi. Po ashtu, lutemi e angazhohemi që sa më parë të ndalen luftimet në Ukrainë dhe në të gjitha vatrat e tjera. Njerëzimi ka nevojë për paqe, harmoni, zhvillim të mirëqenies, e jo për konflikte e gjakderdhje.

Duke ju përshëndetur me selam, edhe njëherë ju falënderoj për besimin e dhënë dhe njëherësh ju ftoj të gjithëve që të angazhohemi me përkushtim që bashkërisht të jemi në hyzmet të dinit e imanit, të popullit e vatanit tonë të dashur.

Zoti na ndihmoftë në misionin tonë!

Prishtinë, 21 tetor 2023

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Atdhedashuria si kërkesë fetaro-islame

Isa Tereshani

Dashuria ndaj atdheut është e lindur te njeriu. Ajo është dhunti e Zotit që është e qëndisur në shpirtin dhe zemrën e tij. Kah do që të shkosh përsëri malli për atdheun nuk shuhet asnjëherë.

Feja është domosdoshmëri për njeriun, pasi vetëm nëpërmjet saj arrihet njohja e ekzistencës dhe njëshmërisë së Allahut xh.sh.. Përmes saj arrihet kthjelltësia shpirtërore. Duke vepruar në rrugën e Allahut xh.sh., arrihet virtyti më i lartë moral, arrihet harmonizimi i marrëdhënieve me njerëzit, arrihet ndjenja e përgjegjësisë, interesimi dhe dashuria ndaj të gjitha krijesave.

Feja i drejtohet njeriut për të ndriçuar mendjen e tij. Ajo është e nevojshme për njeriun që ai të jetojë i lumtur dhe i qetë, sepse besimi dhe adhurimi i japin atij qetësi shpirtërore dhe njëherazi forcë për të përballuar jetën. Feja mundëson që njerëzit të jetojnë në paqe, harmoni dhe siguri, sepse ajo ndalon të këqijat dhe padrejtësitë, e ndalon krimin, mërinë, gënjeshttrat e mashtrimet dhe, në anën tjetër, urdhëron për dashuri, respekt, për ndihmë të përbashkët, ndershmëri dhe sjellje të mira mes njerëzve. Feja rregullon

raportet e njeriut me Krijuesin e tij, por njëkohësisht edhe raportet me krijesat rreth tij. Kërkon që njerëzit të shkojnë mirë me njëri-tjetrin, të kenë respekt për të drejtat e njëri-tjetrit dhe këshillon jetesën në paqe. Kështu shoqëria fiton qetësi, siguri dhe lumturi.¹

Andaj, vetëm nga kjo që lexuam, është fare e lehtë të kuptojmë se kjo fe nuk ka ardhur vetëm për çështjen shpirtërore, për të na mësuar se si ta adhurojmë Allahun në shtëpi apo në xhami, se si të falemi e si të agjërojmë, etj., por, para së gjithash, është program i jetës së njeriut që nga lindja e deri në vdekje. Ajo përfshinë dhe menaxhon me çdo segment të jetës së njeriut: edukimin shpirtëror, arsimimin dhe shkencën, edukatën dhe kulturën, artin e politikën, ekonominë e biznesin, martesën dhe jetën bashkëshortore, shitblerjen dhe tregtinë, etj..

Kjo fe, Islami, si faktor i rëndësishëm në shoqëri, nuk ka dyshim se ka edhe platformën e vet hyjnore që ndihmon çdoherë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë së jetës njerëzore. Këtë, Islami e realizon përmes pesë objektivave madhore që ka, e që janë komponentët

*Kjo fe, Islami,
si faktor i
rëndësishëm në
shoqëri, nuk ka
dyshim se ka
edhe
platformën e
vet hyjnore,
që ndihmon
çdoherë në
ruajtjen e
rendit dhe
sigurisë së jetës
njerëzore.*



kryesorë të stabilitetit të një vendi: ruajtjen e jetës, ruajtjen e mendjes, ruajtjen e pasurisë, ruajtjen e nderit dhe ruajtjen e fesë. Pa fe njeriu është i humbur e i devijuar, pa mendje, i çorientuar, pa moral, i lajthitur, pa pasuri, i mjerë, pa jetë, pra pa lirinë, për të nuk mund të paramendohet. Nuk ka dyshim se këto objektiva ndihmojnë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë nëse merren parasysh dhe implementohen me mekanizmat përkatës. Kështu që atdhedashuria dhe fitimi i lirisë, mbrojtja dhe ruajtja e saj është një ndër parimet bazë dhe objektivat themelore të shariatit.

BESIMTARI DHE ATDHEU-VATANI

“Pa një atdhe të lirë feja nuk mbahet, nuk mund të ushtrohet...”² Njeriu është i krijuar që të dojë disa gjëra dhe të favorizojë më shumë se të tjerat. Ai e do pasurinë, fëmijët, familjen, të afërmit, shokët, dhe në mesin e shumë gjërave të tjera, ai e do edhe vatanin³ e tij. Dashuria për vatan-atdhe, është instinkt i mbjellë në shpirt, i cili e bën të qetë njeriun kur qëndron në të dhe mallëngjehet për të kur është jashtë dhe larg tij. Nëse sulmohet e mbron, nëse përbuset hidhërohet.

DASHURIA E MUHAMEDIT A.S. PËR VENDIN E TIJ

Muhamedi a.s., me lot e lëshoi Meken dhe me gëzim të madh u kthye në te. Nëse e shfletojmë historinë e Muhamedit a.s., shohim se mësimet kuranore ngërthejnë në vete vlera të larta morale. Muhamedi a.s. ishte i inspiruar

*Sipas
mësimeve të
fesë islame, çdo
njeri duhet ta
dojë vendin e
vet dhe e ka
për detyrë t'i
dal zot atij në
rast rreziku.
Pra, besimtari i
mirë është edhe
atdhetar i
mirë.*

dhe i edukuar me këto mësimet, gjë të cilën na e vërteton bashkëshortja e tij, Aisheja r.a., e cila kur u pyet për moralin e Muhamedit a.s., u përgjigj: “*Morali i tij ishte Kurani*”. Nga kjo mësojmë se atë që Muhamedi a.s., ia preferonte njerëzimit, atë e praktikonte edhe vetë. Kur në jetën tonë, e marrim si shembull për moral dhe veprimet e tij, Muhamedin a.s., në të njëjtën kohë ne i kemi vënë në zbatim edhe mësimet kuranore.⁴

Kur e lexojmë historinë e hixhretit-migrimit të Pejgamberit a.s., nga Meka në Medinë, kur ai kishte dalë në periferi të Mekës e kishte kthyer kokën edhe njëherë kah Mekja dhe kishte thënë: “Sa vend i bukur që je, sa e dashur më je (Meke)! Sikur populli yt të mos më nxirrnin me dhunë prej teje, kurrë nuk do të kisha banuar diku tjetër.”⁵ Ai pas vendosjes së tij në Medinë, e luste Allahun që ta pajisë me dashuri për të siç qëndron te Buhariu: “O Allahu ynë! Na e bë Medinën të dashur ashtu siç e duam Meken, apo edhe më shumë.”⁶ Pejgamberi a.s. u lut për Medinën që Allahu ta bekojë dhe ta furnizojë me të mira ashtu siç ishte lutur për Meken Ibrahim i a.s.: “*Kur Ibrahim i u lut: “Zoti Im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij...!”* (El Bekare, 126).

Se sa e donte Medinën, vendin e tij, tregon edhe ky rast i rrëfyer nga Enesi r.a., se derisa Muhamedi a.s. po kthehej nga Hajberi dhe e pa Medinën, shikoi kah kodra Uhud dhe tha: “Kjo është një kodër që na do dhe e duam.”⁷



Dashuria për vendin është një çështje e natyrshme të cilën Islami nuk e mohon, mirëpo e përkrah. Krahassaj, ai i obligon pjesëtarët e saj të jenë besnikë dhe të gatshëm për ta ruajtur prapë e shtëpisë me pasurinë dhe jetën e tyre. Islami nxitë çdoherë që besimtari të jetë produktiv dhe i vyeshtë për veten, familjen dhe vendin e tij, që çdo herë të mundohet të avancojë në të gjitha fushat. Se feja i ka kushtuar rëndësi të madhe atdhedashurisë, flet edhe fakti se sakrificën për ta mbrojtur atdheun e ka vlerësuar në shkallën më të lartë, atë të shehidit. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: *“E për ata që u mbytnë në rrugën e Allahut mos thonë: ‘Janë të vdekur’, Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk kuptoni (gjallërinë e tyre).”* (El Bekare, 154). Ndërsa Muhamedi a.s. në një hadith ka thënë: *“Kush lufton për pasurinë e tij është shehid. Kush lufton për nderin e tij është shehid. Kush lufton për familjen e tij është shehid. Kush lufton për fenë e tij është shehid.”*⁸

Angazhimi për lirinë e vendit, përveç që është detyrim kombëtar, është edhe urdhër fetar. Allahu xh.sh. na ka urdhëruar ta mbrojmë, ta duam, ta zhvillojmë dhe ta ndërtojmë vatanin tonë. Pejgamberi ynë i dashur, është shembulli më praktik se si duhet ta duam vendin tonë dhe si duhet të kujdesemi për të. Ai, gjithashtu na ka mësuar e dëshmuar se si duhet të ndërtohen shoqëria dhe shteti. Kujtojmë me këtë rast themelimin dhe ndërtimin e shoqërisë në qytet-shtetin e Medinës, me rregullat, kushtet, ligjet dhe të drejtat e shkruara nga vetë Pejgamberi a.s. në Sahifen apo Kartën e Medinës.

Sipas mësimave të fesë islame, çdo njeri duhet ta dojë vendin e vet dhe e ka për detyrë t'i dal zot atij në rast rreziku. Pra, besimtari i mirë është edhe atdhetar i mirë. Së këndejmi nuk është rastësi që pikërisht nga radhët e ulemasë-dijetarëve shqiptarë myslimanë, kanë dalë atdhetarë të njohur dhe të përkushtuar ndaj atdheut, siç ishin: Haxhi Ymer Prizreni, Haxhi Zeka, Hoxhë Voka, Imam Vehbi Dibra, Hoxhë Kadriu, Mulla Idriz Gjilani, e sa e sa të tjerë që nuk kursyen asgjë për liri. Nuk është rastësi që shumë organizata dhe institucione fetare kanë qenë vatra të organizimit të shqiptarëve në luftën për çlirimin kombëtar.⁹ Këtë rrugë dhe praktikë e ndoqën edhe ulemaja jonë e mëvonshme, edhe prijësit tanë të shquar, këtë rrugë e ndoqën edhe nxënësit, studentët e talebet tona, të cilët, së bashku me strukturat e tjera të shoqërisë sonë, kontribuan fuqishëm për lirinë dhe pavarësinë e vendit, si dhe për ndërtimin e shtetit dhe konsolidimin e tij.¹⁰ Motoja, *“me fe e komb”*, apo, *“me komb e fe”* ishte dhe mbeti përkushtimi i tyre i paluhatshtëm në rrugën e përhapjes së Islamit, por edhe në mbrojtje të të drejtave kombëtare kundër pushtuesve. Kontributi i hoxhallarëve për vatan nuk u ndal kurrë, por ai vazhdoi deri në luftën tonë çlirimtare ku, vetëm në këtë të fundit, në vijat e para të frontit u vranë 36 hoxhallarë.¹¹

SI TA DUAM ATDHEUN?!

Atdheu kërkon prind të mirë, i cili edukon fëmijët e tij në frymë të shëndoshë e në rrugë të drejtë. Kërkon mësues të mirë, i cili edukon nxënësit dhe i mëson në formën më të mirë të mundshme, kërkon punëtor administrate që u kryen shërbime qytetarëve me ndërgjegje të plotë. Kërkon hoxhë, i cili punon natë e ditë për vetëdijesimin e shoqërisë, i lidhë njerëzit me fenë dhe atdheun e tyre duke u shpjeguar atyre rëndësinë e atdheut, ruajtjen e tij dhe kultivimin e vlerave. Kërkon politikan, i cili nuk merr postin për tjetër pos që t'i shërbejë popullit të vet. Kërkon tregtarë e biznesmenë të mirë, të cilët synojnë ta përparojnë vendin e ta zhvillojnë ekonominë. Kërkon gazetarë të mirë, të cilët mbrojnë vlerat e popullit dhe i përhapin ato. Kërkon policë e ushtarë të mirë, që mbrojnë vatanin me dinjitet nga çdo e ligë e mundshme. Kërkon bujk, që punon tokën mirë dhe me vullnet. Pra kërkon një sensibilizim gjithëpopullorë të çdo individi. Dashuria ndaj atdheut nënkupton që interesi i shtetit, pra i atdheut dhe i shoqërisë, të jetë parësor dhe mbi interesat personale.

Mbrojtja e atdheut me pasuri e me trup, është parim i fesë, dhe llogaritet kontribut i shenjtë, i cili gradohet lart dhe shpërblehet shumë nga Zoti xh.sh.. Mu për këtë, sipas mësimave të Islamit, ata që mbyten në rrugë të Zotit, shehidët-dëshmorët nuk vdesin. Nga ana tjetër, sipas mësimave të Islamit tradhtia ndaj atdheut, është ndër mëkatet më të mëdha. Ata që nuk e duan atdheun e tyre, ata që punojnë për të keqen e popullit dhe të vatanit të vet ata nuk i do as Zoti Fuqiplotë, siç ka theksuar Kurani Famëlartë: *“Allahu nuk i do ata që tradhtojnë.”* (El Enfal, 58).

1 *Ilmihal i Zgjeruar*, (Tiranë-Prishtinë-Shkup), 2018. f.16.

2 Dr. Muhamet Piraku, *Mulla Idriz Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës lindore, 1941-1951*, (Prishtinë), 1995. f. 15.

3 Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Vatan-i. ar. Vatan-atdhe; tur. atdhe; vendlindje.

4 Naim Tërnavë, *Moral Islam “Ahlaku” 2*, (Prishtinë), 1996.

5 Tirmidhiu, Sunen Et Tirmidhiu, Rijad, Mektebetu el Mearife, botimi i tretë, 2008. nr. 3926.

6 Buhariu, Sahihu el Buhari, Kajro, Daru el Gadi el Xhedid, 2013. nr. 1889.

7 Buhariu, Sahihu el Buhari, Kajro, Daru el Gadi el Xhedid, 2013. nr. 4083.

8 Tirmidhiu, Sunen Et Tirmidhiu, Rijad, Mektebetu el Mearife, botimi i tretë. 2008. 1421.

9 Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, *Feja, Kultura dhe tradita islame ndër Shqiptarët*, (Simpozium ndërkombëtar) Prishtinë, 1995. f. 534.

10 Naim Tërnavë, *Ligjërime për fenë e atdheut, fjalime, hytbe, urime, deklarata, intervista*. (3) Prishtinë, 2023.

11 Shih monografinë: *Imamët dëshmorë në luftën e fundit në Kosovë*, 1989-1999.

Kaptina Jusuf

FAMILJA DHE RËNDËSIA E SAJ NË NDËRTIMIN PSIKOLOGJIK TË INDIVIDIT

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Ky është njëri nga tregimet më të shkëlqyera, sepse ka të bëjë me faza të ndryshme të jetës së profetit Jusuf a.s.

Kaptina Jusuf, e përbërë nga 111 versete, është një prej kaptinave të zbritura në Meke, të cilat parashtrojnë fragmente nga ngjarjet e pejgamberëve. Kjo kaptinë, sikur që mban emrin e Jusufit a.s., edhe i tërë tregimi në të i është kushtuar jetës së tij, vështirësive që përjetoi ai dhe babai i tij, mundimeve nga vëllezërit, jeta në shtëpinë e zotërisë së Egjiptit, aventurat e grave, sprova me burgim etj., derisa e shpëtoi Zoti xh.sh.. Andaj ky është njëri nga tregimet më të shkëlqyera, sepse ka të bëjë me faza të ndryshme të jetës së profetit Jusuf a.s., siç janë sprovat e mundimet, prej sprovave të ndarjes deri te bashkimi, prej mërziisë dhe brengës deri te gëzimi, prej asgjësë deri te pasurimi, prej nënçmimit deri te lartësimi, prej robërisë deri te mbretëria, prej vështirësive deri te lehtësimet, prej demantimeve deri te vërtetimet. Kaptina përmban një trajtim të posaçëm të shprehjeve dhe të domethënies së saj, sepse rrëfimi i ngjarjes në një mënyrë të butë e të dhimbshme

depërton thellë në ndjenjat shpirtërore. Edhe pse është nga kaptinat mekase, të cilat në shumtën e rasteve kanë natyrë kërcënimi e tërheqjeje të vërejtjes, kjo është e dalluar sepse ka një atmosferë mëshire, butësie e përkëdheljeje.

LIDHMËRIA E KËSAJ KAPTINE ME KAPTINËN PARAPRAKE DHE ATË PAS SAJ

Kaptina Jusuf përmban një lidhmëri të ngushtë me kaptinat para dhe pas saj në renditjen kuranore. Lidhmëria e saj me kaptinën paraprake, kaptinën Hud, kuptohet nga fakti se në përmbajtjen e kaptinës paraprake si tematikë e përgjithshme është sqarimi mbi jetën dhe veprimtarinë e disa pejgamberëve, si të Nuhut, Hudit, Salihut, Lutit, Shuajbit e Musait. Aty parashtrohen tregime për jetën dhe veprimtarinë e pejgamberëve, për vuajtjet dhe vështirësitë që përjetuan ata gjatë kryerjes së detyrës së tyre.



Kaptina përfundon me qëllimin e rrëfimit të jetës së vëllezërve pejgamberë, që ishin para Muhamedit a.s., e duke u drejtuar me urdhra, udhëzime e këshillime Muhamedit a.s. dhe ymetit të tij. Në kaptinën Hud, pas sqarimit mbi tregimin e Nuhut a.s. thuhet: *“Këto janë disa nga rrëfimet e panjohura (për ty), që po t’i shpallim ty, e që para këtij (Kuranit) nuk i ke ditur, as ti, as populli yt. Pra, të jesh i durueshëm, se përfundimi (i lavdishëm) është për të devotshmit.”*¹ Ndërsa në kaptinën Jusuf, në këtë kontekst si plotësim i saj thuhet: *“Këto janë nga ato lajme të panjohura, e Ne po t’i shpallim ty (Muhamed), se ti nuk ke qenë pranë tyre kur ata vendosën çështjen e tyre (hedhjen e Jusufit në bunar etj.) dhe kur bënin dredhi.”*²

Lidhmëria e kaptinës Jusuf me kaptinën Rad është evidente në faktin se të dy kaptinat përmbajnë argumente mbi Njeshmërinë e Zotit, që është parim themelor i besimit. Përderisa në kaptinën Jusuf rrëfëhet për thirrjen në Njeshmërinë e Zotit nga Jusufi përgjatë qëndrimit të tij në burg përpara se të interpretonte ëndrrat e dy shokëve të burgut, në kaptinën Rad, sjell argumente mbi njësinë e Zotit, për shpalljen, për ringjalljen dhe për shpërblimin dhe dënimin. Për argument të besimit në fuqinë e Zotit përmend qiejt, tokën, hënë, natën, ditën, bimët, pemët dhe krijesat e tjera.

RELACIONI FAMILJAR NË KAPTINËN JUSUF

Një nga metodat dhe mekanizmat kryesorë që ka përdorur Kurani famëlartë për realizimin e objektivave të tij është edhe metoda e tregimeve. Stili kuranor i tregimeve është metodë mjaft atraktive në shprehjen e asaj që përfshin, që nga ngjarjet e ndryshme, faktet, personalitetet, si dhe shembujt nga krijesat e tjera, duke kontribuar kështu në plasimin e vlerave si dhe konsolidimin e tyre. Tregimet arrijnë të zgjojnë vëmendjen e lexuesit-dëgjuesit, sidomos për faktin se natyrshmëria njerëzore karakterizohet nga veçoria e tendencës së pasimit të pozicioneve dhe ngjarjeve në tregime, duke synuar të arrijë njohjen e epilogut përfundimtar të tyre. Stili i përdorur gjatë rrëfimit të historisë së Jusufit në kaptinën Jusuf, mënyra se si paraqitet ngjarja, gjuha e përdorur në pyetjet dhe përgjigjet, janë mjaft atraktive në paraqitjen dhe shtjellimin e gjendjes psikologjike të personazheve dhe epilogun e tyre.

Rrëfimi në detaje i ngjarjes së Jusufit, babait dhe vëllezërve të tij në këtë kaptinë fillon me ëndrrën e parë nga Jusufi se sikur dielli, hëna

dhe njëmbëdhjetë yje i bënë sexhde, i përuleshin atij. Për këtë i tregoi babait të vet, Jakubit a.s., por ai e këshilloi që ëndrrën të mos ia tregojë vëllezërve, sepse do të mund t’i bënë ndonjë të keqe. Jusufi u habit, si mund t’i bënë keq vëllezërit? Por Jakubi i sprovuar i tha se duhet ta dijë që shejtani është armik i përbetuar i njeriut, e mund t’i mashtrojë edhe vëllezërit e tij. Gjatë përshkrimit të ëndrrës së tij, ai fillon me një pasthirmë që shpreh dashurinë duke thënë: *“O babai im, unë pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin e hënë, i pashë duke më bërë mua sexhde!”*³ Kjo, tregon për marrëdhënien e ndërsjellë të familjes së Jakubit a.s., dashurinë dhe respektin e fëmijëve të tij, kushtimisht të Jusufit për babanë e tij. Përgjigja e dhënë nga Jakubi a.s. pas rrëfimit të ëndrrës nga i biri tregon se e njëjta dashuri ekziston në familje në mënyrë të ndërsjellë: *“O biri im, mos ia trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu.”*⁴ Stili i përdorur gjatë rrëfimit të ëndrrës ashtu siç paraqet dashurinë midis Jusufit dhe babait të tij po ashtu shpreh marrëdhëniet midis Jusufit dhe vëllezërve të tij. Duke qenë se Jakubi a.s. e donte Jusufin dhe vëllain e tij Bunjaminin – që e kishte vëlla edhe prej nëne – djalli ua mbushi mendjen vëllezërve të tjerë që ta likuidojnë Jusufin a.s., e pastaj të pendohen e të bëhen njerëz të mirë.⁵ Rrëfimi ashtu siç sjell një peizazh të përgjithshëm të psikologjisë familjare për të gjithë njerëzit, thekson se ngjarje të ngjashme mund të jenë të zakonshme sikur te njerëzit e rëndomtë edhe në familje të një pejgamberi siç ishte Jakubi a.s.. Edhe pse ata iu betuan babait të tyre se e duan dhe do të kenë kujdes për Jusufin a.s., nga zilia e hodhën atë në pus, por ndihma e Zotit ishte aty, e dërgoi Xhibrilin t’ia qetësojë shpirtin, t’ia largojë frikën e vetmisë dhe e lajmëroi se do të jetë i shpëtuar prej kësaj fatkeqësie.⁶

Sado që Jakubi a.s. u shprehi shqetësimin se nuk mund ta linte Jusufin me ta dhe se frikësohej për të nga ujku, ata iu betuan se do të kenë kujdes ashtu që ai ua lejoi ta marrin atë. Këtu haptas vërehet një shqetësim psikologjik për Jakubin a.s., ngase përderisa Jusufi, i cili u rrit në të njëjtën edukatë me vëllezërit e tij shprehte respekt dhe dashuri ndaj babait, vëllezërit e tij nuk vepronin me të njëjtën ndjeshmëri. Pasi morën Jusufin me vete dhe e hodhën në pus, ata duke vazhduar në zili dhe për ta fshehur sado kudo gabimin e tyre, pasi ra muzgu erdhën kinse duke qarë dhe me këmishë të përgjakur, por Jakubi e kuptoi çështjen dhe iu mbështet Zotit për ndihmë. Megjithatë, toni i zërit, mënyra e të

*Edhe pse
Jakubi a.s. ishte
një baba i
zhgënjyer nga
bijtë, si dhe
Jusufi një vëlla
i përndjekur
nga vëllezërit e
tij, ata me
qëndrimet e
tyre vënë në
pah ndjenjën e
tolerancës,
mëshirës dhe
dhembshurisë
familjare.*

shprehurit dhe devijimi i fjalëve nga drejtimi i përgjithshëm nxori në pah josingëritetin e tyre në atë që thanë. Ata duke iu bindur intrigave të djallit u shndërruan në njerëz labilë, ziliqarë, të kompleksuar, pa ndjenja, gënjeshtarë dhe të përgatitur për dredhi të llojit më të rëndë. Po ashtu tablo sjellë një pasqyrim mbi ndjenjën e mosbesimit brenda familjes të shkaktuar nga ndjenjat negative psikologjike dhe kulmin e gjithë kësaj me përgjigjen profetike të Jakubit a.s.: “Ai tha: “Jo (nuk e ka ngrënë ujku), por epshet tuaja ua hijeshuan punën. Halli im është: durim i mirë. Allahu është nga i cili kërkohet ndihmë për këtë që përshkruani ju.”” Dhe kështu Jusufi i hedhur në pus nga vëllezërit e tij u gjet nga një grup tregtarësh të cilët kaluan atypari, e zotëruan atë sikurse të ishte rob i tyre dhe e shitën me të shpejtë, duke u frikësuar se po lajmërohet zotëria i tij. Jusufin e mori ministri i ekonomisë së Egjiptit, i cili i tha gruas së vet të kujdesej mirë për të ngase mund të kenë dobi prej tij, ose meqë nuk kishin fëmijë, ta birësonin si djalë të vetin. Në të vërtetë ka një urtësi të madhe në këtë çështje, ngase po të kishin përcaktuar një çmim të lartë për të dhe po të kishin kuptuar se ai ishte një personalitet i zgjedhur, një profet, ata do të dëshironin ta dëmtonin atë. Ngjashëm, jobesimtarët e tjerë të cilët do të dëgjonin për këtë gjithashtu do të dëshironin t'i shkaktonin ndonjë të keqe atij. Fakti se ata e nënvlerësuan atë dhe e shitën si rob duke shpresuar një përfitim material shkoi në favor të tij, pra ndihma e Zotit dhe mbrojtja e Tij nuk i mungoi në asnjë rast.

Rrëfimi në kaptinë vazhdon me pasqyrimin e mëshirës, e cila është ndër cilësitë e Allahut të Lartësuar, me dimensione të tjera, e reflektuar te të dërguarit e tij, kushtimisht te Jakubi a.s. dhe i biri i tij Jusufi a.s.. Edhe pse Jakubi a.s. ishte një baba i zhgënjyer nga bijtë, si dhe Jusufi një vëlla i përndjekur nga vëllezërit e tij, ata me qëndrimet e tyre vënë në pah ndjenjën e tolerancës, mëshirës dhe dhembshurisë familjare. Thuhet se vendin e Jakubit e kishte kapluar një thatësi e madhe e skamje, prandaj bijtë e tij shkuan në Egjipt për të blerë ushqim. Me t'u takuar, edhe pse Jusufi a.s. i njihte shumë mirë, ata nuk e kishin idenë më të vogël se kush ishte ai.⁸ Jusufi i priti mirë e iu dha drithë për kokë të çdonjërit, por i porositi t'ia sillnin edhe vëllain e vogël, që t'u japë drithë edhe për të. Jusufi a.s. nuk u hakmor ndaj vëllezërve të tij, përkundër asaj që i kishin shkaktuar. Pa e vërejtur ata, ai ua ktheu edhe mallin që kishin sjellë si

*Rrëfimi në
detaje i
ngjarjes së
Jusufit, babait
dhe vëllezërve
të tij, aq sa
tregon gjendjen
psikologjike të
personazheve,
po aq është
edhe një
argument se
Jakubi a.s. ishte
një prind i
mirë dhe se
Jusufi a.s. ishte
shembull dhe
model i
suksesshëm,
fjalët dhe veprat
e të cilit ishin
të shkrira në
njëra-tjetrën.*

kompensim për drithin, e bëri këtë me qëllim që të kthehen përsëri, sepse Jakubi nuk do të hante drithin që nuk ishte paguar, e kështu do t'ia sillnin edhe vëllain. Duke tërhequr vëmendjen me inteligjencën e tij, Jusufi a.s. fitoi zemrat e vëllezërve të tij dhe i bindi që të ia sillnin Bunjaminin me pëlqimin e tyre pa e dëmtuar atë. Pasi vëllezërit i treguan Jakubit a.s. për kërkesën e përgjegjësit të depove dhe iu betuan atij në Allahun, se nuk do të i bëjnë ndonjë dredhi, Jakubi a.s. i lejoi ta merrnin edhe Bunjaminin duke i këshilluar: “O bijtë e mi, mos hyni (në Egjipt) për një derë, po hyni nëpër dyer të ndryshme.”⁹ Pavarësisht çdo gjëje, Jakubi, si baba, tregoi dashurinë dhe dhembshurinë për fëmijët e tij duke i këshilluar ata që të mos hyjnë të gjithë nga një derë, sepse mund t'i shihte ndonjë qëllimkeq.¹⁰ Kjo mëshirë dhe dashuri e shprehur nga Jakubi nuk ishte e cekët sa të përfshinte vetëm jetën e kësaj bote. Aq sa i këshilloi bijtë e tij të jenë të kujdesshëm dhe të marrin masa paraprake përballë fatit të kësaj bote. Ai menjëherë shprehi dorëzimin te Zoti, Krijuesi i çdo gjëje, se nuk mund t'u ndodhte asnjë send pa caktimin e Tij, duke u thënë: “Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i Allahut, vendimi nuk është i tjetërkujt vetëm i Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t'i mbështeten ata që besuan.”¹¹ Pos të tjerash, në këtë verset jepet mesazhi që dhembshuria prindërore nuk duhet të kufizohet vetëm me këtë botë, por prindi duhet të këshillojë fëmijët e tij dhe për ahiretin. Verseti aq sa thekson rëndësinë e lumturisë dhe bashkimit familjar, po aq potencon dëmet e ngecjes në ngjarje të kaluara dhe afrimit me mëri dhe urrejtje ndaj pjesëtarëve të familjes. Njashtu

shpreh faktin se besimi dhe bindja në caktimin e Zotit të Lartësuar janë nga çështjet fundamentale për ruajtjen dhe lumturinë e familjes si në këtë botë ashtu edhe në botën e pastajme.

Bindja dhe dëgjueshmëria që kësaj radhe treguan vëllezërit e Jusufit ndaj babait të tyre, shprehet në këtë mënyrë: “Dhe ata hynë ashtu si i porositi babai i tyre.”¹² Kur hynë te Jusufi a.s., ai i vendosi nga dy veta në një dhomë si mysafirë, e pasi Bunjamini mbeti vetëm, ai e mori me vete në dhomën e tij. Aty i tregoi se ishte Jusufi, i tregoi për planin e vet dhe i tha të mos tronditet për rrjedhën e ngjarjeve. Dashuria dhe



dhembshuria të cilën Jakubi a.s. mbolli te bijtë e tij, reflektoi në çastin kur Jusufi vendosi të mbante vëllain e vogël për të cilin i urdhëroi shërbëtorët që kupën e vet të stolitur me diamante ta vënë në barrën e tij pa i hetuar kush. Pasi publikuan se dikush e ka marrë kupën e sunduesit, kërkuar mendim prej tyre për masën ndëshkuese që duhet të merrnin tek ai që gjendet. Jusufi e bëri këtë me qëllim, sepse sipas ligjit të mbretit, të cilin Jusufi e kishte parasysh, vjedhësi mbetej rob i të zotit të sendit të vjedhur, e Jusufi këtë kishte për qëllim.¹³ Ata duke shprehur sinjeritetin dhe dhembshurinë ndaj babait plak, Jakubit a.s. thanë: “O zotëri, ai ka një baba shumë të vjetër, pra, në vend të tij merr njërin prej nesh. Bëje këtë të mirë, se ti je prej atyre që bëjnë mirë!”¹⁴ Kjo është arritja e Jakubit si baba dhe si njeri, i cili pavarësisht gabimeve të djemve të tij me mëshirë dhe dhembshuri vendosi rendin në familje. Edhe Jusufi a.s. si një i përzgjedhur i Zotit, sikurse babai i tij karshi vëllezërve, shpreh të njëjtën dhembshuri duke qenë dorëlibër ndaj tyre. Pasi Jakubi a.s. u tha djemve të shkojnë sërish në Egjipt dhe të hulumtojnë edhe për Jusufin, vajtën dhe hynë te Jusufi, e lutën të u japë dritë për një mall të dobët që kishin sjellë. Ata po ashtu kërkuar që t’ua lirojë edhe vëllain, me që ai, duke mos ndjerë asnjë dëshirë hakmarrjeje apo armiqësie ndaj tyre¹⁵ prezantoi vetën e tij. Vëllezërit u shokuan, kishte kaluar kohë e gjatë dhe nuk paramendonin që ta gjenin atë diku fare, e le më në ndonjë pozitë si ajo që kishte Jusufi a.s., prandaj i thanë: “Vërtet, ti je Jusufi?” Kurse ai megjithëse ua përmendi gjestin e tyre të shëmtuar, nuk i qortoi, përkundrazi u lut që të i falë Zoti: “Ata thanë: “Për Allahun, është e vërtetë, se Allahu të ka lartësuar mbi ne, kurse ne vërtet ishim fajtorë!” Ai tha: “Sot nuk ka

qortim kundër jush, Allahu ju faltë juve; Ai është më i Mëshirshmi ndër mëshiruesit!”¹⁶

Rrëfimi në detaje i ngjarjes së Jusufit, babait dhe vëllezërve të tij, aq sa tregon gjendjen psikologjike të personazheve, po aq është edhe një argument se Jakubi a.s. ishte një prind i mirë dhe se Jusufi a.s. ishte shembull dhe model i suksesshëm, fjalët dhe veprat e të cilit ishin të shkrira në njëra-tjetrën. Jusufi ishte ai që njihej për bukurinë, moralin si dhe me aftësitë e tij. Rrëfimi i tij nisi nga prehri i babait gjer në pus, nga pusi në saraj, nga saraji në burg e më në fund pasi vërtetohet drejtësia dhe maturia e tij arriti të bëhet përgjegjës i depove të mbretërisë. Kjo ishte mëshirë e Zotit të Madhëruar, që ia dhuron atij që do, e dhurata më e madhe e Tij është ndihma ndaj njeriut që ai ta besojë, t’i respektojë urdhrat e Tij, e më në fund ta përjetojë shpërblimin e madh në jetën tjetër.

1 Hud, 11/49.

2 Jusuf, 12/102; Es Sekafi, *Tenasubi's-Suveri'l-Kur'an*, fq. 115.

3 Jusuf, 12/4.

4 Jusuf, 12/5.

5 Semerkandi, *Bahru'l-Ulum*, II/178.

6 Taberi, *Xhamiu'l-Bejan*, XIII/13.

7 Jusuf, 12/18.

8 Mevdudi, *Tefhimu'l-Kur'an*, II/445.

9 Jusuf 12/67.

10 Taberi, *Xhamiu'l-Bejan*, II/244.

11 Jusuf, 12/67.

12 Jusuf, 12/68.

13 Mevdudi, *Tefhimu'l-Kur'an*, II/477.

14 Jusuf, 12/78.

15 Kurtubi, *el-Xhamiu li Ahkami'l-Kur'an*, III/17.

16 Jusuf, 12/91-92.

Mahsheri – Dita e Madhe

VENDI I TUBIMIT TË PËRGJITHSHËM

Eduart Thartori

Tashmë të gjithë jemi në një fushë të madhe. Edhe unë edhe ti.

Po dalim të gjithë nga varri. Atëherë të gjithë do të habitemi. Madje edhe besimtarët do të habiten. Ata i kanë besuar të gjitha çfarë Zoti u tha për këtë ditë. Por nuk e kishin provuar vetë, “live”. Nuk e kishin provuar se si është të dalësh nga dheu, e të pastrosh trupin prej dheut. Nuk e kishin provuar se si është të të formohet përsëri trupi që ke pasur. Pasi ka qenë tretur për shekuj me radhë në dhe.

Dal unë, del edhe ti, edhe ai tjetri. Shpejt gjithë ajo fushë e madhe, mbushet me njerëz që sapo kanë mbirë nga dheu. Ti dhe unë jemi njëri nga miliarda e miliarda qenie njerëzore që sapo kanë mbirë nga toka. Tamam si ato fijet e grurit, kur pasi e ke hedhur farën në tokë, nisin të çajnë dheun. Ky proces në bujqësi zgjat me javë. Nga koha kur toka është e kaftë, e deri kur prej saj dalin fije-fije filizat e parë të grurit. Derisa krejt toka të bëhet e blertë.

Aty pranë teje do të dalë edhe bashkëshortja jote, pak më tej edhe fëmijët, edhe prindërit. Por ata duket sikur nuk kanë asnjë lidhje me ty. Secili habitet me veten e tij. Nuk po të njohin. Pret t’i takosh, por secili është i zënë me hallet e veta.

Pastaj sheh se ajo masë e madhe të ringjallurish, kanë marrë një drejtim. Pa vetëdije të gjithë ecin. Ecin drejt fushës së madhe të Mahsherit. Vendit ku grumbullohen të gjithë.

Disa njerëz ecin duke u habitur për trupin e tyre. Shohin se si në gjymtyrët e tyre ka dritë. Ajo buron nga vetë mishi i tyre. Nga fytyra e

tyre. Është vendi ku i prekte uji i abdesit përditë. Sot ai abdes po ua ndriçon fytyrën.¹

Nga ana tjetër sheh disa njerëz me fytyra të errëta, janë në hall të madh. E kuptojnë se kjo ditë është e tmerrshme për ta. Disa të tjerë qajnë me të madhe, duke thënë: “Ah, na patën thënë peygamberët për këtë ditë. Por nuk u besuam...!”

Atë ditë do të ketë edhe fytyra të nxira. Të tmerruara. Ata janë jobesimtarët, të ligjtë...²

Tashmë të gjithë jemi në një fushë të madhe. Edhe unë edhe ti. Edhe ai apo ajo, që ecnin me eskortë dhe që mund ta shikojë vetëm në televizor. Sot nuk ka më VIP-a. Të gjithë do të jenë aty. Po po, aty dhe të gjithë lakuriq. Si herën e parë kur lindën. Nuk ka më tituj, nuk ka më doktorë shkencash dhe as shkëlqesi. Të gjithë janë aty, duke pritur çfarë do të ndodhë me ta. Askush nuk di asgjë. Askush nuk mund të thotë diçka. Janë të gjithë lakuriq, burra dhe gra. Por askush nuk e ka mendjen të shoh tjetrin. Të gjithë kanë hallet e veta.³

Disa janë të qetë, disa janë të tmerruar. Disa kokën e mbajnë ulur me frikë. Disa i kthejnë sytë lart nga qielli.

VIJNË LIBRAT

Pastaj një fenomen i habitshëm ndodh. Një turmë e madhe zogjsh që po vjen drejt tyre. Po vijnë shpejt dhe po ulen mbi ta. Nuk qenkan zogj, por qenkan libra. Disa libri u vjen lehtë dhe butësisht në anën e djathtë dhe ata e presin. Është i ndriçuar. Ata e shfletojnë dhe lumturohen. Është libri i veprave të tyre. E

shohin të habitur. Shumë kapituj aty kanë marrë notën: I FALUR... I FALUR... I FALUR...

Janë mëkatet e tyre që janë falur. Disa kapituj kanë marrë notën, SHKËLQYESHËM... I PRANUAR... MIRNJOHJE...

Janë të mirat që bënë. Agjërimet, namazet, sadakatë dhe fjalët e mira që thanë. Janë aty të vërtetat që mbrojtën me gjakun e tyre. Janë aty edhe vitet e burgut që bënë, padrejtësisht. Janë aty edhe lotët e nënave që humbën fëmijët e tyre. Janë aty edhe kamxhikët që provuan në rrugën e Zotit. Janë aty edhe përbuzjet që provuan pse ishin besimtarë. Pse mbanin shaminë apo pse mbanin mjekër.

Hej, shikoni librin tim! - Thërrasin të lumturuar.⁴

Por ka edhe të tjerë që nuk janë si ata. Atyre libri u ka ardhur në krahun e majtë. Libri i tyre është i errët. Kanë frikë ta hapin. Kushedi sa e sa maskarallëqe ka aty. A thua do të jenë shënuar të gjitha? Nisin ta shfletojnë. Ato janë aty të gjitha. Koha kur ka vlarë një zog të vogël pa mëshirë, atëherë kur ishte akoma një djalë i ri. Koha kur ia nxu jetën gruas sa ishin të martuar. Koha kur u bë financier banke dhe vodhi shumë para. Ai tjetri po sheh se si janë shënuar vendimet gjyqësore që ai ka marrë kur ishte gjykatës. Po sheh se si e futi në burg atë fukaranë, thjesht se i duhej një njeri në burg, për të shpëtuar atë politikanin që vërtet i kishte bërë ato krime.

Edhe ai mohuesi që thoshte se Zoti nuk ekziston, edhe ai po e shfleton librin e tij. Kush pra, kush ma solli këtë libër? Kush më ringjalli? Kush më solli këtu? Ah i mjeri unë, të kisha besuar atëherë kur të gjithë njerëzit besuan. Por sot nuk e di nga t'ia mbajë. Fillon të shikojë shiritin e jetës së vet. Të gjitha horrlëqet që ka bërë, tradhtitë, dallaveret, vjedhjet, kamatën. Sa shumë që është lodhur për t'i fituar ato para të shkreta. Po sot, ku janë? Si ka mundësi që të jem mashtruar kaq keq? A ia vlejti tani? Gjithë ajo garë e madhe për pushtet, famë e pasuri. Gjithë mashtrimet, premtimet, korrupsioni... A ia vlejti sot?

Sot është koha e shpagimit. Sot nuk ka as gjykata, dhe as pushtet që të mbrohet. Të gjithë kanë hallet e veta.

Por më keq, do ta kenë disa të tjerë. Ata që me dijen e tyre u shërbyen zullumqarëve. Ata që justifikonin zullumet e tyre, duke dredhuar ajetet e Kuranit. Ata që justifikonin zullumqarët me bindje të plotë. E për çfarë? Për karrigen e ngrohtë të rektorit të Universitetit, apo të kryetarit të Komunitetit, apo ndoshta edhe për një zarf të mbushur me para? Dje llogaria ishte: Më mirë me zullumqarin, sesa

kundër zullumqarit. Por sot? Ku do ta gjeje shefin e tij, zullumqar? Nuk është shumë larg tij në fakt. Diku më tej, duke vajtuar për hallet e veta. Shkon tek ai, që t'ia ndihmojë pak. Por ai e përzë, duke i thënë: Zhduku se kam hallet e mia.

Disa të tjerë, akoma po presin. I dinë krimet e veta dhe nuk shpresojnë asgjë të mirë. Duart i kanë pas shpinës, se e dinë që libri do t'u zbresë në dorë. Por libri nuk gabon të zotin e vet. Librat e tyre të ndyrësirave, u përplasen mbi shpinë. Nuk shpëtojnë dot. Edhe ata do ta marrin librin e tyre. Por çfarë të lexojnë? Ai ishte prokurori që ka dënuar me vdekje dhjetëra burra dhe gra të pafajshëm. Ai ka ndarë nënën nga fëmija. Ai ka bërë gjenocid mbi njerëz të pambrojtur. Madje ai kënaqej kur shikonte krijesën e gjallë të vuante prej tij. Sot është koha e shpagimit dhe ai, e di mirë këtë.

DIELLI MBI KOKË

Papritur skena ndriçohet. Dielli po afrohet mbi kokat e njerëzve. Aty janë me miliarda njerëz, të gjithë duke vuajtur në nxehtësinë e tij. Fillon djersa të kullojë. Nuk po flasim për ballin e lagur. Por nga djersa e tyre, nis të bëhet baltë, në këmbët e tyre. Pastaj pak nga pak, po bëhet pellg me ujë. Pastaj uji ngrihet më shumë, derisa nisin të notojnë në djersën e tyre. Disa gati sa nuk mbyten me djersët e tyre. Skena të tmerrshme, sikur të një anijeje të mbytur... Gjithsesi është vetëm fillimi dhe kjo është vërtet shumë pak, nga ajo që i pret ata...

VETËM NJË DITË

Do të jetë vetëm një ditë. Por jo një ditë, si gjithë ditët e tjera. Ajo është një ditë që llogaritet sa 50.000 vjet me ditët e kësaj bote. Aq sa njerëzit dëshpërohen në pritje, lodhen, frikësohen për çfarë i pret dhe ata akoma nuk e kanë parë zjarrin. Disa kanë nisur të bëjnë llogaritë. Sa qëndruam në atë botë? Pyesin njëri-tjetrin. Disa thonë një ditë të vetme si kjo. Janë brezat që kanë jetuar në këtë botë. Disa thonë vetëm një pjesë të saj. Disa madje do të thonë se gjithçka kaluam në atë jetë, ishin thjesht disa orë.⁵

Të gjitha për çka luftuam dhe harxhuam jetën tonë, ishin vetëm për disa çaste që shijuar. E gjitha, a ia vlejti?

Aty në atë fushë të madhe të Mahsherit, disa prej njerëzve do të jenë të qetë. Do të jenë në hijen e Arshit të Allahut. Ndërkohë që pjesa tjetër do të jenë duke u munduar nën tmerrin e diellit mbi kryet e tyre. Këta do të jenë në një vend të lartë, të freskët. Ata janë të zgjedhurit e Allahut të



Madhëruar. Për ta nuk do të ketë mundime të tilla. Janë ata njerëz që ishin dashuruar me xhaminë. Ata që duheshin me njëri-tjetrin për hatrin e Allahut. Janë ata që refuzuan tundimet dhe jetuan një jetë të ndershme. E shumë të tjerë që vetëm Allahu i njeh dhe i ka zgjedhur, për atë ditë, të jenë nën hijen e Arshit të Vet.⁶

SHEFATI

Do të qëndrojmë të gjithë aty duke pritur. Nga mundimi i madh i pritjes, njerëzit do të qajnë derisa lotët t'i shterojnë. Pastaj do qajnë me gjak. Të gjithë duan vetëm diçka. Gjykimi të fillojë. Madje edhe zullumqarët, që e dinë se nuk kanë shpëtim, duan të nisë gjykimi sa më shpejt. Të gjithë duan vetëm të mbarojë kjo fazë. Le të shkojnë në zjarr, vetëm nga aty të largohen. Është shumë e lodhshme dhe e mundimshme. Por ajo fazë nuk mbaron. Njerëzit shkojnë tek Ademi a.s., njeriu i parë. I kërkojnë atij të ndërmjetësojë te Zoti, që ta nisë gjykimin. Por ai refuzon për shkak të lëshimit të tij. Shkojnë pastaj te Nuhu, tek Ibrahim, te Musai dhe te Isai a.s., por të gjithë refuzojnë. Sepse të gjithë kanë nga një kleçkë të vogël në biografi. Edhe pse të gjitha ato janë të falura dhe të pastruara. Por të gjithë kanë frikë. Deri kur shkojnë tek i dashuri i Allahut, Muhamedi a.s.. Ai e merr përsipër dhe shkon i vetëm para Arshit të Allahut. Aty ai bie në

sexhde dhe qëndron ashtu pa lëvizur. Derisa Allahu dërgon një engjëll dhe e ngre atë nga sexhdja.

Pastaj Allahu i Madhëruar i flet: "O Muhamed!" Ndërsa Muhamedi a.s. i përgjigjet: "Po!" Allahu i thotë: "Kërko dhe do të të jepet!" Pejgamberi a.s. thotë: "Më ke premtuar që do të ndërmjetësoj për njerëzimin. Të lutem Allah, nise gjykimin e njerëzimit."

Allahu thotë: "Pranohet prej teje. Do ta nis gjykimin e njerëzimit." Pastaj Pejgamberi a.s. largohet dhe bashkohet me pjesën tjetër të turmës.⁷

PARAQITJA E MADHE

Pastaj diçka tjetër e madhe ndodh. Sot në fakt është dita kur ndodhin gjërat e mëdha.

Një oshtimë e madhe dëgjohet dhe qielli nis të hapet...

Disave libri u vjen lehtë dhe butësisht në anën e djathtë dhe ata e presin. Është i ndriçuar. Ata e shfletojnë dhe lumturohen.

1 Bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s. "Në ditën e gjykit, ymeti im do të vijë me gjymtyrë të ndriçuar, prej gjurmëve të abdesit." Mutefekun Alejhi – Teksti është i Muslimit.

2 Abese, 40-42.

3 Bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s., transmetuar nga Aisheja r.a: "Atë ditë njerëzit do të ringjallen lakuriq të pabërë synet dhe të zbathur, të vetmuar." –Thashë: "Burra dhe gra të gjithë bashkë?" –"Të gjithë bashkë moj Aishe. Por çështja është aq e madhe, sa askush nuk ka mendjen të shoh tjetrin." Mutefekun Alejhi.

4 Frymëzuar nga Kurani, sure Haka, ajetet 19-24.

5 Mu'minunë, 112-113.

6 Bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s. që flet për shtatë kategoritë e personave që do të jenë nën hijen e Arshit të Allahut xh.sh., Mutefekun Alejhi 4/449.

7 <https://halakat.taimiah.org/index.spx?function=Printable&id=967&node=6868#reference2>

Kërkimi i Zotit sipas metodës së Ibrahimit a.s.¹

Enes Kariq

Në hapësirat e tij të shumëllojshme, Kurani në mënyrë të dukshme dhe të fshehtë, është i gërshtuar me një mesazh të fuqishëm të largimit nga politeizmi (*shirku*). Sikur në faqet e Kuranit shohim një “vrenjtje” kundrejt edhe vetëm mendimit se njerëzit ose prodhimet e tyre idhujtare (statujat, idhujt, imazhe kult, totemet...) mund të hyjnizohen. Gjithashtu, në kapitujt e tij, Kurani në disa vende qorton se politeizëm është kur dikush hyjnizon ndonjë yll, Diellin, Hënë...

Natyrisht, krijimi hyjnor është imponant dhe i fuqishëm. Ai vetvetiu i bën përshtypje njeriut. Universi është aty, përbri shikimit dhe dëgjimit tonë, si mrekulli e pranishme e cila zhvillohet rreth nesh. Është e pamundur që Universi të mos e trajtojë njeriun, të mos e mahnit atë. Kundrejt madhështisë dhe pafundit të Universit është e pamundur të qëndrosh indiferent.

Megjithatë, Kurani porositi se kjo mahnitje me Universin nuk është diç e keqe nëse gjatë kësaj kemi parasysh Krijuesin e gjithçkaje, Një dhe i Vetmi Zot, i Cili krijon të gjitha katet qiellore, i Cili është i Dukshmi (*Dhāhir*), por në një mënyrë njëkohësisht është edhe i Padukshmi (*Bāḥin*).

KËRKIMI I IBRAHIMIT A.S. PËR ZOTIN

Pikërisht ajo që Zoti me krijimin e vet të botëve të panumërta “shfaqet”, por njëkohësisht edhe “fshihet” - është misteri qendror i sekretit hyjnor. Është e mundur që pikërisht në atë sekret të ekzistojë ajo arsyeja kryesore, andaj njerëzit kërkojnë ose kanë kërkuar “ta shohin Zotin në njëmendësi”²

Në këtë kuptim është shumë interesant shembulli i Ibrahimit, të dërguarit të Zotit. Ai ka dëshiruar ta “shihte” Zotin. Rasti i tij është edhe më interesant, ngase në kërkim të Zotit,

Nuk është e vështirë të zbulohet se Kurani për të dërguarit e Zotit i flet tërthorazi vetë jetës, ose brenda pulsimeve dhe ndodhive shumëtrajtëshe të jetës. A duhet të thuhet atëherë se jeta e një të dërguari ishte e vështirë?! Gjithsesi, mund të thuhet se nuk ishte e lehtë.



Një dhe të Vetëm, ai nisi një udhëtim duke u larguar nga hyjnitë e dukshme të rreme të politeizmit. Surja *El En 'am*, 74-79, thotë se Ibrahim i tha babait të tij, Azerit, l'i refuzonte idhujt e tij si hyjni dhe konsideron se "edhe babai i tij edhe populli e tij janë në humbje të dukshme!"

Ibrahimi pastaj u drejtua në natyrë, ku atij iu shfaq "Mbretëria e Qiejve dhe e Tokës": "Dhe kur ra nata, ai e pa një yll e tha: 'Ky është Zoti im!'. Por, pasi perëndoi ai, tha: 'Nuk i dua ata që perëndojnë!'. E kur e pa hënën që po lind, ai tha: 'Ky është Zoti im!' E pasi që edhe ai perëndoi, ky tha: 'Nëse Zoti im nuk më drejton në rrugë të drejtë, unë me siguri do të jem nga ata që kanë humbur.' Por kur e pa diellin si po lind, ai thirri: 'Ky është Zoti im, ky është më i madh!' Mirëpo, pasi edhe ai perëndoi, ai tha: 'O populli im, unë heqë dorë nga ato që ju i bëni shokë! Unë po e drejtoj fytyrën time si besimtar i vërtetë kah Ai që ka krijuar qiejt dhe tokën...!'"²³

Por, filloi nata dhe perëndoi Dielli, muzgu po binte rreth e rrotull... Pjekuria e Ibrahimit atëherë arriti kulmin, e kuptoi se ai duhet të "kthente fytyrën e tij të përkushimit dhe besimit të pastër tek Ai që krijoi qiejt dhe Tokën!"

Si edhe në vende tjera në Kuran, edhe ky pasazh (6:74-79) ofrohet bujarisht për interpretime mahnitëse.

E para, kërkimi i Ibrahimit për Zotin, Një dhe të Vetëm, në këtë botë të shfaqjeve, paraqitjeve dhe ndryshimeve "materiale" ndjek shtegun nga "më e vogla" te "më e madhja". Ibrahim i lëshoi statujat dhe idhujt, pranoi yllin e ndritshëm në horizontin qiellor, pastaj e lëshoi atë, pranoi Hënën e ngrohtë, pastaj e lëshoi dhe, më në fund, pranoi Diellin përcellues si ai që iu shfaq si "më i madh", pra, më i ndritshmi. Por edhe Diellin e lëshoi, pasi që perëndoi.

E dyta, pikërisht kur atij në këtë botë fenomenesh "materiale" iu shfaq gjëja "më e ndritshme", vetëm Dielli, Ibrahim bëri një hap thelbësor shpirtëror në kërkimin e tij për Zotin: Kur perëndoi Dielli, Ibrahim mësoi:

Është Ai i Përhershmi, Ai i Cili është gjithandej, Ai i Cili nuk perëndon! Ai është në kohët e fenomeneve të cilat kanë inkurajuar përkohësisht Ibrahimin, por Ai është edhe përtej atyre kohëve. Ai nga përjetësia e Tij i bashkëpërcakton të gjitha këto, aspak pa e humbur gjithëpraninë e Vet.

E treta, Ibrahim kuptoi se ylli, Hëna, Dielli ... janë shenja (*āyāt*) të cilat tregojnë për Zotin. Ato vetë nuk janë hyjni.

Ky tregim për Ibrahimin tregon se i gjithë Kurani mundet (dhe duhet) të lexohet si një mesazh, i cili e mëson njerëzimin

*Jo vetëm që
Kurani flet për
vuajtjet dhe
tundimet e mëdha
të të dërguarve të
Zotit, ky libër
gjithashtu na flet
për të dërguarit e
Zotit të cilët,
megjithëse besojnë
me ngulm në Zot,
i kërkojnë Zotit
garanci shtesë për
të mbështetur
besimin e tyre.*

që në botët e panumërta të natyrës të lexohen shenjat që tregojnë për Zotin, Një dhe të Vetëm.

KATËR ZOGJTË E IBRAHIMIT A.S.

Në Kuran, të dërguarit e Zotit i shohim më shpesh si njerëz që jetojnë jetën e tyre tokësore me njerëz të tjerë, gra dhe burra, dhe me këta njerëz - dëshmitarë të besueshëm - ata i përcjellin ditët dhe netët e tyre këtu, rrëzë sferës së Hënës.

Të dërguarit e Zotit jetojnë, ndiejnë dhembje, vuajnë, përmallohen, dashurojnë, emigrojnë, pësojnë, kaplohen dhe preken nga vorbullat e luftës, tmerret e përmbytjeve, tërmete, furtunave, stuhive, sëmundjeve... Gjatë gjithë kësaj, ata ishin të dërguarit e Zotit, ata ngulmuan në misionin dhe detyrën e tyre prej të dërguari dhe peygamberike, për shkak se ata ishin të obliguar ndaj njerëzve të kohës së tyre që t'ua komunikojnë urdhrat dhe porositë e Zotit, udhëzimet shpirtërore, parimet morale.

Nuk është e vështirë të zbulohet se Kurani për të dërguarit e Zotit i flet tërthorazi vetë jetës, ose brenda pulsimeve dhe ndodhjeve shumëtrajtëshe të jetës. A duhet të thuhet

atëherë se jeta e një të dërguari ishte e vështirë?! Gjithsesi, mund të thuhet se nuk ishte e lehtë. Ishte përplot spontanitetet dhe paparashikueshmëri. Të dërguarit e Zotit shpesh ishin në skaj të durimit. Kurani shpesh flet për këtë. Surja *El Bekare* (2:214) përmend sprovën të rënda që përjetonin të dërguarit dhe pasuesit e tij, madje bërtisnin me zë të lartë: "Kur do të vijë më [ajo] ndihmë e Zotit?!" Ata u ngushëlluan me fjalët: "Ndihma e Zotit është afër, me të vërtetë!" E njëjta sure përmend se "të dërguarit u vranë në drejtësinë e Zotit (pa kurrfarë të drejte!)" (2:61). Fjalët fort të imagjinueshme dhe prekëse përshkruajnë pikëllimin e gjatë të Jakubit a.s. për djalin e tij Jusuf a.s.: "O Jusuf, o dëshpërimi im (O i mjeri unë)!" - fliste Jakubi (krhs. *Jusuf*, 12:84). Në një vend në Kuran (*El Isra*, 17:74) për Muhamedin a.s., thuhet: "Dhe sikur të të mos kishim përforcuar ty, gati u lëshove pe (paganëve), sadopakë qoftë!" Kjo për Muhamedin a.s. me sa duket thuhet në lidhje me vështirësitë që pësoi dhe duroi gjatë viteve të bojkotit mekas. Sigurisht, ai vuajti edhe më vonë, gjatë fatkeqësive të imigrantëve për në Medinë. Dhe kështu me radhë, ne mund të numëronim sprovën të rënda të pësuar nga të dërguarit e Zotit, nga ato edhe se Junusin a.s., e gëlltiti balena (*Es Saffat*, 37: 142) deri te fakti se Nuhi a.s., duroi tmerret e një përmbytjeje të madhe (*El Mu'minun*, 23:23-29).

Jo vetëm që Kurani flet për vuajtjet dhe tundimet e mëdha të të dërguarve të Zotit, ky libër gjithashtu na flet për të dërguarit e Zotit të cilët, megjithëse besojnë me ngulm në Zot, i kërkojnë Zotit garanci shtesë për të mbështetur besimin e tyre. Në këto ese e kemi përmendur Musain a.s., i cili kërkoi që *“Zoti ti shfaqet, e që Musai ta shohë atë”* (El A'raf, 7: 143).

Me këtë rast, një klithmë e rëndë e Ibrahimit a.s., paraardhësi i njerëzimit monoteist, është veçanërisht interesant për ne në suren *El Bekare*, 2:260): *“Zoti im, më mundëso të shoh se si i ngjallë të vdekurit?”* Pas paralajmërimit të Zotit: *“A nuk beson ti atë?!”* - Ibrahim i u përgjigj se beson, por *“dëshiron që zemra t'i qetësohet!”*⁴

Pasoi urdhri i Zotit drejtuar Ibrahimit: *“Merri katër zogj, dhe theri ato, e pastaj në çdo mal vendos nga një pjesë të tyre, mandej thirri ato, do të vijnë ty shpejtë, e dije se Allahu është i Gjithëfuqishmi, i Urti.”*⁵

Asgjë më shumë nuk thuhet në Kuran për këtë, nuk thuhet nëse Ibrahim a.s., mori katër zogj dhe bëri ashtu siç ishte urdhëruar. Duke pasur parasysh mënyrën se si Kurani flet për mrekullitë, duhet të supozohet se Ibrahim a.s., iu bind urdhrit të Zotit, pasi që ai pasoi pas klithmës së tij: *“Zoti im, më mundëso të shoh se si i ngjallë të vdekurit?”*

Me anë të një analize kontrastuese të tërësisë së tekstit kuranor, vijmë deri te njohuritë jashtëzakonisht interesante si në vijim:

Surja *El En'am*, 6:74-79, e tregon mjaft qartë Ibrahimin a.s., si ai që vrojton yllin, Hënën, Diellin, për të gjitha ato veç e veç në të njëjtin çast pohon se është zoti i tij. Por, si perëndojnë ato, ai heq dorë prej tyre, atëherë vjen në pjekurinë se Zoti është Ai që i krijoi të gjitha ato. Pikërisht, Zotit në fund të kërkimit, Ibrahim a.s. ia kthen fytyrën e vet, i dorëzohet realitetit hyjnor që është përtej yllit, Hënës dhe Diellit, por edhe më afër njeriut sesa ylli, Hëna dhe Dielli...

Së dyti, ashtu siç mori urdhër nga Zoti për të prerë dhe copëtuar katër zogj, Ibrahim a.s. mori (përmes ëndrrës së vërtetë) urdhrin hyjnor se duhet të sakrifikojë (ther) djalin e vet.⁶ Kjo gjithashtu kishte të bënte me kërkesat e fundme të cilat e trajtuan Ibrahimin a.s.. Ibrahim iu dorëzua Zotit, kështu që Zoti ia gjeti rrugëdaljen...

Së treti, surja *El Bekare*, 2:258, sjell një dialog midis Ibrahimit a.s., dhe një sundimtari të fuqishëm. Dialogu ka të bëjë për Zotin, si dhe asaj se ç'mundet njeriu dhe ç'mundet Zoti. Në fund, Ibrahim i tha këtij sundimtari: *“Zoti im e lind Diellin nga lindja, bërë pra ti atë nga perëndimi.”* Atëherë ai që nuk besoi mbeti i hutuar. Sigurisht, sundimtari tiran nuk mund të bënte një gjë të tillë. Është e pamundur që njeriu të ndikojë në ndryshimin e lëvizjes së Universit.

Duke iu kthyer motivit të “katër zogjve të Ibrahimit”, kurse në lidhje me shumicën e tregimeve të tjera të Kuranit për Ibrahimin, vërejmë se ky motiv, si dhe të tjerët të përmendur këtu, ka të bëjë me krijimin Hyjnor. Komentuesit e Kuranit



na bindin se kjo mrekulli me “katër zogjtë” u zhvillua më tej, duke thënë se Ibrahim a.s. me të vërtetë i “preu” katër zogj të ndryshëm (*palloi, shqiponja, korbi dhe gjeli*), i përziu pjesët e tyre në gjakun e tyre, dhe pastaj i shpërndau në katër male. (Numri katër këtu tregon katër anët kryesore të botës!). Atëherë Ibrahim i ftoi ato drejt vetes. Ato i erdhën të gjallë, nxituan drejt tij të bindura. Fakti që ato i erdhën nga të katër anët e botës do të thotë që krijimi i Zotit zhvillohet në të gjitha anët e botës.

Le të themi në fund të kësaj eseje se janë të vështira edhe pyetjet edhe përgjigjet për krijimin. Këtë e tregon edhe ky vend në Kuran (2:260). Me fjalë të tjera, që Ibrahim a.s., të shohë se si Zoti me të vërtetë i ringjall të vdekurit, domethënë se si Ai krijon të gjallën nga e vdekura, ai është dashur të kalojë përmes një përvoje të vështirë, ai duhej të bënte therjen dhe copëtimin e katër zogjve të gjallë! Në njëfarë mënyre, Ibrahim a.s., duhej të merrte përvojën e vdekjes së këtyre katër zogjve, për të fituar përvojën e krijimit të tyre të serishëm.

Përktheu nga gjuha boshnjake: Dr. Azmir Jusufi

1 Enes Karić, *Kako citati Kur'an 1*, (Sarajevë, 2019), 60-65, 80-83.

2 Krhs.: *El Bekare*, 2:55; *El A'raf*, 7:143.

3 Krhs.: *El En'am*, 6:76-79.

4 *El Bekare*, 2:260.

5 *El Bekare*, 2:260.

6 Krhs.: *Es Saffat*, 37:101-102.

“Mysliman” – ç’është kjo?

Hajrudin S. Muja

Më thonë se jam mysli­man, se jam pjesëtar i dy miliardë njerëzish dhe i një feje me përhapje më të gjerë në botë, dhe unë po përpiqem të kuptoj ç’është mysli­mani? Është një fjalë që e shkruaj dhe e lexoj në artikuj gazetash, në formularët që më pyesin për fenë time, një fjalë që më del përpara kur pyes pse falem dhe pse jam ndryshe nga popujt dhe identitetet e tjera! Ata janë jomysli­manë – më thonë, e unë qenkam pa ‘jo’-në!

Ç’është mysli­mani pra? Kam parë njerëz buzë rrugës që u shpërndajnë pamflete të tjerëve: “vetëm për jomysli­manët”, me tituj e nëntituj “Kush është mysli­mani?”, që u flasin atyre, por nuk ma thonë mua “Ç’është në të vërtetë mysli­mani”? Më flasin për numrin e tyre të madh, një miliardë e gjysmë, e unë ndiejë kureshtje të mësoj nëse gjysma e tyre e dinë se ç’është mysli­mani? Mos më besoni mua, por unë megjithatë do t’ua them, sepse edhe unë llogaritëm në këtë statistikë. Besimi në Allahun xh.sh. dhe të dërguarit e Tij, namazi, agjërimi, zekati dhe pelegrinazhi, janë vetëm dera hyrëse e të qenët mysli­man. Kaq e thjeshtë dhe kaq e lehtë për t’u kuptuar, por askush nuk më thotë çfarë qëllimi ka mysli­mani, për çka lufton ai, në çka përmbahet dhe çka në të vërtetë beson ai?

Çfarë t’u them atyre që ndajnë pamflete të tjera, me të cilat më akuzojnë për terrorist, për fundamentalist, për të prapambetur, për

*Besimi në
Allahun xh.sh.
dhe të
dërguarit e Tij,
namazi,
agjërimi,
zekati dhe
pelegrinazhi,
janë vetëm
dera hyrëse e të
qenët
mysli­man.*

anti-demokrat, për barbar, për injorant, për të eskaduar, për “tru shpërlarë”...?! Më konsiderojnë një gjysmënjeri që nuk i njeh dhe nuk di t’i shijojë ‘të mirat’ e jetës, më quajnë aziatik, tradhtar, antikombëtar dhe të pa dëshirueshëm për mesin ku jetoj, këtu në një nga metropolet më të mëdha të botës, ku djajtë e skëterrës tërbohen në zemrat e njerëzve të këqij dhe ku e shëmtuara vishet me rrobat e bukurisë, por që edhe pse nuk ka shumë sy për ta parë – e shëmtuar mbetet! E unë mbetem si banorët e asaj mbretërie që duke pirë ujë nga i njëjti pus, u çmendën të gjithë dhe kujtuan se është çmendur mbreti, e pastaj edhe mbretit ju desh të pijë nga uji i çmendurisë, që të bëhet i “mençur” si ata!

Unë prapë qëndroj i heshtur, sepse askush nuk më thotë ç’është mysli­mani?! Më tregojnë rrëfime mbi jetën e mysli­manëve që kanë jetuar në të kaluarën, për guximin e tyre, për trimërinë dhe heroizmin e tyre, për moralin e tyre të lartë, për përkrahjen e mysli­manëve të tjerë, për njohuritë e tyre të thella dhe arritjet e tyre të mëdha shkencore. E unë sërish mbetem i hutuar dhe kërkoj të di përse nuk jetojnë mysli­manë të tillë sot? Unë habitem se si një grup të krishterësh të vetëquajtur “Dëshmitarët e Jehovahit”, me më pak se tetë milion pjesëtarë, botojnë një libër me 192 fletë në 95 gjuhë, në 84 milionë ekzemplarë dhe dy revista dyjavore me 1.315.000 ekzemplarë, kurse mysli­manët me më shumë se dy miliardë pjesëtarë, me gjithë

pasurinë e madhe të “arit të zi”, nuk janë në gjendje të bëjnë qindra revista të tilla propaganduese!? Përkundër urdhrit të parë të Zotit: “Lexo”, ata nuk lexojnë, të gatshëm të vdesin për Kuran, por jo ta jetësojnë atë! Ngado që shikon, sheh: “myslimanë në mëngjes dhe qafirë në mbrëmje”! Po, a nuk është i njëjti Islam për të gjithë njerëzit, për të gjitha kohët dhe për të gjitha vendet? Kanë qenë myslimanë ata që kanë jetuar në kohët e kaluara, apo këta të sotmit që po ua matin Islamin me me ‘përrçik’!?

Më thonë se duhet të ndihem krenar që jam mysliaman, por unë mund të ndihem i tillë vetëm atëherë kur të kem kuptuar esencën e të qenët mysliaman dhe vetëm atëherë kur të ndjehem vërtetë i tillë. Prej cilit të mësoj çështje vërtetë mysliamani? Prej atyre që gjithë jeta u shkon duke më mësuat si të fërkoj duart (për abdes) dhe kaq, asgjë më tepër, apo prej atyre që më mësojnë si të ‘fërkoj’ mendjen!? Njëri andej, tjetri këndej! Të parët më fusin në thellësinë e “pyllit” dhe s’më nxjerrin dot jashtë duke më komentuar Kuranin që kurrë nuk e kanë lexuar (ose nuk e kuptojnë), kurse të dytët më fusin në armiqtësi me ata që mendojnë se mysliaman i mirë është vetëm ai që posedon mendje të stagnuar dhe që shkon sipas direktivave që i japin ata?! Mu këto, më fajësojnë edhe për “ëndrrat” që nuk i kam parë dhe nuk i kam menduar, më akuzojnë edhe për krimet që bëjnë vetë! Urrejnë pamjen time, emrin tim, mbulesën time, veshjen time, bindjet e mija, urrejnë gjithçka që më lidhë me mysliamanin! Më japin shpresë kur më thonë se: “të gjithë mysliamanët nuk janë terroristë” dhe më pezmatojnë se “të gjithë terroristët janë mysliamanë”, sepse sado i madh të jetë krimi i një jomysliamani, ai s’mund të jetë terrorist po nuk e pat aty edhe “mysliamanin”!

Kujtoj dhe habitem kur shoh se si vetëm fjala “Allahu ekber” vendos në heshtje 3-4 milionë njerëz të qindra kombësive të ndryshme në Qabe dhe nuk dëgjon tjetër veç dallëndysheve që rrotullohen rreth Qabesë si besimtarët!? Të gjithë këta janë mysliamanë të pastër (me abdes), të rreshtuar pa dallim, të bardhë e të zinj, të pasur e të varfër, meshkuj e femra, mbretër e lypsarë, veshin të njëjtën veshje, hanë të njëjtin ushqim, recitojnë të njëjtën lutje. Cili organizim do të arrinte ta



bënte një gjë të tillë përveç besimit? Por, kur futem në xhaminë e lagjes, para vetes kam dy namazli, njërin me mjekër tjetrin pa mjekër, njërin me pantolla të shkurtra tjetrin me të gjata, njëri “tradicional” tjetri i “moderuar”, njëri merr tekbinin te krah, tjetri te veshët, njëri lidhet në kraharor, tjetri nën kërthizë, njëri i falë farzet, tjetri nuk i falë, njëri falë 20 rekate teravi, tjetri 8, njëri merr pjesë në mevlude, tjetri nuk merr, njëri falë nafile, tjetri nuk i falë...?! Cili është mysliamani?

Po guxova të shprehë lirshëm mendimin tim për bombat e “demokracisë” që i vrasin njerëzit në kampe përqendrimi, që i lënë fëmijët të vdesin para syve të botës në varfërinë e skajshme, më thonë “antisemit”, se ata na qenkan terroristë të ardhshëm të cilët duhet të shtypen në gjirin e nënës, që të mos shumohet kopeja e tyre terroriste. Bota kështu u nda në të krishterë të bardhë, në ‘pisa’ esmerë dhe të ata fare të errët! Ata të parët të qytetëruar, këta të dytët me bomba në dorë të gatshëm për të rrënuar jetët e atyre të parëve! A nuk e keni vënë re se në dorën e tyre është e rrezikshme qoftë edhe një shishe uji apo një prerëse thonjsh (në aeroport). A nuk e keni vënë re për kaq kohë se vetëm “jomysliamani i sëmurë” mund të bëjë masakër dhe vetëm “mysliamani i sëmurë nuk është terrorist”?! Sa keq që vriten njerëzit nëpër shkolla dhe vende të tjera publike të Perëndimit, në vend që të vdisnin në

Kujtoj dhe habitem kur shoh se si vetëm fjala “Allahu ekber” vendos në heshtje 3-4 milionë njerëz të qindra kombësive të ndryshme në Qabe dhe nuk dëgjon tjetër veç dallëndysheve që rrotullohen rreth Qabesë si besimtarët!?



vendet e “esmerëve”, duke mbrojtur botën “demokratike” nga “terrorizmi”!

Ku janë myslimanët? Ku është elita, e cila, e mbytur në luksin e vet nuk sheh përtej hundëve të veta mjerimin që e rrethon!? Mos më thoni se një profet shndërroi një popull që merrej me blegtori në një popull që udhëhoqi botën për shekuj të tërë, një popull që arriti një zhvillim të pakrahasueshëm në kohë dhe gjerësi të dijeve shkencore, mbi të cilat u mbështeten të gjitha arritjet e mëvonshme. E di këtë, por ku është ky popull sot dhe pse është në këtë gjendje!?

Sot, poseduesit e kapitalit dhe ushtarët e tyre të quajtur politikanë, kanë dalë haptas në anën e agresorit dhe kanë vendosur fjalët në penat e gazetarëve dhe në gojët e “analistëve”, për ta bërë të bardhën të zezë dhe të zezën të bardhë! Besimtari duhet t'i thotë të bardhës të bardhë dhe të zezës të zezë, edhe sikur e gjithë bota të thotë të kundërtën! Nëse jemi për mendimin e lirë, ne duhet të kërkojmë argument edhe sikur të gjithë sunduesit, shtetarët dhe shkencëtarët të thonë ndryshe.

Gabojnë ata që mendojnë se myslimani është një besimtar me vetëm një tog ritualesh mistike që duhet plotësuar. Ai gjithsesi është edhe i tillë, por nuk i mjafton nëse ai nuk bën

më shumë se kaq. Nëse nuk i përfshin mësimet e Islamit në çdo aspekt të jetës (El En'am, 162). Nuk mund ta konsiderosh veten besimtar duke realizuar detyrimet e ibadetit, nëse nuk të punon “antena” për të njohur anët e së mirës dhe anët e së keqes, dhe duke përkrahur këtë të fundit, qoftë edhe me heshtjen tënde! Secili duhet të llogarisë veten cilit grup i takon, por ibadetet tua janë tërësisht të pavlefshme nëse të mungon kjo “antenë”!

Myslimani është posedues i dashurisë dhe frikë për Allahun, është i vendosur për ta jetësuar Kuranin, është posedues i dashurisë që shprehë kundrejt krijesave të tjera. Pa besim, çdo dashuri bazohet në vlera të kota të kësaj bote si: paraja, pamja fizike, statusi shoqëror, etj., por këto janë vetëm mangësi të cilat i shkaktojnë zhdukjen e ndjenjës që supozohet të jetë dashuri! Myslimanin e bën mysliman kodi i përgjithshëm i sjelljes që e formëson dhe e udhëzon në këtë dhe në botën tjetër. Ai është “rob” i moralit, jeton sipas këtij morali, sillet sipas këtij morali dhe vdes duke ndjekur këtë moral. Ky moral vjen nga Krijuesi dhe udhëzimi i Tij, udhëzim që na tregon se për të ndryshuar gjendjen në të cilin gjendemi, duhet të fillojmë me ndryshimin e vetes tonë. (Err Rrad, 11).



Fejesa dhe normat e saj

Nehat Shehu

Është më së i qartë fakti që martesë konsiderohet shtyllë e familjes, me të fillon dhe zhvillohet familja, e cila është celula e një shoqërie të vogël dhe njëkohësisht baza kryesore mbi të cilën ngrihet shoqëria e vërtetë. Pra, shoqëria në tërësi është e përbërë prej këtyre familjeve të cilat ngrihen mbi besimin, parimet e traditat e mirëfillta, të cilat janë si një bazament për shoqërinë, dhe sa më i fuqishëm të jetë ky bazament, aq më e fuqishëm dhe më e sigurt do të jetë kjo shoqëri e cila ndërtohet mbi të. Prandaj Islami i dha një pozitë të veçantë familjes, personit, por edhe vetë aktit në fjalë duke e quajtur atë në Kuran si “besatim i fuqishëm” apo edhe lidhje e tillë. Kjo në mënyrë që të vihet në pah rëndësia e aktit dhe shenjtëria e tij, si dhe të tregohet që Islami ka synime strikte në ruajtjen e kësaj familjeje dhe sigurimin e vazhdimet të saj apo jetëgjatësisë. Kjo kontratë martesore apo ky akt i rëndësishëm kërkon një lloj premtimi fillestar apo besatimi, gjatë të cilit secili prej dy palëve të sqarojë paqartësitë dhe të bindet me

zemër në hapin e madh që do ndodh pastaj, e pikërisht kjo njihet me termin “El hitbetu” apo fejesa.

NOCIONI I FEJESËS

Dijetarët kanë përmendur nocione dhe përkufizime të ndryshme rreth fejesës, megjithatë më i popullarizuari apo më i përkrahuri është ky: Kërkesa apo premtimi i burrit (apo gruas) për martesë.¹

Realisht kjo kërkesë apo ky premtim mund të bëhet nga cilado palë (edhe pse e zakonshmeja është të jetë nga ana e mashkullit) qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë duke dërguar dikë, qoftë te personi me të cilin synohet martesë, qoftë te kujdestari i saj/tij apo ndonjë familjarë e të ngjashme. Dhe është me vend të përmendim faktin që kjo fejesë mbetet në kontekstin e kërkesës apo premtimit dhe deri në këtë fazë nuk përmban asnjë specifik të ndonjë akti martesor.

Faktikisht kjo kërkesë mund të jetë nga dy palët, qoftë nga ana e mashkullit apo nga ana e femrës, dhe se kjo kërkesë siç është e lejuar të bëhet nga ana e mashkullit lejohet edhe nga ana e femrës, qoftë kjo kërkesë e drejtpërdrejtë ose diçka alegorike, apo edhe autorizim i dikujt që ta kryej këtë gjë, forma këto të cilat kanë ndodhur dhe ndodhin akoma e që për të cilat nuk ka ndonjë kundërshtim nga ana shariatike.

Lidhur me njërin apo formën tjetër të cilat u përmendën më lartë kemi ngjarje të transmetuara nga Pejgamberi a.s. Ishte vetë Pejgamberi a.s. që kërkoj dorën e Aishes r.a. nga babai i saj Ebu Bekri r.a., kurse në anën tjetër Hadixheja r.a. dërgoi dikë që t’ia paraqes

Dijetarët kanë përmendur nocione dhe përkufizime të ndryshme rreth fejesës, megjithatë më i popullarizuari apo më i përkrahuri është ky: Kërkesa apo premtimi i burrit (apo gruas) për martesë.



ofertën apo kërkesën e saj për martesë Pejgamberit a.s., kërkesë së cilës iu përgjigj pozitivisht i Dërguari i Allahut.

URTËSIA E LEGJITIMITETIT TË FEJESËS

S'ka dyshim që çdo lejim apo ndalim në fenë tonë ka urtësinë e vet. Në këtë grup hyn edhe fejesa, ku dijetarët na kanë mësuar se kjo fejesë është bërë e ligjshme-lejuar në mënyrë që njëra palë apo tjetra të ketë në dispozicion kohë të mjaftueshme që të mbledhin informacione mbi partnerin/ren e ardhshëm, duke pyetur për moralin, karakterin, tiparet, rrethin familjarë, etj., të dhëna këto të cilat janë jetike për atë çfarë do vije më pas (pra martesën dhe formimin e familjes). Andaj kjo fejesë u jep këtë mundësi të dy palëve në mënyrë që të jenë të ditur për njëri-tjetrin dhe të jenë të qetë e të relaksuar për jetën që synojnë ta nisin pas këtij hapi. Që fejesa të jetë e ligjshme duhen plotësuar disa kushte, ku ndër to veçojmë:

1. Të mos jetë femra në fjalë prej atyre me të cilat na ndalohet martesa (ndalesë nga ana e familjes, nga ana e qumështit, pra ndalesë e përhershme apo edhe martesa me ateisten, ose gruan e shkurorëzuar tri herë e cila konsiderohet si ndalesë e përkohshme).

2. Të mos jetë e martuar me dikë tjetër apo të mos jetë në idetin (pritjen) e saj pas shkurorëzimit të kthyeshëm.

3. Të mos jetë e fejuar me dikë tjetër² (pra ne rast kthimit të përgjigjes pozitivisht).

Lidhur me këtë pikë, kemi një çështje të rëndësishme e cila mendoj që është e rrugës që të sqarohet e ajo është: fejesa mbi fejesë, kjo pasqyrohet si vijon: fejesa mbi fejesë konsiderohet kur një person dëshiron të martohet me një grua të cilës i ka ofruar fejesë dikush para tij, dhe kjo e fundit nuk ka kthyer akoma përgjigje.

Lidhur me këtë çështje, na ka treguar Pejgamberi a.s. në hadith ku thotë: “Të mos bëjë askush fejesë mbi fejesën e vëllait të tij, derisa të tërhiqet ai që e ka kërkuar atë femër më parë, ose t'i ketë dhënë leje kërkuarit të dytë.”³

Lidhur me këtë hadith, Imam Maliku ka thënë: “Ajo që vlerësojmë ne në komentimin e këtij hadithi është që vije në domethënie e paraqitjes së kërkesës dhe refuzimit e ofertuesit të parë dhe pajtimi me të dytin për mehrin e ofruar nga ai.”⁴

Duke u bazuar në këtë hadith ne mund të konkludojmë se për këtë çështje kemi këto raste:

*“Të mos bëjë
askush fejesë
mbi fejesën e
vëllait të tij,
derisa të
tërhiqet ai që e
ka kërkuar atë
femër më parë,
ose t'i ketë
dhënë leje
kërkuarit të
dytë.”*

(Muhamedi, a.s.)

a) Në rastin e paraqitjes së kërkesës dhe pranimit nga femra, assesi nuk lejohet që të kërkojë dikush martesën e saj, dhe për këtë kemi unanimitet të dijetarët islam (kjo është ajo që u theksua te kushtet e ligjshmërisë së fejesës).

b) Në rastin e paraqitjes së kërkesës te femra, dhe ajo nuk është përgjigjur ende, as nuk ka pohuar as nuk ka mohuar gjë, në këtë rast shumica e dijetarëve hanefi mendojnë që nuk lejohet të kërkojë fejesa e saj nga ana e mashkullit tjetër.

c) Në rastin e paraqitjes së kërkesës te femra dhe refuzimin e qartë nga ana e saj, atëherë me unanimitet të të gjithë dijetarëve lejohet që të paraqes kërkesën ndonjë tjetër i interesuar për martesë.⁵

Këtu përmendim edhe një rast të fundit e që është paraqitja e kërkesës te femra, dhe ajo nuk ka refuzuar zyrtarisht, por ka dhënë shenja të një refuzimi eventual, në këtë rast lejohet paraqitja e kërkesës nga dikush tjetër sipas dijetarëve hanefi, ndonëse një veprim i tillë konsiderohet si mekruh (e urryer).

SHIKIMI I NJËRI-TJETRIT DHE GJËRA TË CILAT LEJOHEN DHE NDALOHEM GJATË FEJESËS

Kur myslimani vendos të fejojë një femër, atëherë i lejohet që ta shikoj atë para se t'i fillojë hapat për martesë, me qëllim të njohjes së vajzës dhe duke kushtëzuar që qëllimi të jetë i mirë dhe i pastër (e njëjta vlen edhe për femrën). Kjo është pikërisht ajo që na porositi Pejgamberi a.s. në hadithin e transmetuar nga Mugire ibën Shubete, i cili dëshironte fejesën e një femre, dhe pasi kishte informuar të Dërguarin a.s., ky i fundit i tha atij: “A e ke shikuar atë?” “Jo”, i tha ai! Atëherë Pejgamberi a.s. tha: “Shko shihe atë, sepse kjo e bën të jetë më jetëgjatë lidhja juaj.”⁶⁷

Ndërsa sa i përket çështjes se çfarë i lejohet të shikoj, mund të themi se shumica e dijetarëve janë të mendimit që i lejohet të shikoj vetëm ato pjesë që lejohet t'i shihen para fejesës, pra fytyra dhe duart e saja.⁸

Pasi që folëm për shikimin e njëri-tjetrit, tani do kalojmë te gjërat që lejohen dhe ato që ndalohen gjatë kësaj kohe (pra gjatë fejesës). Në fillim potencuam që fejesa sipas Islamit është kërkesë për martesë dhe se gjatë kësaj periudhe lejohet që të interesuarit të shohin njëri-tjetrin (siç u sqarua në pikën paraprake) me qëllim të njohjes më të thellë etj., mirëpo duhet të theksojmë që kjo duhet të mbetet në kufijtë e të lejuarës dhe assesi të mos dal më shumë se kaq, rrjedhimisht nuk lejohet takimi i tyre pa ndonjë person tjetër, sepse



vetmimi mes tyre është gjë e ndaluar në Islam, prandaj nuk duhet keqpërdorur këto mundësi të ofruar nga Islami e të lejohet vetmimi i të fejuarve. Fatkeqësisht kjo traditë sot është bërë e zakonshme në mesin tonë, e që shoqërohet me dëshirën e imitimit të qytetërimit perëndimorë dhe traditave të tyre.⁹

Lidhur me vetmim dhe ndalueshmërinë e tij kemi hadithin e transmetuar nga Abdullah ibën Abasi ku thotë: “Të mos vetmohet asnjë burrë me cilëndo femër të huaj, vetëm nëse me të është kujdestari i saj.”¹⁰

Ky vetmim ngërthen në vete edhe metodat e tanishme të rrjeteve sociale apo të ngjashme, andaj rregullat dhe ndalesat që kanë të bëjnë me vetmimin real vlejné edhe për këtë virtual dhe për këtë gjë kemi një shumicë dërrmuese të dijetarëve të cilët e mbështesin këtë mendim. E gjitha kjo që t’u iket veprave të liga dhe keqpërdorimeve të çfarë lloji qofshin, e si të tillë të ruhen familjet, dhe posaçërisht çifti.

PRISHJA E FEJESËS DHE PASOJAT E SAJ

Fillimisht duhet të theksojmë se prishja e fejesës është e lejuar për cilëndo palë (qoftë nga ana e mashkullit qoftë nga ana e femrës) atëherë kur mendohet që është më mirë dhe më e dobishme për të, sepse fejesa në këtë kontekst nuk është akt martesor, por është vetëm paraqitje e kërkesës për martesë dhe si e tillë nuk merr tretmanin e këtij akti. Mirëpo duhet potencuar që prishja e fejesës pa ndonjë arsye nga cilado palë është e urryer dhe nuk përkon me karakterin e besimtarit/res që të bëjë një veprim të tillë. Nëse eventualisht ndodh kjo prishje për njërën apo tjetrën arsye, nuk do të thotë që nuk ka pasoja, andaj dijetarët kanë treguar edhe për rastin e pasojave të prishjes së fejesës dhe kanë potencuar njëzëri që

nëse ka pasur shkëmbim të dhuratave, atëherë është e drejtë të kërkohet kthimi i tyre, nëse eventualisht ato janë shkatërruar pjesërisht apo në tërësi, atëherë dijetarët hanefi thonë që paguhet vlera e atyre dhuratave, pa marrë parasysh nga cila palë ka ndodhur. Te këto dhurata përfshihet edhe mehri apo paja nëse është paguar, veçse për të, dijetarët janë të pajtimit që i takon e drejta ekskluzive e mashkullit që të kërkojë kthimin e tij (apo vlerës së tij) sepse mehri është normë nga normat e martesës, dhe nëse nuk ka martesë atëherë nuk aplikohen normat e tij.¹¹

Kjo ishte sa i përket dëmshpërblimit për dëmin material, ndërsa nëse njëra palë apo tjetra dëshiron të kërkojë dëmshpërblim për dëmin moral, atëherë dijetarët klasik nuk ua lejojnë një gjë të tillë, mirëpo nuk mund të themi të njëjtën gjë edhe për këta bashkëkohorët, të cilët kohëve të fundit kanë filluar të lejojnë edhe një dëmshpërblim të tillë duke u bazuar edhe në ndryshimin e rrethanave.

Allahu e di më së miri!

Në fund lusim Zotin që t’i ruaj familjet tona e t’i begatojë me harmoni e respekt të ndërsjellë! Amin!

1 Talat Abdul Gafur Hasan, Ahval Shahsiye lil Muslimin, fq. 23.

2 Muhamed Rifat Uthman, Fikh e-nisai fi el hitbeti ve ez-zevaxh, fq. 16/17.

3 Muhamed Bin Ismail el Beuhari, Sahih el Buhari, 5142.

4 Është përmendur më herët.

5 Është përmendur më herët.

6 Ahmed bin Hambel, Musned Imam Ahmed, 18154.

7 Jusuf Kardavi, El Halalu ve el Haramu fi el Islam, fq. 202/203.

8 Amar Abdul Munim Selim, Adab el Hitbetu ve ez-zifaf, fq. 18.

9 Jusuf Kardavi, El Halalu ve el Haramu fi el Islam, fq. 202/203.

10 Muhamed Ismail el Buhari, Sahih el Buhari, 3006.

11 Muhamed Rifat Uthman, Fikh en-nisai fi el Hitbeti ve ez-zevaxh, fq. 40/41.

E drejta pronësore e gruas dhe burimet e saj (1)

Dr. Ilmije Kuqi

“Pasha Allahun, në epokën paraislame, çështjen e gruas nuk e llogarisnim asgjë, gjersa Allahu në lidhje me to shpalli atë që e shpalli dhe ndau për to atë që ndau.”

(Umeri, r.a.)

E DREJTA PRONËSORE E GRUAS

Në epokën paraislamike, gruaia nuk kishte kompetencë ligjore për të zotëruar pronë apo për të disponuar pasurinë e saj, përveçse në disa raste të rralla. Ajo kryesisht ishte në pronësi të kujdestarit ose bashkëshortit të saj dhe për këtë arsye ajo trashëgohej po si çdo lloj pasurie tjetër. Kur Kurani i madhërishtëm filloi t'i shpallet vulës së pejgamberëve, gruaia mori pozitën e saj dhe nga ajo u hoqën të gjitha llojet e padrejtësisë nën të cilat ajo kishte vuajtur me shekuj, e poshtëruar, e përbuzur, e privuar nga të drejtat, e zhveshur nga nivelet më të ulëta të njerëzimit. Ky nuk është ekzagjerim, pasi ndonjëherë ajo trashëgohej si plaçkë dhe nganjëherë vritej nga frika e varfërisë dhe turpfit. Kur dielli i Islamit lindi dhe drita e tij u përhap, ai i ia fshiui asaj të gjithë këtë padrejtësi, e çliroi nga ajo robëri dhe e zëvendësoi me forcë, lartësi, dinjitet, status dhe epërsi dhe i dha të drejtat që ajo nuk i kishte arritur. Ai ia dha të drejtat e saj njerëzore, fetare, sociale, ekonomike dhe politike dhe ia mundësoi asaj t'i gëzonte të gjitha, derisa ajo, në Islam, u bë në pozitë të barabartë me burrin. Secili prej tyre ka të drejtën dhe detyrën e tij, secili sipas asaj që Zoti i Madhëruar krijoi për të dhe e bëri të denjë për të.

Islami e ngriti vlerën e gruas dhe anuloi gjithçka që arabët dhe joarabët përdornin për ta privuar gruan nga të drejtat e saj financiare dhe nuk bëri dallim midis saj dhe burrit në këtë. Ai bëri për të një entitet të pavarur dhe

përgjegjëse për veprimet e saj, e bëri të aftë për detyrat ligjore dhe të aftë për të zotëruar dhe disponuar pasurinë e vet njësoj si burri. Mjafton fjala e Umer ibën el Hatabit për statusin e gruas para Islamit që të na bëhet e qartë se sa e nënçmuar ishte ajo: “Pasha Allahun, në epokën paraislame, çështjen e gruas nuk e llogarisnim asgjë, gjersa Allahu në lidhje me to shpalli atë që e shpalli dhe ndau për to atë që ndau.”¹

Islami erdhi dhe vendosi të drejtën e gruas për të zotëruar, përfutur dhe vepruar në atë që e zotëron, dhe i dha të drejtë të pavarur financiare, në të cilën burri kujdestar qoftë apo bashkëshort, nuk ka pushtet mbi pasurinë dhe pronën e saj.

Gruaia e pjekur, sipas legjislacionit islam, ka të drejtën e posedimit të pronës dhe të drejtën për të vepruar në të gjithë pasurinë e saj në të gjitha format dhe metodat e fitimit të lejuar dhe mjetet legjitime, si blerja dhe shitja, qiradhënia dhe qiramarrja, investimi, tregtia, shpenzimet, marrëveshje për biznes, bujqësia, bamirësia, dhurata, testamenti, lëmosha, huadhënia, huamarrja, falja, hipoteka etj.. Ajo ka të drejtë të lidhë kontrata financiare dhe tregtare vetë pa ndërmjetës, të autorizojë, të garantojë të tjerët, t'i lë testament kujt të dojë përveç trashëgimtarëve të saj brenda kufijve ligjorë dhe të ngre padi për mbrojtjen e të drejtave të saj financiare përpara gjykatës, dhe forma të tjera financiare dhe ekonomike, të gjitha pa autoritetin, lejen ose mbikëqyrjen e kujdestarit ose bashkëshortit të saj, me kusht që puna, sjellja dhe pronësia e saj të mos bien

në kundërshtim me mësimet ligjore dhe me funksionin bazë të gruas për amësinë dhe bashkëshortësinë.

Gruaja myslimane e moshërritur, mentalisht e shëndoshë, beqare qoftë apo e martuar, ka drejtë të plotë, të pavarur financiare dhe ka të drejtën absolute në kuadrin e dispozitave të Sheriatit në atë që fiton nga puna e saj hallall, si dhe të drejtën për të zotëruar prona siç e theksuam me lartë dhe të drejtën e veprimit në atë që e zotëron, ndërsa babai, vëllai, bashkëshorti apo djali nuk kanë autoritet mbi pasurinë e saj, dhe ajo nuk ka nevojë për lejen e tyre për të zotëruar dhe për të vepruar në të në atë formë që dëshiron përderisa është e ligjshme.

Se kjo liri i është dhënë gruas dhe konsiderohet si një nga të drejtat e saj ligjore, ka shumë ajete dhe hadithe që tregojnë qartë. Ndër to ajeti: *“Grave jepuani dhuratën e kurorës së tyre (niqahin) më të mirë, e në qoftë se ato nga vullneti i vet ju falin diçka nga ajo, atëherë hajeni atë hallall të mirë.”*²

Zoti i Lartësuar, gruas ia dha të drejtën për të zotëruar mehrin, në të njëjtën kohë duke ia dhënë lirinë e veprimit në atë që e zotëron pa iu referuar lejes së askujt, si dhe ndaloi të tjerët, kushdo qofshin ata, që të marrin diçka nga ai apo të veprohet në të përveçse me dëshirën e saj, e kjo është dëshmi se sipas legjislacionit islam, gruaja ka lirinë e veprimit me pronën e saj pa kufizim përderisa ajo ka arritur moshën e pjekurisë.

Gjithashtu, fjala e të Lartmadhërishmit: *“E nëse i lëshoni ato para se të keni kontakt intim me to, por u keni pas caktuar atyre një caktim (kurorë), atëherë duhet t’u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveç nëse ato ju falin”.*³ **“E juve**

*(burrave) nuk u lejohet t’u merrni asnjë send nga ajo që u keni dhuruar (si niqah).”*⁴

Ky ajet pohon të drejtën e gruas për të zotëruar gjysmën e mehrit në rast divorci para gjerdekut, me lejueshmërinë e faljes së mehrit pa kërkuar lejen e askujt, gjë që mbështet pavarësinë e saj financiare.

Në lidhje me dy ajetet e sipërpërmendura, Ibën Betali ka thënë: *“Kështu u vërtetua, se kushdo që është i pjekur, veprimi në pasurinë e tij është i drejtë ashtu siç dëshiron. I Lartmadhërishmi thotë: “Grave jepuani dhuratën e kurorës së tyre (niqahin) më të mirë.” Allahu ia lejoi bashkëshortit atë që gruaja ia jep me vullnetin e saj. Gjithashtu thotë: “E nëse i lëshoni ato para se të keni kontakt intim me to, por u keni pas caktuar atyre një shumë të mehrit (pajë nusërie), atëherë duhet t’u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveç nëse ato ju falin ose ju falë ai në duart e të cilit është lidhja e kurorës. E të falni (burra ose gra) është më afër devotshmërisë, e mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush. Vërtet, Allahu sheh atë që vepron.”*⁵

Allahu ia lejoi asaj faljen e pasurisë së saj pasi bashkëshorti i saj ta ketë divorcuar pa leje nga askush, kjo tregon lejueshmërinë e veprimit të gruas në pasurinë e saj, dhe se ajo në të është në mënyrë të barabartë po si burri. Ata (dijetarët) argumentuan me urdhërimin e Esmes nga Pejgamberi a.s. për të dhënë lëmoshë dhe nuk e urdhëroi atë që të kërkonte leje nga Zubejri r.a., (bashkëshorti i saj) dhe se Mejmunja r.a., e liroi robëreshën e saj dhe nuk kërkoi lejen e Pejgamberit a.s.. Gjithashtu, me hadithin e Ibën Abasit r.a., se Pejgamberi a.s. iu drejtua grave në ditën e Bajramit dhe u tha atyre: *“Jepni*



sadaka, qoftë edhe nga stolitë tuaja”, dhe nuk ka asnjë hadith që (tregon se) ato kanë kërkuar leje prej bashkëshortëve të tyre, dhe as që i Dërguari i Allahut a.s. i ka urdhëruar që të kërkojnë leje prej tyre. Nuk ka mospajtim se testamentet e saj nga një e treta e pasurisë së saj janë të lejuara po si testamentet e burrit dhe bashkëshorti nuk ka asgjë në dorë në këtë. Këtë e thotë Libri, që është thënia e të Plotfuqishmit: “*pasi të kryhet testamenti i tyre dhe pasi të lahet borxhi.*”⁶

Nëse testamentet e saj në një të tretën e pasurisë së saj janë të lejueshme pas vdekjes së saj, atëherë veprimet e saj në pasurinë e saj gjatë jetës së saj janë me të lejueshme.⁷

Të drejtën e pronësisë së gruas dhe veprimit në të, e dëshmon gjithashtu ajeti: “*Provoni bonjakët derisa të bëhen për martesë, e nëse vëreni te ta pjekuri, atëherë dorëzoni atyre pasurinë e tyre.*”⁸

Zoti i Madhëruar i bëri të barabartë burrat dhe gratë në arritjen e pubertetit dhe shfaqjen e pjekurisë, si dhe urdhëroi që t’u jepet pasuria e tyre dhe nuk e ka veçuar burrin nga gruaja, kështu që vërtetohet se kushdo që është në pjekuri të shëndoshë, mund të veprojë me pasurinë e tij sipas dëshirës.⁹ Kjo është kështu ngase, atij që duhet t’i dorëzohet pasuria e vet për shkak të pjekurisë së tij, s’ka dyshim se atij i lejohet të veprojë në të pa lejen e askujt. Kjo është e dukshme se nëse vajza është jetime dhe pastaj rritet dhe është e pjekur, ajo mund të veprojë në pasurinë e saj.

Ndërsa ndër hadithet, që e dëshmojnë këtë të drejtë të gruas, për të mos u zgjeruar, përmendim hadithin, ku i Dërguari i Allahut a.s. thotë: “*Jepni lëmoshë, o gra qoftë edhe nga stolitë tuaja,*”¹⁰ ato filluan t’i hedhin vathët dhe qaforët e tyre.¹¹

Zejnebja, bashkëshortja e Abdullah ibën Mesudit r.a., dhe një grua tjetër e quajtur me po këtë emër, erdhën te Pejgamberi a.s., dhe e pyeten për lëmoshën, a ju lejohet t’u japin lëmoshë bashkëshortëve dhe jetimëve të tyre? Ai tha: “*Për ata ka dy shpërblime: shpërblimi i mbajtjes së lidhjeve familjare, dhe shpërblimi i sadakasë.*”¹²

Në këtë hadith, vërtetohet se gruaja ka të drejtë pronësie si dhe lirinë për të vepruar në këtë pronë pa iu referuar lejes së askujt, dhe

Gruaja ka të drejtë pronësie si dhe lirinë për të vepruar në këtë pronë pa iu referuar lejes së askujt, dhe tregon se ajo në adhurimet financiare është tamam si burri, ngase ato dhanë sadaka dhe i Dërguari a.s. ua pranoi sadakanë dhe nuk pyeti nëse sadakaja ishte e ndonjë vajze të re apo e ndonjë gruaje të martuar.

tregon se ajo në adhurimet financiare është tamam si burri, ngase ato dhanë sadaka dhe i Dërguari a.s. ua pranoi sadakanë dhe nuk pyeti nëse sadakaja ishte e ndonjë vajze të re apo e ndonjë gruaje të martuar, se ajo sadaka ishte nga një e treta apo më shumë, se i ishte kërkuar leje burrit apo jo?! Po të kishte qenë një domosdoshmëri, i Dërguari i Allahut a.s., nuk do ta linte dhe ky ishte veprimi i fundit që e bëri ai a.s..

Argumentet në lidhje me këtë janë të shumta, por ne mjaftohemi me këto.

Mbështetur në këtë, toka apo ajo gjë që është blerë me pasurinë e saj konsiderohet pronë e saj dhe ajo ka të drejtë ta regjistrojë atë në emër të vet në mënyrë që ta vërtetojë dhe dokumentojë pronësinë e saj. Ajo mund të zotërojë atë që i është dhënë ose atë që ka blerë me pasurinë e saj dhe të veprojë më të si të dëshirojë përderisa nuk bie në kundërshtim me rregullat e sheriatit.

Është me rendësi të përmendet, se gjersa Islami i bëri drejtësi gruas duke i siguruar asaj të drejtat e saj financiare në këtë mënyrë unike, gruaja në Evropë vetëm kohët e fundit ka krijuar juridiksion financiar të pavarur. Mjafton të dimë se arsyet e kufizimit (ndalimit të kompetencave ligjore) në legjislacionin islam janë: të qenët i mitur dhe çmenduria, ndërsa në të drejtën romake, dhe në ligjin francez deri në vitin 1938, ishin: të qenët i mitur, çmenduria dhe feminiteti.

Ligjet e Evropës “të qytetëruara” e privonin gruan nga të gjitha këto të drejta deri kohët e fundit, dhe rrugën e saj të vetme për të arritur tek ato të drejta e kishin bërë nëpërmjet burrit, bashkëshort qoftë, baba apo kujdestar. Pra, për shumë shekuj pas Islamit, gruaja evropiane nuk kishte të drejtat që ia dha Islami, madje dhe pas zotërimit të tyre, ajo nuk i mori lehtë dhe nuk e ruajti moralin, nderin dhe dinjitetin e saj, por iu desh të sakrifikoje gjithçka që kishte dhe të duronte djersën, gjakun dhe lotët, në mënyrë që të arrinte diçka nga ajo që Islami ia dha vullnetarisht dhe që nga fillimi, jo duke iu nënshtruar nevojshmërisë ekonomike, as duke iu nënshtruar konfliktit të vazhdueshëm mes qenieve njerëzore, por me miratim prej tij për



të vërtetën e përjetshme dhe drejtësinë, dhe zbatimin e tyre në realitet, jo në botën e idealeve dhe ëndrrave.

Në lidhje me të drejtën e gruas myslimane në pronë dhe veprimin me të dhe asaj jomyslimane në të kaluarën dhe të tanishmen, Sejid Kutubi, kur bënë interpretimin e ajetit: *“Burra ju takon hise nga ajo që fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato”*,¹³ thotë: “E regjistrojmë këtu të drejtën e pronës individuale që ia dha Islami gruas në këtë tekst, të drejtë që injoranca arabe – po ashtu si injorancat e tjera të lashta – e kishte shkelur dhe nuk ia njihte atë gruas – përveçse në raste të rralla – dhe akoma vazhdon të mashtror për ta shkelur. Vetë gruaja ishte diçka që trashëgohej po si plaçka! Kjo është e vërteta që injorancat moderne, të cilat pretendojnë se u kanë dhënë gruas të drejta dhe respekt që asnjë program tjetër nuk ua ka dhënë atyre kanë vazhduar me padrejtësi. Disa i bëjnë trashëgimi trashëgimtarit më të madh mashkull, disa e bëjnë lejen e kujdestarit të domosdoshme për të nënshkruar çfarëdo kontrate për gruan në lidhje me pasurinë, dhe e bëjnë lejen e burrit të domosdoshme për çdo disponim financiar të bashkëshortes në pasurinë e saj. Kjo ndodhi pas revolucioneve dhe lëvizjeve të shumta të grave dhe anomalive që rezultuan prej tyre në të gjithë sistemin ligjor që ka të bëjë me gruan, pastaj në sistemin familjar dhe në platformën e përgjithshme morale.

Ndërsa sa i përket Islamit, ai ia ka dhënë këtë të drejtë që në fillim dhe pa kërkesën e saj, pa revolucion, pa shoqata grash dhe pa anëtarësim në parlament. Kjo e drejtë i është dhënë në përputhje me pikëpamjen e tij të përgjithshme për nderimin e qenies njerëzore në tërësi, nderimin e dy pjesëve të një veteje, të ngritjes së gjithë sistemit të tij shoqëror në

bazë të familjes dhe të mbajtjes së atmosferës së familjes me përzemërsi, dashuri dhe garanci për secilin anëtar të familjes. Prandaj, prej këtu barazia e së drejtës për të zotëruar pronën dhe e drejta për të fituar mes burrave dhe grave ishte i lidhur me parimin e përgjithshëm.¹⁴

Krejt në fund themi se e drejta e pavarur financiare e gruas që i është dhënë asaj nga Islami është një tregues i qartë i respektit të Islamit për mendjen dhe aftësitë e saj. Kufizimi (ndalimi i kompetencave ligjore) në Islam është vetëm për dy arsye: të qenët i mitur, mashkull qoftë apo femër, dhe ata dy në këtë janë të barabartë, dhe kjo nga frika e paafetësisë së tyre për të menaxhuar punët e tyre për shkak të mungesës së aftësive të tyre mendore dhe pa plotësisë, dhe arsyeja tjetër, çmenduria, ku i çmenduri nuk ka aftësi mendore që i mundëson atij të drejtojë dhe të menaxhojë punët e tij.

Nëse marrim parasysh dimensionin kohor të ligjit islam dhe dhënien e të drejtës së gruas për disponim prone, na bëhet e qartë se deri në çfarë mase Islami respekton mendjen e gruas dhe se ajo është qenie njerëzore e plotë.

1 El Buhari, nr: 4913, 6/157, Muslimi, nr: 1479, 2/1108.

2 En Nisa, 4.

3 El Bekareh, 237.

4 El Bekareh, 229.

5 El Bekareh, 237.

6 En Nisa, 12.

7 Sherh Sahihi el Buhari i Ibën Bettalit, 7/108.

8 En Nisa, 6.

9 Sherh Sahihi el Buhari, 7/108-109.

10 El Buhari, nr: 1466, 2/122, Muslimi: 100, 2/694.

11 Koment i Buhariut, 2/116, Muslimi, nr: 1000, 2/694.

12 El Buhari, nr: 1466, 2/116 dhe 2/121, Muslimi, nr: 1000, 2/694.

13 En Nisa, 32.

14 Fi dhilali el Kuran, 2/645.

Natyra juridike e borxhit sipas të drejtës islame

Argjent Xheladini

Borxhdhënia është mënyrë afrimi tek Allahu i Lartësuar, sepse në të shprehet dhembshuria për njerëzit dhe mëshira për ta, si dhe lehtësimi i punëve dhe i vështirësive që ata kanë.

HYRJE

Borxhi-huaja është prej çështjeve të njohura në mesin e njerëzve dhe se në të drejtën islame përveç që është vepër e lejuar, ajo konsiderohet si vepër e rekomanduar (mendub), duke u mbështetur në tekstet kuranore dhe në hadithet e të Dërguarit a.s.. Ligjshmërinë e borxhit e gjejmë në ajete kuranore, në hadithe si dhe në konsensusin e dijetarëve (ixhma).

Në kuptimin gjuhësor, borxh do të thotë prerje¹, është quajtur kështu për shkak se pasuria e dhënë te borxhmarrësit është një pjesë nga pasuria e borxhdhënësit.² Ndërkaq, në atë terminologjik, është ajo pasuri që borxhdhënësi ia jep borxhmarrësit, me kusht që ngjashëm t'ia kthejë atij kur të ketë mundësi.³

NATYRA JURIDIKE E BORXHIT

Borxhi është bërë legjitim me Kuran, Sunet dhe me konsensus të dijetarëve, për shkak të nevojave të njerëzve në marrëdhëniet e tyre reciproke, ngase ndodh që njeriu të varfërohet dhe ndien nevojë për gjëra të domosdoshme për ekzistencën e tij, atëherë ai kërkon borxh për të përmbushur nevojat e tij, e që më pas ta kthejë atë në të njëjtën masë.⁴

Borxhi konsiderohet vepër e pëlqyer (mustehab) për borxhdhënësin, bazuar në fjalët e Allahut xh.sh.: “Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë e që Ai t’ia

shumëfishoj atë dhe ai ka një shpërblim të mirë.” (El Hadid, 11).

Borxhdhënia është mënyrë afrimi tek Allahu i Lartësuar, sepse në të shprehet dhembshuria për njerëzit dhe mëshira për ta, si dhe lehtësimi i punëve dhe i vështirësive që ata kanë. Duke qenë se Islami e ka pëlqyer dhënien e borxhit, ai, gjithashtu, ia ka lejuar nevojtarit të kërkojë borxh dhe nuk e ka konsideruar atë pjesë të kërkesës së papëlqyer, pasi ai e merr këtë pasuri që të përfitojë prej saj, për të kryer nevojat e veta, e më pas t’ia kthejë atë kujt i takon.⁵

Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Kush ia lehtëson një myslimani një brengë nga brengat e kësaj jete, Allahu do t’ia lehtësojë atij një brengë prej brengave të Ditës së Kiametit. Kush ia lehtëson barrën një nevojtarit në këtë botë, Allahu do t’ia lehtësojë atij në dynja dhe ahiret, e kush ia fsheh një të metë një myslimani në këtë botë, Allahu do t’ia fshehë atij në dynja dhe ahiret. Allahu është çdoherë në ndihmën e rob-it, gjersa rob-i jetë në ndihmën e vëllait të tij.”⁶ Nga Ibën Mesudi transmetohet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Çdo mysliman që i jep dy herë borxh një myslimani, është sikur t’i ketë dhënë atij një herë sadaka.”⁷

Sa i përket konsensusit (ixhmait) të dijetarëve, themi se ata janë të dakorduar se borxhi është i lejuar në Islam. Ebu Derdaja ka thënë: “Sikur t’i jap ndokujt dy dinarë që pastaj

të mi kthejnë ata, ky veprim është më i dashur për mua sesa me ata dy dinarë t'i jap sadaka, ngase borxhi është çlirim ndaj vëllait mysliman, zbatim ndaj nevojës së tij, ndihmë ndaj tij, ndaj është i preferuar për borxhdhënësin ashtu siç është sadakaja, por nuk është obligim i domosdoshëm.” Imam Ahmedi ka thënë: “Nuk është mëkat për ndokënd që i kërkohet borxh e nuk jep.”⁸

OBLIGIMI I KRYERJES SË BORXHIT

S'ka dyshim se borxhi është një vepër e mirë dhe ai i liron njerëzit nga vështirësitë e tyre, por nga borxhmarrësi, ai (borxhi) duhet të kthehet në afatin e parashikuar (përcaktuar), apo sipas mundësive ngase ai është amanet, e amaneti një ditë duhet të kthehet në vend. Allahu xh.sh. thotë: “Allahu ju urdhëron që t’ua jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me drejtësi mes njerëzve...” (En Nisa, 58). Borxhi madje e mban njeriun e vdekur peng, gjersa të kryhet ai, ndaj është mirë që të bëhet kujdes e të kryhet sa më shpejt, e të mos neglizhohet. Një njeri e kishte pyetur Pejgamberin a.s.: “O i Dërguari i Allahut, nëse vritem në rrugën e Allahut, a më falën mëkatet e mia? I Dërguari i Allahut ia ktheu: “Po, nëse mbytesh në rrugën e Allahut si durimtar dhe llogaritës në shpërblim, duke luftuar e mos ikur mbrapa, me përjashtim të borxhit, ngase Xhibrili ma tha mua këtë.”⁹

Kurse në një rast tjetër, një njeri e kishte pyetur Pejgamberin a.s. për një vëlla të tij që kishte vdekur dhe kishte pasur borxh, atëherë Pejgamberi a.s. i tha atij: “Ai është i prangosur për shkak të borxhit të tij, ndaj kryeja borxhin atij.”¹⁰

PRITJA DHE AFATIZIMI I BORXHIT

Është mirë që të pritët borxhliu sipas mundësive të tij, e nëse kërkon afatizim, t'i mundësohet atij, ngase pa dyshim që për këtë ka shpërblim për borxhdhënësit. Për këtë porositi Allahu xh.sh. kur thotë: “Po në qoftë se ai (borxhliu) është në gjendje të vështirë, atëherë bëni një pritje derisa të vijë në një çlirim. E t’ia falni (borxhin) në emër të lëmoshës, ajo nëse e dini, është shumë më e mirë për ju.” (El Bekare, 280).



Borxhi e mban njeriun e vdekur peng, gjersa të kryhet ai, ndaj është mirë që të bëhet kujdes e të kryhet sa më shpejt, e të mos neglizhohet.

Në një hadith thuhet: Ka thënë Pejgamberi a.s.: “Kush dëshiron që Allahu t’i bëjë hije me hijen e Tij, le ta presë (afatizojë) borxhliun e gjendjes së vështirë, apo le t’ia falë atë.”¹¹

Unë si përmbarues, (i autorizuar nga shteti për ekzekutimin e borxheve), në punën time shpeshherë ndodhë që borxhlinjtë t’i pres deri sa t’i krijojnë mundësitë për pagesën e borxhit që kanë. Në lëndën përmbarimore P.nr.18/23, borxhliu, edhe pse ka lidhur marrëveshje me përmbaruesin për pagesën e borxhit me këste, i njëjti më ka thënë se për momentin nuk kam mjete për ta paguar këstin dhe ia kam mundësuar afatizimin edhe për një muaj. Ngjashëm si kjo lëndë kam edhe shumë të tjera dhe këtë gjithmonë e bëjë duke shpresuar në shpërblimin e Allahut xh.sh., duke u bazuar në ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit a.s..

Borxhi nuk duhet të sjellë përfitim - Ajo që duhet theksuar këtu te borxhi është fakti që borxhi nuk duhet të sjellë përfitim, por të kthehet sipas sasisë apo vlerës së marrë, përndryshe kalon në kamatë, ngase me borxh synohet ndihma e njerëzve dhe lehtësimi në punët e tyre, e jo të bëhet borxhi si mjet shfrytëzimi e përfitimi. Një rregull e jurisprudencës thotë: Çdo borxh që sjell fitim (dobi), konsiderohet kamatë. Ndalesa këtu është e kufizuar me

kushtëzimin e dobisë prej borxhit dhe nëse kjo është bërë traditë.¹² Mirëpo, nëse nuk është e kushtëzuar dhe nuk është traditë e njohur, i lejohet borxhmarrësit që t'ia rikthejë edhe më mirë sesa që ka marrë, bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s., ku kishte marrë borxh një deve, e pastaj e kishte urdhëruar Ebu Rafiin t'ia kthejë atij një deve nga devetë e zekatit, por kur ai nuk gjeti të ngjashme, e ktheu një më të mirë, me urdhrin e Pejgamberit a.s..

Kushtëzimi i afatit në borxh - Sipas shumicës së juristëve myslimanë, nuk lejohet kushtëzimi i afatit në borxh, e nëse e jep borxhin me afat të kushtëzuar, atëherë ai duhet të kthehet, por imam Maliku ka mendim tjetër, ai thotë se lejohet kushtëzimi i afatit dhe kushti i vënë është i detyrueshëm. Nëse përcakton borxhin për një afat të caktuar, kjo gjë lejohet dhe borxhdhënësi nuk ka të drejtë ta kërkojë atë, derisa të plotësohet afati,¹³ sepse Allahu xh.sh., thotë: "...kur merrni hua prej njërit-tjetrit për një afat të caktuar shkruajeni atë..." (El Bekare, 282), gjithashtu bazohet edhe në hadithin ku Pejgamberi a.s. ka thënë: "Myslimanët i respektojnë (qëndrojnë sipas) kushtet e tyre."¹⁴ Mendimin e imam Malikut e përkrahin edhe shumë dijetarë të kohës sonë, njëri prej tyre edhe Vehebeh Zuhejli, i cili e sheh këtë mendim logjik dhe të përshtatshëm me kohën aktuale.

NË ÇKA LEJOHET BORXHI?

Sipas hanefive, borxhi lejohet në ato gjëra që mund të maten dhe peshohen, si dhe ato që mund të numërohen si vezët, gruri, monedhat, buka, e nuk lejohet në gjëra të tjera, si në shtazë, pasuri të paluajtshme, etj., për shkak të pamundësisë së kthimit të sasisë së ngjashme me të. Hanefitë e kushtëzojnë që të kthehet e ngjashme me atë që merret, përndryshe nuk e lejojnë. Sipas tyre, nëse një njeri ka marrë hua 1kg mish për pesë euro, e në kohën e kthimit mishi lirohet nga pesë euro në dy euro, atëherë ai detyrohet t'ia kthejë pesë euro. Ngjashëm veprohet edhe me gjërat e tjera. Ndërsa mailikitë, shafitë dhe hanbelitë, janë të mendimit se borxhi lejohet në të gjitha ato që lejohet edhe paradhënia, duke e lejuar në gjëra që maten e peshohen si gjërat ushqimore, apo edhe në gjëra të tjera që nuk maten e nuk peshohen si pasuritë e ndryshme të paluajtshme, shtazët dhe të ngjashme me to. Mendimin e mbështesin në hadithin, sipas të cilit Pejgamberi a.s., kishte marrë borxh një deve, e

thonë se ajo ishte marrë hua pa matur e pa peshuar, por në bazë të përshkrimit.¹⁵

PËRFUNDIM

Pa dyshim që lutjet drejtuar Allahut janë gjëja më e rëndësishme që të na mundësohet pagesa e borxhit. Transmetohet nga Ebu Seid el Hudriu r.a., i cili ka thënë: "Një ditë i Dërguari i Allahut a.s. kishte hyrë në xhami, ku ishte i ulur njëri prej ensarëve, i cili njihej si Ebu Umamete. Në atë rast i Dërguari a.s. i pati thënë: "Çfarë ke që po qëndron ulur në xhami, kur nuk është koha e namazit?" Ai u përgjigj: "Më ka kapluar mërzia e borxheve, o i Dërguari i Allahut!" "Ki mendjen, a dëshiron të të mësoj ty diçka që, kur ta thuash, Allahu i Lartësuar do të largoj prej teje mërzinë dhe do ta mundësojë të paguash borxhet" – i tha. Ai u përgjigj: "Po, si jo!" Atëherë i Dërguari a.s. i tha: "Kurdo që të zgjohesh në mëngjes dhe kurdo që të biesh në gjumë, thuaj: "O Zoti im, kërkoj mbështetje te Ti, që të më largosh brengën dhe pikëllimin, kërkoj mbështetje te Ti, që të më mbrosh prej plogështisë dhe përtacisë, kërkoj mbështetje te Ti, të më largosh frikën dhe koprracinë, kërkoj mbështetje te Ti, të më ndihmosh të paguaj borxhet dhe të më mbrosh nga shtypja e njerëzve!" Tha: "E thashë këtë dua, dhe Allahu ma mundësoi të paguaj borxhet dhe më largoi mërzinë."

1 El Xhevheri, *Es Sihah fil-lugati*, vëll. V, fq. 71.

2 Vehebeh Zuhejli, *El Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3786.

3 Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll.III, fq. 249.

4 Ejup Haziri, *Fikh, E drejta civile Islame*, Prishtinë, 2014, fq. 77.

5 Sejid Sabik, op. cit., fq. 249.

6 Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr.1853; Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. 221.

7 Ibni Maxhe.

8 Ejup Haziri, op. cit., fq. 79.

9 Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr.1634.

10 Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr.2424.

11 Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr.2410.

12 Sejid Sabik, op. cit., fq. 251.

13 Ibid, fq. 250.

14 Buhari në Sahihun e tij, nr.2112.

15 Ejup Haziri, op. cit., fq. 84.

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (2)

MUHTESARI I TAHAVIUT

Hazir D. Selmani

Në periudhën e shekujve III-IV hixhri, u shkruan 3 *muhtesarët* e parë të fikhut hanefi. I pari prej tyre llogaritet *Muhtesari i Tahaviut*. Pastaj pas tij vijnë *Muhtesari i Kerhit* dhe *Muhtesari i Hakim Shehidit*. Të tre këta *muhtesare* më vonë u komentuan gjerësisht dhe u kthyen në *mutun* (doracakë) jashtëzakonisht shumë të rëndësishëm të fikhut hanefi.


SI ERDHI DERI TE SHKRIMI I MUHTESARËVE TË FIKHUT?

Shekulli i II hixhri llogaritet periudha kur fikhu islam filloi të shkruhej në libra të posaçëm. Fakihi i parë i cili shkroi fikhun ndaras nga shkencat e tjera është Muhamed b. Hasen Shejbani, nxënësi i Ebu Hanifes. Ai këtë gjë e bëri në shumë libra të tij. Libri më i njohur i tij padyshim se është vepra *El Mabsut*, që ndryshe njihet edhe si *El Asl*. Në modelin e kësaj vepre, Shafi'u shkroi veprën *El Umm*, ndërsa Sahnuni veprën *El Mudevveneh*, që është libri themelor i fikhut maliki.¹ Vetë titulli *El Umm* i veprës së imam Shafiut ka ngjashmëri të madhe me titullin *El Asl* të veprës së Shejbanit. Prej kuptimeve të fjalës *El Umm*, krahas kuptimit nënë janë edhe këto kuptime të tjera: prejardhje, origjinë, zanafillë, pikënisje, burim, gurrë, bazë, themel, etj., e që shumicën e këtyre kuptimeve i ngërthen edhe vetë fjala *El Asl*, që në shqip përkthehet si:

origjinë, prejardhje, fillesë, gjenezë, burim, gurrë, bazë, bazament; themel, etj.²

Vepra *El Asl* e Shejbanit për nga vëllimi është shumë e madhe. Mendohet se fillimisht kapitujt e saj ishin libra në vetvete, d.m.th. dalin diku 75 libra që u njohën si *El Usul*, të cilat libra-kapituj më vonë Shejbani i bashkoi

Fakihi i parë i cili shkroi fikhun ndaras nga shkencat e tjera është Muhamed b. Hasen Shejbani, nxënësi i Ebu Hanifes. Ai këtë gjë e bëri në shumë libra të tij. Libri më i njohur i tij padyshim se është vepra El Mabsut, që ndryshe njihet edhe si El Asl.



Vepra El Mabsut

në një libër të vetëm dhe ajo u njoh me titullin *El Asl*. Kjo vepër tani në botimin e fundit të Katarit ka 12 vëllime me gjithsej afër 7000 faqe. Pastaj, vepra *El Umm* e Shafiut në njërën prej botimeve të saja ka 11 vëllime, prej të cilëve 7-8 vëllime janë fikh. Ndërsa *El Mudevveneh* e Sahnunit në botimin e Saudisë ka 16 vëllime. Po të kihet parasysh kjo që u tha, shumë lehtë kuptohet se në periudhën e shekujve II-III hixhri ishte vështirë sigurimi i një kopjeje të plotë të këtyre veprave, kopjimi i tyre për bibliotekat personale, ruajtja, transporti, referimi në debate dhe libra si dhe sjellja e tyre në mexhliset dhe hallkat e fikhut. Pastaj të mos flasim për mësimin e tyre nga të rinjtë e të rejtat që ndiqnin udhën e dijes dhe se sa kohë do t'i duhej një mësuesi që ta shpjegonte deri në fund një vepër kaq të madhe, etj.. Kjo gjë solli që dijetarët e brezave të rinj të mendonin që materialin e këtyre veprave ta shkurtonin, kuptohet me ruajtje të tërësishme të domethënies së tyre, duke hequr përsëritjet e duke e ngjeshur fort mirë fjalinë me fjalë të përpikta dhe mjaft precize, si dhe duke hequr në shumicën e rasteve argumentet e sidomos zinxhirët e transmetuesve. Kjo solli që libra e libra të mëdhenj të shkurtoheshin nga qindra fletore dorëshkrimesh në disa fletore, e që lehtësisht mund të barteshin dhe të siguroheshin, si dhe shumë më shkurt mund të përfundohej studimi i tyre para një mësuesi të fikhut. Kështu pra lindën librat e fikhut që do të njihen me termin *muhtesar*.

MUHTESARËT E PARË FIKHOR NË HISTORINË ISLAME

Të parët që sollën këtë risi mendohet se janë malikitë, pastaj shafitë dhe të tretët hanefitë. Dijetari i parë që shkroi një vepër të llojit *muhtesar* del se është fakihu maliki Ibën Abdulhakem (jetoi në periudhën 154-214 hixhri). Ibën Abdulhakemi shkroi 3 libra të këtij lloji: *El Muhtesar el Kebir*, *El Muhtesar el Evset* dhe *El Muhtesar el Sagir*. Kadi Ijadi për veprat e tija thotë: “Njerëzit (dijetarët e fushës) u morën me muhtesarët e tij si me asnjë libër tjetër të librave medhhebore, kuptohet pas *El Muvettasë* dhe *El Mudevvenesë*.”³ Pastaj prej shafive, i pari që shkroi një vepër të llojit *muhtesar* llogaritet Buvejtju, nxënësi i Shafiut dhe pas tij, Muzeniu, nxënësi tjetër shumë i afërt i Shafiut. Më vonë vepra *Muhtesar i Muzeniut* do të kthehet si njëri ndër 5 librat bazë të fikhut shafi. Ndërsa te hanefitët, sipas Afganiut ishte Tahaviu që shkroi librin e parë të llojit *muhtesar*.⁴ Për habi, *muhtesarët* e parë fikhor lindën në Egjipt, ngase të tre këta dijetarë jetuan dhe vepruan në Egjipt.

Tahaviu ishte prej muxhtehidëve mutlak që ruajti përkatësinë e tij ndaj Ebu Hanifes. Sipas kësaj del sa ka qenë thujse në po atë derexhe fikhore të Ebu Jusufit dhe Shejbanit.

RRUGA QË ÇOI DERI TE MUHTESARI I TAHAVIUT

Muzeniu i sipërpërmendur kishte një motër fakihe-juriste, e cila kishte ndjekur mexhlin e imam Shafiut.⁵ Ajo u martua dhe burri i saj ishte njeri i edukuar dhe njihte mirë poezinë arabe. Nga kjo martesë, në fshatin Taha të Munjes në vitin 239 hixhri lindi djali i tyre, të cilit ia lanë emrin Ahmed. Shkaku i vendlindjes së tij filloi të njihet si Ahmed Tahavi dhe më vonë si Ebu Xhafer Tahavi. Ky djalosht sigurisht se mësimet e para i mori nga këta dy. Pastaj filloi me ndjekjen e mexhlisit të dajës së tij, Muzeniut, nxënësit më të dashur dhe më të dalluar të imam Shafiut. Ky mexhlis zhvillohej në shtëpinë e Muzeniut. Tahaviu pasi u rrit u largua nga ky mexhlis si dhe nga tërë medhhebi i shafive dhe kaloi në atë të hanefive. Shkaqet e këtij ndërrimi medhhebor nuk janë edhe shumë të qarta. Thuhet se ishte zemërimi pas një qortimi nga daja i tij, Muzeniu. Mirëpo, Keutheriu në librin e tij *El Havi* mjeshtërisht dhe me kriteret e hadithologëve i hodhi poshtë gjitha thashethemet duke argumentuar se shkaku kryesor ishte ai shkencor dhe se kureshtja dhe hulumtimi ishin shkaqet që e çuan Tahaviun të gjurmonte medhhebin hanefi dhe pastaj edhe të kthehej në medhhebin e tyre.⁶ Megjithatë, duket se

pati diçka mes nipit dhe dajës edhe pse sigurisht se nuk ishte kjo që çoi në ndërrimin medhhebor. Tahaviu pasi u largua nga Muzeniu filloi të mësonte nga hanefiu, Bekar b. Kutejbeh, nga i cili transmeton me të madhe hadith si dhe hanefiu tjetër Ahmed b. Ebi Imran, nga i cili e përvetësoi fikhun hanefi dhe prej të cilit pati përfituar shumë dituri fikhore.⁷ Në vitin 268 hixhri udhëtoi për në tokat e Shamit (Levant), ku qëndroi afër 1 vjet. Atje edhe u takua e përfitoi dituri nga kryegjykatësi i madh hanefi, kadi Ebu Hazim. Këta ishin mësuesit e tij kryesor. Pas vdekjes së dajës së tij, Tahaviu duke imituar stilin e dajës në librin e tij, si dhe duke parë nevojën e madhe në mesin e hanefive për një libër të këtillë si të Muzeniut, ai shkroi librin e tij fikhor të njohur si *Muhtesar Tahavi*. Tahaviu ishte njeri i lapsit dhe gjithsej shkroi rreth 30 vepra, shumica e të cilave janë të humbura dhe vetëm një pjesë e tyre ekzistojnë dhe fatmirësisht janë edhe të botuara. Ai ishte *historian* dhe *shurutij* i madh (noter i lartë sheriatik), *mufesir* i kalibrit të Taberit dhe vepra e tij e botuar pjesërisht me titull *Ahkam el Kuran* dëshmon më së miri këtë gjë. Njëherësh kjo vepër llogaritet edhe si tefsiri i parë tematik në islam. Ai ishte *muhadith* dhe *fakih* i derexheve më të larta. Veprat hadithore, *Sherhu Meani'l-Athar* dhe *Sherhu Mushkili'l-Athar* janë fenomenale si në shkencat hadithore ashtu edhe në fikhun e hadithit. Libri tjetër i tij i akides është vepra kryesore



dhe më e sigurt e akides islame. Dhehebiu në Sijerin e tij, Tahaviun e cilëson kështu: “*Alamet imami, hafëzi i madh e muhadithi dhe fakihu i Egjiptit*.”⁸ Muhadithi i madh, Ibën Ethiri, atë e numëron si njërin prej përtëritësve (ar. *el-muxhedid*) të fesë në shekullin e III hixhri.⁹ Ndërsa në medhhebin hanefi ai gëzon rangjet më të larta në hierarkinë e fukahave hanefi. Sipas disave ai zë vend në nivelin e *muxhtehidëve të meseleve*, e që është niveli i tretë i fukahave. Ndërsa sipas fjalëve të Keutheriut, Tahaviu ishte prej *muxhtehidëve mutlak* që ruajti përkatësinë e tij ndaj Ebu Hanifes.¹⁰ Sipas kësaj del sa ka qenë thujse në po atë derexhe fikhere të Ebu Jusufit dhe Shejbanit. Pas një jete gati një shekullorë, Tahaviu vdiq në vitin 321 hixhri në moshën 82 ose 92 vjeçare dhe u varros në Karrafeh. Rreth 37 vjet pas vdekjes së tij, *Dinastia Fatimite* morën Egjiptin dhe themeluan Kajron. Me këtë edhe iu dha fund shkollave të para sunitë të Egjiptit që d.m.th. u shua edhe medreseja e madhe e hanefive të Egjiptit. Prandaj, pas Tahaviut nuk pati më ndonjë tjetër në nivelin e tij shkencor që doli nga ato troje.

MUHTESARI I TAHAVIUT DHE KOHA E SHKRIMIT TË TIJ

Në mesin e tridhjetë veprave të jashtëzakonshme të Tahaviut, u përmend edhe Muhtesari i tij fikhor. Sajmeriu shënon se kjo vepër është edhe libri i parë që shkroi Tahaviu dhe se pas shkrimit të tij ai pati deklaruar: “*Allahu e mëshiroftë Ebu Ibrahim (Muzeniun)! Sikur të ishte gjallë tani, ai do të bënte qefaret për betimin e tij*.”¹¹ Pra, del se diç pati thënë Muzeniun për të! Edhe pse disa dijetarë të tjerë që janë kronistë hanefi të më vonshëm janë të mendimit se libri i tij i parë ishte vepra *Sherhu Meani'l-Athar*,¹² mirëpo deklarata e Sajmeriut ka më tepër përparësi, kjo kur kihet parasysh se Sajmeriu jetoi dy-tre breza pas Tahaviut. Deklarata e

Sajmeriut tregon edhe kohën e përafërt të shkrimit të kësaj vepre dhe ajo është pas vdekjes së Muzeniut. Vdekja e Muzeniut ishte më 24 ramazan 264 hixhri.¹³

SA VERSIONE TË MUHTESARIT FIKHOR PATI SHKRUAR TAHAVIU?

Një numër i madh i kronistëve hanefi, si Sajmeriu, Kutlubuga, Ibën Hinai, Kefeviu, Lekneviu, etj.,¹⁴ kur bëjnë numërimin e veprave të Tahaviut, ata përmendin vetëm një Muhtesar të tij fikhor. Bibliografi i madh, Ibën Nedimi, regjistron dy vepra të Tahaviut me emrin El Muhtesar, njëra e madhe dhe tjetra e vogël dhe më qëndrimin e tij pajtohet edhe Haxhi Halifeja.¹⁵ Nga ana tjetër, Kurashiu krahas *Muhtesarit* fikhor të Tahaviut shënon edhe dy libra tjerë me titujt *El Muhtesar el Kebir* dhe *El Muhtesar el Sagir*. Po këtë gjë e shënon edhe mulla Ali Lexuesi. Madje, bile Afganiu shton dhe thotë se, kopja që ai nxori nga dorëshkrimi në botim është versioni i mesëm i *Muhtesarit* të Tahaviut.¹⁶ Haxhi Halifeja duke u bazuar te Kurashiu dhe ky i fundit duke u bazuar tek Ibën Nedimi deklarojnë se Tahaviu shkroi dy versione të *Muhtesarit*, mirëpo, teksti i Ibën Nedimit, e që është burimi më i vjetër që përmendën më shumë se një Muhtesar të Tahaviut, nuk jep për t'u kuptuar se dy veprat tjera me titullin *El Muhtesar* janë versioni të *Muhtesarit* të tij të fikhut. Ndoshta këto dy vepra janë versione të ndonjë libri tjetër, e që si zakonisht në atë periudhë autori librat e mëdhenj i shkruante edhe në një version më të vogël, ndërsa Muhtesari i tij i fikhut nuk është ndonjë libër i madh që do të duhej të shkruhej dy-tre herë. Megjithatë, mbetet për t'u krahasuar komentet e këtij Muhtesari, qofshin ata të botuar apo dorëshkrime, kjo për t'u vërtetuar se a shpjegojnë të njëjtin libër apo kanë dallime në materialin e shpjeguar dhe të komentuar.

Muhtesari i Tahaviut deri vonë ka qenë vetëm dorëshkrim. Meritën e botimit të tij për herë të parë e gëzoi Ebu'l-Vefa Afgani, i cili në vitin 1951 e botoi atë për herë të parë, edhe atë në një vëllim me 480 faqesh.

NDËRTIMI STRUKTUROR DHE BOTIMET E MUHTESARIT TË TAHAVIUT

Muhtesarin e tij fikhori, Tahaviu e shkroi në stilin dhe renditjen e *Muhtesarit* të Muzeniut, dajës së tij dhe mësuesit të tij të hershëm. Kjo gjë theksohet në shumë burime.¹⁷ Realisht po të krahasohen titujt e kapitujve të dy veprave, do të vërehet një ngjashmëri e dukshme si në emërtimet e kapitujve, ashtu edhe në renditjen e një pjese të tyre. Mirëpo, Ibën Tejmijeh, gjatë një diskutimi, kalimthi jep një deklaratë tjetër interesante në të cilën thotë se, Muzeniu në një pjesë të renditjes dhe ndarjeve ka imituar Muhamed b. Hasen Shejbanin, kur thotë: “*Hiraku imitoi Muzeniun, e ndërsa Muzeniu imitoi Muhtesarin e Muhamed b. Hasenit edhe pse*

kjo gjë ka ngjarë në disa ndarje dhe renditje...”¹⁸ Për nga ana strukturore, *Muhtesari i Tahaviut* fillimisht ka një hyrje të shkurtër dhe shumë domethënëse. Pastaj libri ndahet në kapituj (ar. kitab) si dhe temat brenda kapitullit ndahen në nën-kapituj (ar. bab). Numri i kapitujve është 58. Kur mes Ebu Hanifes dhe nxënësve ka mendime të ndryshme, ai i regjistron ato dhe ua atribuon thënësve të tyre edhe pse për disa atribuime kritikohet në mënyrë shkencore dhe me mjaftë edeb-edukatë nga Razi Xhesasi në komentin e tij. Në fund të shumë meseleve, Tahaviu shpreh edhe përzgjedhjet e tija (*ihitjaratuhu*). Në disa çështje ka edhe qëndrime të tija personale që dallojnë nga qëndrimet e Ebu Hanifes dhe nxënësve të tij. *Muhtesari i Tahaviut deri vonë ka qenë vetëm dorëshkrim. Meritën e botimit të tij për herë të parë e gëzoi Ebu'l-Vefa Afgani, i cili në vitin 1951 e botoi atë për herë të parë, edhe atë në një vëllim me 480 faqesh, ku rreth 430 faqe janë teksti i Tahaviut me fusnotat e nevojshme të Afganiut. Më vonë Muhtesari i Tahaviut pati edhe disa botime të tjera, e bile disa janë edhe më cilësor se ai i Afganiut, ngase mbështeten në më shumë dorëshkrime.*

Në gjuhën shqipe prej këtij *Muhtesari* nuk ka ndonjë përkthim as edhe të pjesshëm, e lëre më i plotë. Mirëpo, kjo nuk domethënë se në trojet tona nuk ka qenë i njohur ky doracak, ngase dorëshkrimi i këtij *Muhtesari* që ndodhet në Bibliotekën Kombëtare Universitare “Sh. Kliment Ohridski” në

Shkup tregon shumë për këtë gjë. Kjo kopje daton nga viti 591 hixhri (1195 gregorian).¹⁹

Ky *Muhtesar* dhe *metën* i famshëm i fikhut hanefi bie në grupin e doracakëve të plotë, ngase mes kapakëve ngërthen tërë kapitujt e njohur të fikhut hanefi. Shikuar nga këndi i komenteve, ai mund të klasifikohet në grupin e doracakëve të komentuar mesatarisht, ngase për të janë shkruar të paktën 10 komente (*shuruh*) nga dijetarë të ndryshëm. Si dhe shikuar nga aspekti i burimit të materialit, *Muhtesari i Tahaviut* është punim origjinal brenda kornizave të medhhebit hanefi që nuk bazohet direkt në ndonjë veprë konkrete paraprake. *Muhtesari i Tahaviut* edhe si *metën* edhe bashkë me komentarët (*shuruh*) citohet mjaftueshëm, bile kënaqshëm në literaturën hanefite, sidomos në Bedaiu's-Sanai të Kasanit. Ky doracak ishte njëri prej materialeve bazë në përpilimin e shumë veprave të mëvonshme fikhore hanefite si p.sh.: *Xhevahiru'l-Fikh* e djalit të Merginanit, *Tekmiletu'l-Kuduri* e Husamedin Raziut, etj., dhe për t'u vërtetuar në këtë, mjafton të lexohet hyrja e këtyre veprave.

KOMENTET (EL SHURUH) TË MUHTESARIT TË TAHAVIUT


Afgani shprehet se *Muhtesari i Tahaviut* është: “*muhtesari i parë i hanefive, më i miri dhe me shkurtimin më të mirë, si dhe me transmetimet më të sakta nga dijetarët e medhhebit dhe me studimet më të fuqishme dhe më me përparësi për fetfa.*”²⁰ Vlera dhe pozita e autorit si dhe librit të tij në medhhebit bënë që kjo përmbledhje fikhore (*muhtesar*) brenda një kohe të shkurtër të kthehej në një doracak (*metën*) të rëndësishëm, mbi të cilin dijetarë të mëdhenj do të shkruajnë komentare shkencor (*shuruh*). Komentet²¹ në fjalë janë:

1. Komenti i Razi Xhesasit (vdiq 370 hixhri). Autori i kësaj veprë të madhe është Ebu Bekër Ahmed b. Ali Razi Xhesasi. Kjo veprë e madhe fatmirësisht e ka pa dritën e botimit dhe është botuar në 8 vëllime me rreth 8000 faqe, kuptohet me gjithë shënimet marginale të muhakikëve. Kevtheriu për këtë koment thotë: “*Komenti më i vjetër dhe më i rëndësishëm, libër i shkallës më të lartë në mjeshtëri si të rivajetit (transmetim) ashtu edhe të dirajetit (fikh).*”²² Vlen të theksohet se gabimisht ky koment në shumë burime i atribuohet Ebu Bekër Ahmed b. Ali el Verrak, e që realisht është keqlexim i emrit të Raziut dhe fjala është për të njëjtin person dhe të njëjtin libër.

2. Komenti i Sajmeriut (vdiq 436 hixhri). Llogaritet prej komenteve të humbura dhe në disa burime përshkruhet si veprë disa vëllimesh.

3. Komenti i Ebu Nesr Ekta' (vdiq 474 hixhri). Tani për tani llogaritet veprë e humbur. Ebu Nesri është nxënësi i Kuduriut dhe njëherësh edhe komentuesi i parë i *Muhtesar Kudurit*.

4. Komenti i Ispixhabit të Madh (vdiq 481 hixhri). Autori i tij është Ebi Nesr Ahmed b. Mensur Huxhendi Ispixhabi (Isfixhabi) el Kebir. Kevtheriu shënon se ky koment ndodhet



dorëshkrim në bibliotekën Ali Pash Shehidi të Stambollit. Shejhu'l-islam Ispixhabi (do të përmendet në vijim) në fillim të komentit të tij mbi Muhtesar Tahaviun për këtë komentin e Ispixhabit të Madh thotë se ishte një punim mjaft i zgjeruar.

5. Komenti i Serahsiut (vdiq 483 hixhri). Autori i tij është Shemsil'eimeh Serahsi, autori i Mebsutit të famshëm. Kutlubuga në *Taxhu't-Teraxhim*²³ thekson se ai personalisht e ka parë një pjesë të këtij komentit. Bile, Kevtheriu shënon se kjo vepër ekziston si dorëshkrim në bibliotekat Sulejmanijeh dhe Shehzadeh të Stambollit.

6. Komenti i Shejhu'l-islam Ispixhabit (vdiq 535 hixhri). Autori i tij është Ali b. Muhamed Ispixhabi Semerkandi. Ai është njëri prej mësuesve të Merginanit. Nga dijetarët është cilësuar si dijetari i Semerkandit, i cili e dinte medhhebin hanefi më mirë se gjithë bashkëkohëtarët e tij. Kevtheriu shënon se ky koment ndodhet dorëshkrim në bibliotekën Jeni Xhami të Stambollit. Fatmirësisht edhe kjo vepër së fundmi e ka pa dritën e botimit dhe është botuar në 4 vëllime me diku afër 2200 faqe.

7. Komenti dy vëllimesh i Veberit. Autori i tij cilësohet si imami i madh Ebu Nesr Ahmed b. Muhamed b. Mes'ud Veberi.²⁴ Për të nuk dihet gjë tjetër. Në literaturën fikhore të hanefive figuron një personalitet që citohet me të madhe me nofkën El Veberi, e sidomos nga Ajniu në komentin e Hidajes, mirëpo a flitet për të njëjtin person a jo, kjo nuk është e sigurt. Edhe komentit i tij tani për tani llogaritet i humbur.

8. Komenti i Signakit (vdiq 714 hixhri). Tekijudin Gaziu shënon se ai ka hasur një shënim nga ca dijetarë të shquar se Signaki ka shkruar një koment disa vëllimesh mbi *Muhtesar* Tahaviun. Edhe ky koment sot për sot llogaritet i humbur.²⁵

9. Komenti i Kutlubugasë. Në disa burime figuron se edhe Ibën Kutlubuga pati shkruar një koment mbi *Muhtesar*

Tahaviun, për të cilin koment nuk dihet gjë dhe llogaritet i humbur.²⁶

10. Komenti i Eflatunzades. Në disa burime figuron se edhe myftiu i madh i Stambollit dhe nxënësi i mulla Husrevit i njohur si Eflatunzadeh shkroi një koment të Muhtesar Tahaviut. (vijon)

- 1 Muhamed Sejid, Desuki, *Tedvinu'l-fikhi'l-hanefij ve etheruhu fi tedvini fikhi'l-medhahib*. (Doha: Universiteti i Katarit, Revista "Mexheletu Kulijeti'sh-sheria ve'd-dirasati'l-islamijeh", nr. 20, viti 2002), fq. 294; fq. 303 dhe fq. 304.
- 2 Përkthimet janë marrë shkurtimisht nga fjalët përkatëse nga fjalori online i dr. Isa Memshit (<https://arabishtshqip.com>), parë për herë të fundit më: 03.10.2023.
- 3 Kadi Ijad, *Tertibu'l-Medarik ve tekribu'l-mesalik*. (Rabat: Metbeatu'l-fedaleh, botimi i parë, 1966), vol. 3, fq. 366.
- 4 Ebu'l-Vefa Afgani. Hyrja studimore e *Muhtesar Tahaviut*. (Kajro: metbeatu dari'l-kitabi'l-arabij, 1951), fq. 4.
- 5 Xhelaludin Sujuti, *Husnu'l-muhadarah fi tarihi Misr ve'l-Kahirah*. (Kajro: daru ihjai'l-kutubi'l-arabijeh, botimi i parë 1967), vol. 1, fq. 399.
- 6 Muhamed Zahid el Keutheri, *El-Havi fi sirati't-Tahavi*. (Kajro: el-Mektebetu'l-ez'herijeh, 1995), fq. 15-19.
- 7 Bekar b. Kutejbeh vdiq në vitin 270 h. dhe është nxënësi i Hilalurra'jit dhe ky i fundit ishte nxënës i Ebu Jusufit dhe Zuferit. Ndërsa, Ibën Ebi Imrani, i cili vdiq në vitin 280 h. ishte nxënës i Bishr Kindiut dhe Ibën Sema'as. Bishr Kindiu është nxënës i Ebu Jusufit dhe Ibën Sema'ah ishte nxënës i Ebu Jusufit dhe Shejbanit. Ndërsa kadi Ebu Hazimi vdiq në vitin 292 h., me të cilin u takua në Sham, është nxënës i Isa b. Ebanit dhe ky i fundit nxënës i Shejbanit.
- 8 Shemsudin Dhehebi, *Sijeru ealami'n-nubela*. (Bejrut: muesesetu'r-risaleh, botimi i tretë, 1985), vol. 15, fq. 27.
- 9 Mexhudin Ibën Ethir, *Xhamiu'l-usul fi ehadiithi'r-Rasul*. (Damask: daru Ibën Kethir, botimi i tretë 2016, me tahkik të Arnautit), vol. 8, fq. 232.
- 10 Për rangimin e Tahaviut shiko: Tashkuprizadeh, *Tabekatu'l-fukaha*. (Mosul: metbeatu'z-zehra, botimi i dytë, 1961), fq. 58; Abdulhaj el-Leknevi, *El-Fevaidu'l-Behijeh*. (Kajro: daru'l-kitabi'l-islamij, pa vit botimi), fq. 31 fq; Zahid el-Keutheri, *el-Ishfaq ala ehkami't-Talak*. (Amman: daru'l-fet'h, botimi i parë, 2022), fq. 208.
- 11 Kadi Ebu Abdilal Sajmeri, *Ehbaru Ebi Hanifeh ve es-habihi*. (Rijad: Alemu'l-kutub, botimi i dytë, 1985), fq. 168
- 12 Abdulkadir el Kurashi, *El Xhevahiru'l-mudijeh fi Tabekati'l-Hanefijeh*. (Rijad: Hexhr, botimi i dytë, 1993), vol. 1, fq. 276 dhe 277; *El Fevidu'l-Behijeh*, fq. 34.
- 13 *TDV Islam Ansiklopedisi*, (Stamboll: Türkiye Diyanet Vakfı, 2006), vol. 32, fq. 246.
- 14 Shiko: *Ehbaru Ebi Hanifeh ve Es-habihi*. Fq. 168; Kasim bin Kutlubuga, *Taxhu't-Teraxhim*. (Damask: daru'l-kalem, botimi i parë, 1996), fq. 101; Alaudin Ibën el Hinaij, *Tabekat el-Hanefijeh*. (Bagdad: Divanu'l-vakfi's-sunij, botimi i parë, 2005), vol. 2, fq. 26, bio. 60; Mahmud el Kelevi, *Ketaibu Ealami'l Ehjar*. (Bejrut: DKL, botimi i parë, 2019), vol. 1, fq. 355; *El-Fevaidu'l-Behijeh*. Fq. 32.
- 15 Shiko: Ibën el Nedim, *El Fihri'sh*. (Londër: Al-Furqan Foundation, 2009), vol. 2, fq. 32; Katip Çelebi, *Keshfu'dh-Dhunun an esamij el kutubi ve'l-funun*. (Londër: Al-Furqan Foundation, 2021), vol. 6, fq. 332, lib. nr. 15973.
- 16 Shiko: *El Xhevahiru'l-mudijeh fi Tabekati'l Hanefijeh*. Vol. 1, fq. 276 dhe 277; Ali Lexuesi, *El Ethmaru'l-xhenijeh fi esmai'l hanefijeh*". (Bagdad: Divanu'l-vakfi's-sunij, botimi i parë, 2009), vol. 1, fq. 335; Hyrja studimore e Afganiut mbi *Muhtesar Tahavi*. fq. 5.
- 17 *Ehbaru Ebi Hanifeh ve Es-habihi*, fq. 168.
- 18 Ahmed Ibën Tejmiyeh, *Mexhmuu'l Fetava*. (Rijad: Mexhmeu'l-melik Fehd, 1995), vol. 4, fq. 450-451.
- 19 <http://nubsk.edu.mk/en/collections/oriental-manuscripts> (parë për herë të fundit më: 01/10/2023)
- 20 Hyrja studimore e *Muhtesar Tahaviut*, fq. 4.
- 21 Për komentet në fjalë dhe dorëshkrimet e tyre shiko: *El-Havi fi sirati't-Tahavi*. Fq. 37; Abdullah el-Habeshi, *Xhamiu'sh-shuruh ve'l-havashi*. (Xhide: daru'l-minhaxh, botimi i parë, 2017), vol. 4, fq. 131.
- 22 *El-Havi fi sirati't-Tahavi*. Fq. 37.
- 23 *Taxhu't-Teraxhim*, fq. 235, bio. nr. 201.
- 24 *Taxhu't-Teraxhim*, fq. 125, bio. nr. 55.
- 25 Tekijudin Temimi Gaziu, *El Tabekatu's-Senijeh fi teraxhimi'l-hanefijeh*. (Rijad: daru'r-Rifajj, botimi i parë, 1983), vol. 3, fq. 152, bio. nr. 758.
- 26 Ismail Pashë Bagdadi, *Hedijetu'l-Arifin*. (Bejrut: daru ihjai't-turath, pa vit botimi), vol. 1, fq. 831.

Gjenocidi ndaj fëmijëve e grave në Gaza në emër të civilizimit bashkëkohor

Mulaim Shehu

Gaza është qyteti më i madh i Autoritetit Palestinez me numër të banorëve afër 2.2 milionë banorë, ndërsa ka sipërfaqe afërsisht 378 km², që është qyteti më i dendur, jo vetëm në botën arabe, por edhe në botë përgjithësisht.

Qyteti më i folur dhe përfolur këto ditë në botë është Gaza. Ky qytet bregdetar palestinez, është qyteti më i madh në Rripin e Gazës, që është larg nga qyteti Kuds 78km. Gaza kufizohet në jugperëndim me Egjiptin, kurse në lindje dhe veri me Izraelin, apo siç thonë më mirë palestinezët, me Palestinën e okupuar. Andaj, Rripi i Gazës dhe Bregu Perëndimor përbëjnë të ashtuquajtur shtetin e Palestinës, që janë të ndara dhe nën okupimin ushtarak Izraelit, që nga viti 1967.

Kështu Izraeli kontrollon hapësirën ajrore dhe detare të Gazës, si dhe gjashtë nga shtatë kalimet tokësore të Gazës, dhe rezervon të drejtën për të hyrë në të sipas dëshirës me ushtrinë e saj. Andaj, Gaza është e varur nga Izraeli për ujë, energji, telekomunikacion dhe shërbimet e tjera.

Gaza është qyteti më i madh i Autoritetit Palestinez me numër të banorëve afër 2.2 milionë banorë, ndërsa ka sipërfaqe afërsisht 378 km², që është qyteti më i dendur, jo vetëm në botën arabe, por edhe në botë përgjithësisht. Popullsia e Rripit vazhdimisht është në rritje, niveli maksimal i lindjeve ka arritur në 8.3 fëmijë për grua, por për rrethana të ndryshme ka rënie, megjithatë me popullsi 43.5% janë 14 vjeç.


HISTORIKU I GAZËS

Qyteti Gaza është themeluar nga kenanët përafërsisht 1500 vjet para lindje së Isait a.s., mirëpo gjatë historisë, ajo u pushtua nga shumë pushtues, si faraonët, grekët e lashtë,

romakët, osmanët, anglezët, kurse tani është e pushtuar nga sionistët.

Për herë të parë Gaza përmendet në dorëshkrimet e faraonit Tahtemes III, shek. XV para Isait a.s.. Kështu 300 vite pas pushtimit faraon, në këtë qytet, rreth tij vendoset fisi Falestin apo thënë më qartë fisi Palestinez. Meqë sipas sionistëve mjafton të kesh jetuar në ato toka vetëm 250-300 vjet në 5000 vite histori dhe të kesh licencë të bësh gjithçka, madje edhe gjenocid ndaj fëmijëve palestinez.





Në vitin 250, në Rripin e Gazës filloi përhapja e krishterimit, kurse në periudhën e Porphyrius-it, ndërmjet vitit 396 dhe 420 ishte edhe më intensive. Pas ndarjes së Perandorisë Romake në shek. III, atëbotë Gaza ende ishte nën pushtimin e Perandorisë Romake Lindore, që më vonë u quajt Perandoria Bizante, atëbotë lulëzoi qyteti dhe ishte një qendër e rëndësishme e Shamit.

Në vitin 635 h. myslimanët arabë e çliruan dhe nga ajo periudhë Gaza u bë qendër e rëndësishme për myslimanët dhe qytetarët e tjerë. Andaj, sa për ilustrim do të theksojmë se Gaza është vendlindja e njërit prej katër imamëve të jurisprudencës islame, Imam Muhamed ibën Idris esh Shafiut, që ka lindur në vitin 150 h. respektivisht 767.

Gjatë kryqëzatave, qytetin Gaza e pushtojnë evropianët. Është rikthyer nën sundimin e myslimanëve pas triumfit të Salahuddin Ejubit në betejën e Hitin-it në vitin 1187, ku Gaza lulëzoi në kohën e fundit të Perandorisë Osmane, dhe për herë të parë është themeluar Kuvendi Bashkiak në vitin 1893.

Në historinë bashkëkohore, Gaza u pushtua nga forcat britanike gjatë LPB-së, kështu që u bë pjesë e mandatit britanik në Palestinë. Por, Anglia, atëbotë si një fuqi e madhe çelësat e Palestinës ia dorëzoi izraelitëve, ku edhe themelohet shteti i Izraelit, të cilin fillimisht e pranoi si shtet ShBA-ja, më pastaj Bashkimi Sovjetik, Çekosllovakia dhe e katërta ishte ish-Jugosllavia.

EMËRTIMET E QYTETIT

Qyteti Gaza konsiderohet një nga qytete më të lashta, siç thamë më parë që njeh historia, kurse sa i përket emërimit

të tij, ka shumë mendime të ndryshme, sepse emri i saj ka pësuar ndryshime sipas pushtuesve të saj, andaj sa për ilustrim ne do të theksojmë vetëm disa prej tyre. Kështu Gaza te kenanët quhej Hezati, faraonët e quanin Gazato, asirianët e quanin Azzati, ndërsa osmanët nuk e ndryshuan nga emërtimi arab غزة Gaza.

Po ashtu ka edhe mendime të ndryshme nga historianët për sa i përket emërimit të saj me emrin Gaza. Disa pohojnë se ka domethënie “القوة dhe المنعة” “fortifikim dhe fuqi”, ndërsa disa pohojnë se kuptimi i saj është “الثروة” që d.m.th. “thesar, pasuri, bollëk”. Mirëpo, ka të tillë që thonë se emri i saj ka kuptimin “الميزة” që d.m.th. “veçori dalluese”, andaj ky qytet dallohet nga qytete e tjera.

Autori i fjalorit më të vëllimshëm, Muhamed b. Mendhur, që ka 19 vëllime, pohon se fjala Gaza rrjedh nga: “غز فلان” بغلان واغتر به اذا اختصه من بين اصحابه d.m.th. “filani është besnik ndaj filanit dhe krenohet me të në mesin e shokëve të tij”, po kështu këtë mendim e konfirmon edhe enciklopedisti Jakut el Hamevi në veprën e tij “Muxhemu-l-buldan”.

Lidhja e arabëve me Gazën ishte një lidhje e fortë, sepse ishte një qendër e rëndësishme për shumë rrugë tregtare, njëherësh simbolizon qëllimin e dy udhëtimeve të mirënjohura, që janë përmendur në Kuranin famëlartë në Suren Kurejsh, “...në udhëtimin që bëjnë dimër e verë”. Udhëtimi që bënin arabët gjatë stinës së dimrit në Jemen dhe udhëtimin gjatë stinës së verës në vendet e Shamit.

Kështu, në njërin prej udhëtimeve gjatë stinës së verës për në Sham ka vdekur Hashim b. Abdu Menaf, gjyshi i Muhamedit a.s. dhe është varrosur në Gaza, afër xhamisë së njohur aktualisht “Xhamia e Zotëriut Hashim” në lagjen “Ed Derxh”. Andaj, edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s.,

Lidhja e arabëve me Gazën ishte një lidhje e fortë, sepse ishte një qendër e rëndësishme për shumë rrugë tregtare, njëherësh simbolizon qëllimin e dy udhëtimeve të mirënjohura, që janë përmendur në Kuranin famëlartë në Suren Kurejsh, “...në udhëtimin që bëjnë dimër e verë”.

atëbotë kur ishte i vogël, përafërsisht 12 pranvera, me xhaxhain e tij, Ebu Talibin shkuan në Sham për tregti përmes qytetit Gaza.

Gaza konsiderohet qyteti më i rëndësishëm palestinez, për shkak të rëndësisë strategjike, ekonomike dhe ndërtimit, përkundër asaj se në të është selia e përkohshme e Autoritetit Vendor Palestinez, po ashtu në të janë edhe seli të tjera dhe ministri.

Mirëpo, për shkak të luftës Arabe-Izraelite, në vitin 1948, Gazën e merr Egjipti, ku lulëzoi qyteti në shumë aspekte, dhe kjo vazhdoi deri në vitin 1967, ku në këtë vit Izraeli e okupon Gazën.

Pas marrëveshjes së Oslos, ndërmjet Organizatës për Çlirim e Palestinës dhe Izraelit në vitin 1993, sipas traktit Gaza-Eriha, i nënshkruar më 04.05.1994, pushteti i qytetit kalon në Autoritetin e Autonomisë së Palestinës. Dhe, pas zgjedhjeve në vitin 2006, shpërtheu luftë ndërmjet Lëvizjes së Fatahut dhe Lëvizjes së Rezistencës Islame “Hamas”, kështu që Lëvizja e Fatahut pësoi dhe refuzoi kalimin e Autoritetit në Gaza të Hamasi, andaj që atëherë Gaza është në gjendje rrethimi nga Izraeli dhe Egjipti. Mirëpo, pas revolucionit egjiptian, më 25 janar 2011, atëherë Egjipti hapi kalimin për lehtësimin e qytetarëve të Gazës, edhe pse ky vendim nuk paraqiste ndonjë veçori specifike.

Veprimtaria ekonomike është primare në Rripin e Gazës, edhe pse nuk ka ndonjë kapacitet të madh në bujqësi, blegtori dhe punë, sepse ekonomia është shkatërruar gjatë rrethimit të plotë izraelit dhe përlëshjeve të herëpashershme dhe të përgjakshme.

Kështu është një anomali, që këto ditë të kërkohet se historia filloi nga data 7 tetor, që këto ditë të dënohet vetëm Hamasi dhe askush tjetër, por këto ditë kërkohet të harrohet 75 vjetët më të ngjeshura të terrorit, aparteidit, gjenocidit dhe spastrimit etnik, që historia njerëzore nuk ka parë ndonjë herë në kaq shtrirje kohore.

GJENOCIDI NDAJ FËMIJËVE E GRAVE NË EMËR TË CIVILIZIMIT

Sipas raportit zyrtar, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, nga fillimi i sulmeve të Izraelit ndaj Gazës deri më sot (25 tetor), numri i palestinezëve të vrarë ka arritur në 5791, prej të cilëve 2047 fëmijë dhe 1016 gra.

Vallë, a kështu luftohet terrorizmi, duke vrarë fëmijë dhe gra, mirëpo me keqardhje këtë luftë e mbështet bota e civilizuar dhe demokratike duke dënuar njerëzit e pafajshmin me vdekje, atëherë dëshiroj të shprehem lirshëm se unë personalisht nuk i përkas këtij civilizimi.

Por, ne i përkasim civilizimit që pohon se: *“Andaj, Ne u shpallëm Bijve të Israelit se kush vret ndokënd, që nuk ka vrarë*

njeri apo që nuk ka bërë ngatërresa në Tokë, është sikur të këtë vrarë gjithë njerëzit.” (El Maide, 32).

Kështu Izraeli u bën thirrje 2.3 milionë banorëve të Gazës të largohen nga vendbanimet e tyre brenda 24 orëve, ndryshe do të konsiderohen si terroristë. Izraeli pasi u tregon rrugën se ku duhet të evakohen banorët e Gazës, ai i bombardon ekzaktësisht në atë rrugë që ata po ndiqnin, duke vrarë 70 familjarë, ku numri i fëmijëve të vrarë po kalon 1500 të tillë, bombardon kishat e krishtera duke vrarë dhjeta veta përnjëherë, ky quhet efekt anësor se Izraeli është një përjashtim nga rregulli.

Megjithatë, kjo nuk është hera e parë që Izraeli bën masakra dhe gjenocid mbi palestinezët civilë dhe fëmijë. Reagimet nga Izraeli janë shumë të zbehta kur është në pyetje padrejtësia që bëhen ndaj palestinezëve, veçmas ndaj fëmijëve.

Sipas përlllogaritjes që është bërë nga kanali televiziv “Al Xhazira”, viti 2023, është viti më i përgjakshëm ndaj fëmijëve, pasi afër 2 mijë janë të vrarë tragjikisht nga bombardimet izraelite dhe numri i tyre sa vjen e shtohet.

Orëve të fundit në Gaza kanë qarkulluar foto në rrjetet sociale palestineze, se në pëllëmba të dorës fëmijët shkruajnë emrin, mbiemrin dhe numrin e identitetit kombëtar. Ndërsa, disa prindër në Gaza janë udhëzuar që të shkruajnë emrat e fëmijëve të tyre në këmbë për të ndihmuar në identifikimin e tyre nëse ata fëmijë vriten. Kurse në një rast tregojnë se një foshnjë dhe tre fëmijë janë vrarë, të cilët mbajnë emrat e tyre të shkruar në krahët e tyre. Ndërsa, rast tjetër shihet fëmija i plagosur pa familje të mbijetuar. Shumica e viktimave të masakrës janë fëmijë dhe gra, gjymtyrët e trupit të të cilëve u humbën. Disa nga viktimat pa kokë, me mungesë të ndonjë gjymtyre dhe organe të brendshme të dala jashtë. Këtu thuajse çdo ditë kemi raste ku thuhet se “ky është i vetmi familjar i mbijetuar”.

Një veprim interesat i cili më la mbresa të thella është se në kujtim të fëmijëve që u vranë në sulmet e Izraelit në Rripin e Gazës është organizuar një fushatë mbjelljeje pemësh. Çdo pemë në kuadër të kësaj fushate, e cila synon rritjen e hapësirës së gjelbra në Gaza, mori emrin e fëmijëve që humbën jetën në sulmet izraelite.

Izraelitët pohojnë se po hakmerren ndaj sulmit të 7 tetorit, por vallë pse në Bregun Perëndimor, që nuk ka Hamas, aparteidit, gjenocidit, zhvatja e pronës, vrasja dhe burgosja e civilëve, kolonizimi i tokave, që me rezolutën 242 të Kombeve të Bashkuara nuk i përkasin atyre, vazhdon nga viti 1967.

Dhe, në fund dua të them, se gjatë qëndrimit në mërgim kam pasur rast të njoftohem me arabë të shteteve të ndryshme, por palestinezët dallohen prej tyre si nga aspekti i arsimimit, inteligjencës, atdhetarisë, besnikërisë dhe besimtarisë.

Kujdesi i Pejgamberit a.s. për gruan me cikël menstrual

Samire Bilalli

“Të pyesin ty për menstruacionet (hajdin)! Thuaj: Ajo është gjendje e neveritur, andaj largohuni prej grave gjatë menstruacioneve dhe mos iu afroni atyre për marrëdhënie derisa të pastrohen. E kur të pastrohen, atëherë afrohuni atyre ashtu siç u ka lejuar Allahu. Allahu i do ata që pendohen dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta e të neveritshme!” (El Bekare, 222).

Femra, në të gjitha fazat e jetës së saj, është e krijuar në atë mënyrë që të jetë më e ndjeshme ndaj situatave dhe ngjarjeve të ndryshme. Kjo vërehet edhe më qartë gjatë periudhës së menstruacioneve, ku ajo përjeton dhimbje fizike, por edhe një luhatie humori, që ndikon në anën psikologjike të saj. Duke qenë kështu, Islami në përgjithësi, por edhe vetë Pejgamberi a.s. në veçanti, si model dhe shembull yni, i kushtoi një kujdes të veçantë femrës gjatë këtyre ditëve, duke treguar kujdes dhe sjellje të veçantë.

Marrë parasysh që disa gjëra janë të ndaluara për femrën gjatë këtyre ditëve, si lehtësim për atë, siç është namazi, agjërimi, bërja e tavafit, leximi i Kuranit, kryerja e marrëdhënieve intime etj., janë disa punë dhe veprime të tjera, të cilat janë të lejuara për të, e madje edhe të preferuara, siç është dhikri, përmendja e Zotit, marrja me dituri fetare etj., por edhe veprime të tjera të përditshme edhe në raport me burrin e saj, përveç veprimeve të ndaluara që i përmendëm më lart.

Nëpër etapa të ndryshme të njerëzimit, femra gjatë ciklit menstrual është trajtuar në mënyrë jo njerëzore. Ajo është ndarë nga shtrati, madje disa kanë shkuar aq larg, sa që e kanë vendosur atë në një vend tjetër, ngase e kanë konsideruar atë si të papastër e të ndyrë. Asaj nuk i është lejuar të gatuj, e aq më pak që të tjerët të ushqehen prej duarve të saj. Zorastritët, femrën kur ishte në të përmuajshmet, e konsideronin si të fëlliqur dhe atë e mbyllnin në një dhomë të vetmuar. Në traditën hebraike parashihej që burri duhet të qëndrojë larg gruas kur është në të përmuajshmet, jo vetëm gjatë ditëve të tyre, por edhe shtatë ditë më pas, për faktin se trupi i saj dhe rrobat që ka përdorur konsideroheshin si të fëlliqura, dhe për pasojë ishin edhe të ndaluara. Gjatë periudhës së tillë, burrat hebrenj nuk i preknin bashkëshortet e tyre, nuk hanin bashkë dhe nuk flinin në një shtrat me to.¹ Kjo gjë kishte sjellë huti edhe te disa nga sahabët e Pejgamberit a.s..

Për këtë, Enesi r.a., ka thënë: “Me të vërtetë hebrenjtë ishin nga ata që kur ndonjëra nga gratë e tyre ishte në të përmuajshmet, ata nuk hanin me to e as nuk banonin me to në një shtëpi. Sahabët e pyetën të Dërguarin a.s. për këtë, e Allahu i Gjithëfuqishëm e shpalli ajetin: “Të pyesin ty për menstruacionet (hajdin)! Thuaj: Ajo është gjendje e neveritur, andaj largohuni prej grave gjatë menstruacioneve dhe mos iu afroni atyre për marrëdhënie derisa të pastrohen. E kur të pastrohen, atëherë afrohuni

Islami në përgjithësi, por edhe vetë Pejgamberi a.s. në veçanti, si model dhe shembull yni, i kushtoi një kujdes të veçantë femrës gjatë këtyre ditëve, duke treguar kujdes dhe sjellje të veçantë.

Pejgamberi a.s. nuk e largoi gruan e tij nga mbulesa edhe pasi që iu paraqitën të përmuajshmet, e lërë më të vepronte diç tjetër me të, ta distanconte apo edhe ta largonte atë nga punët që i bënte me duart e saj.

atyre ashtu siç u ka lejuar Allahu. Allahu i do ata që pendohen dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta e të neveritshme!” (El Bekare, 222). E i Dërguari a.s., më pas tha: “Bëni çdo gjë përveç marrëdhënieve intime me to.”

Kur ky lajm arriti te hebrenjtë, ata thanë: “Ky njeri nuk dëshiron të lejojë asgjë prej gjërave tona, e të mos na kundërshtojë.”

Pas kësaj, tek i Dërguari a.s. erdhën Usejd ibën Hudajri dhe Ubade ibën Bishri, dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut, hebrenjtë flasin këtë dhe këtë, po vallë ne nuk do të kemi kurrfarë marrëdhënie me to?” Pas kësaj fytyra e Pejgamberit a.s. u ndryshua aq fort, sa që këta menduan se është hidhëruar me ta, dhe dolën nga aty. Por kur dolën te dera panë një dhuratë, një sasi qumështi që i ishte dërguar Pejgamberit a.s.. Ai a.s. ua dërgoi qumështin atyre të dyve dhe ata pinë prej ti, e më pas e kuptuan se ai a.s. nuk ishte hidhëruar me ta.²

Pejgamberi a.s. për dallim nga hebrenjtë, jo që nuk e largoi bashkëshorten e tij nga shtrati për shkak se ajo ishte në të përmuajshmet e saj, por përkundrazi, ai e vazhdoi rrjedhën e jetës ashtu siç ishte më parë. Për këtë kemi shembullin e Umu Selemes r.a., e cila tregon:

“Derisa isha ulur në kadife me të Dërguarin e Allahut a.s., hyra në cikël menstrual. Në mënyrë të heshtur u tërhoqa dhe veshja rrobat e ciklit. I Dërguari i Allahut a.s. më tha: “A të janë paraqitur të përmuajshmet?” “Po” – thash. Më ftoi mua pranë dhe u ula me të në kadife. Unë dhe i Dërguari i Allahut a.s. jemi pastruar nga një enë prej xhunubllëku.”³

Pejgamberi a.s. nuk e largoi atë nga mbulesa edhe pasi që iu paraqitën të përmuajshmet, e lërë më të vepronte diç tjetër me të, ta distanconte apo edhe ta largonte atë nga punët që i bënte me duart e saj.

Për ta dëshmuar këtë, në një hadith, të cilin e transmeton Ebu Hurejra, thuhet: “Derisa isha në xhami me të Dërguarin e Allahut a.s., ai i tha Aishes r.a., m’i sill rrobat. Ajo i tha: “Jam në të përmuajshmet.” Pejgamberi a.s. i tha: “Të përmuajshmet nuk i ke në duart tua”, dhe ajo ia solli rrobat.”⁴

Kujdesi i Pejgamberit a.s. ndaj grave të tyre gjatë periudhës së ciklit shfaqej edhe kur ai ishte në itikaf. Aisheja r.a. tregon se kur Pejgamberi a.s. ishte në xhami (në itikaf) e nxirrte kokën nga xhamia përmes dritares në



dhomën e saj, dhe ajo ia krihte flokët, edhe kur ishte në ditët e saj.⁵

Mirësjellja dhe kujdesi i veçantë i Pejgamberit a.s. ndaj grave të tyre nuk kishte kohë të caktuar, ai nuk e anashkalonte gruan gjatë periudhës së saj, e më pas ta vazhdonte kujdesin. Ai na mësoi se sjellja e mirë ndaj gruas nuk do të thotë vetëm mbështetja e saj financiare, por rëndësi më të madhe i kushtonte mbështetjes emocionale, duke e bërë atë të ndihej e plotë edhe në gjendjet kur humori i saj binte nën nivel.

Transmetohet nga Aisheja r.a., se ka thënë: “U nisëm për udhëtim, me qëllimin e vetëm për ta kryer haxhin. Por, kur arritëm në Sarif (vend rreth 11km nga Meka) më erdhën ditët e mia. Kur hyri tek unë i Dërguari i Allahut a.s., unë po qaja, e ai më tha: “Çfarë ke kështu? Të erdhën menstruacionet?” “Po” – iu përgjigja. Ai a.s. më tha: “Kjo është një gjë të cilën e ka caktuar Allahu për bijat e Ademit. Kështu pra, bëj të gjitha veprimet që bën çdo haxhi tjetër, përveç tavafit (rrotullimit rreth Qabesë).” Pastaj ajo shtoi: “I Dërguari i Allahut a.s. theri kurban një lopë për gratë e veta.”⁶

Nga ky hadith shkëpusim pjesën e mërzitjes së Aishes dhe të qarën e saj, për të dëshmuar shembullin e lartë se si duhet t’i qaset bashkëshorti gruas së tij gjatë periudhës kur ajo është në të përmuajshmet. I Dërguari a.s. e pa Aishen r.a. duke qarë, dhe e kuptoi se ajo gjendje po e bën të pikëlluar atë. Ne përmendëm më lartë, se gruaja gjatë periudhës së saj, përveç ndryshimeve të humorit, ka edhe ndryshime fizike që shkaktojnë dhimbje të trupi i saj, e duke e marrë parasysh që gjatë kësaj periudhe, asaj i ndalohen edhe disa obligime fetare, ajo bëhet edhe më e ndjeshme për shkak të moskryerjes së tyre në kohën e caktuar, siç ishte rasti me Aishen r.a..

Pejgamberi a.s. kur e pa në atë gjendje, nuk e injoroi, ashtu siç ndoshta do të vepronin të tjerët, por e ngushëlloi atë me fjalët më të mira, duke i treguar se kjo gjendje nuk shkaktohet nga ti, e as që është në dorën tënde, por është caktim nga Lartmadhëria e Tij.

Ndonëse gruaja ka disa ndalesa në obligimet fetare gjatë kësaj periudhe, ajo nuk duhet të privohet plotësisht nga to. Muhamedi a.s. ua mësoi burrave se, ani pse gruaja nuk lexon Kuran gjatë kësaj periudhe, ajo mund të dëgjojë lexim të Kuranit nga burri i saj apo nga TV. Aisheja r.a. tregon se i Dërguari a.s. mbështetej në prehrin tim derisa unë isha në të përmuajshmet dhe ai këndonte Kuran.⁷

Allahu xh.sh. na e solli Pejgamberin a.s. si shembullin më të mirë që ne të ecim hapave të tij. Kur themi shembulli më i mirë, do të thotë që Allahu xh.sh. është kujdesur që shembullin e tij, a.s., të na e pasqyrojë edhe në detaje të vogla, por të rënda në peshore. Dashuria ndaj bashkëshorteve nuk mbaronte me fillimin e ciklit të tyre. Ai përveçse me fjalë,

tregonte dashuri edhe me vepra, ani pse të lehta dhe të vogla për t’u vepruar, por në sytë e bashkëshorteve shiheshin si një përkushtim dhe vlerësim ndaj tyre. Aisheja r.a. ka thënë: “Kur isha me cikël kam pirë nga ena dhe më pas atë ia kam dhënë të Dërguarit a.s., e ai e vendosi gojën e vet në të njëjtin vend ku kisha vendosur edhe unë. Po ashtu, derisa isha në atë gjendje, kam kafshuar me dhëmb mishin nga ashti dhe pastaj ia kam dhënë të Dërguarit a.s. dhe ai e vendosi gojën e vet në vendin ku unë e kisha kafshuar.”⁸

Të ngrënit, të pirët, veshmbathja, biseda, krehja e flokëve, shkëmbimi i gjërave me njëri-tjetrin, e plot veprime të tjera, që janë cekur në hadithe, por edhe ato që nuk janë përmendur, janë veprime të thjeshta, të përditshme e të natyrshme, por ajo që i bën të veçanta këto që u përmendën, është shprehja “kur unë isha me cikël”, që tregon se këto kanë ardhur si mësim dhe edukim për të dy bashkëshortët, për të na mësuar se edhe veprat e thjeshta që nuk kërkojnë përpjekje të madhe, nëse bëhen me qëllimin e fitimit të kënaqësisë së Allahut, mund të kthehen në adhurime ndaj Tij.

Këtë temë dua ta përmbylli me një hadith të transmetuar nga Aisheja r.a., e cila ka thënë: “Kur ndonjëra nga ne ishte me cikël, i Dërguari i Allahut a.s., e urdhëronte atë ta mbulonte pjesën e poshtme, e më pas mbështetej në të, por kurrë nuk bënte marrëdhënie intime. Mirëpo, cili prej jush është në gjendje t’i mbizotërojë kërkesat e tij, siç i ka mbizotëruar i Dërguari i Allahut a.s.”⁹

Ajo që dua ta vë në pah është fjala e fundit e hadithit: “Mirëpo, cili prej jush...”, e unë do t’ia shtoja, cili prej jush mund të jetë i vetëpërmbajtur sikurse i Dërguari i Allahut?!; Cili prej jush mund të jetë një detajist edhe në jetën e përditshme sikurse i Dërguari i Allahut?!; Cili prej jush mund të jetë kaq shembullor ndaj gruas së tij, sikurse ai, a.s., që ishte më i miri me gratë e tij?!; Cili prej jush mund ta ndjek shembullin e tij në çdo aspekt të jetës?! Kjo mbetet një sfidë për secilin mysliman që synon të jetë më i miri me gruan, fëmijët dhe familjen e tij.

1 “Islami nëpërmjet haditheve 2”, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, fq. 152.

2 Sahihu i Muslimit, nr. 171, version i shkurtuar, Imam Zekijudin el Mundhiri.

3 Sahihu i Muslimit, nr. 176, version i shkurtuar, Imam Zekijudin el Mundhiri.

4 Sahihu i Muslimit, nr. 173, version i shkurtuar, Imam Zekijudin el Mundhiri.

5 Muhtesar Sahih el Buhari, nr. 206, Imam Zejnudin Ahmed ibën Abdulatif Zebidi.

6 Muhtesar Sahih el Buhari, nr. 204, Imam Zejnudin Ahmed ibën Abdulatif Zebidi.

7 Sahihu i Muslimit, nr. 174, version i shkurtuar, Imam Zekijudin el Mundhiri.

8 Sahihu i Muslimit, nr. 178, version i shkurtuar, Imam Zekijudin el Mundhiri.

9 Sahihu i Muslimit, nr. 177. version i shkurtuar. Imam Zekijudin el Mundhiri.

Stereotipat e gabuara rreth shamisë dhe rrugët e evitimit të tyre

Armida Plumbi

STEREOTIPAT DHE PARAGJYKIMET

Stereotipat dhe paragjykimet janë mënyra se si mund të kategorizohet bota rreth nesh. Stereotipi u përshkruan karakteristika të tjera, roleve shoqërore të anëtarëve të një grupi shoqëror, dhe kështu turbullon tiparet individuale dhe ndryshimet midis anëtarëve. Një nga elementët më të dallueshëm të stereotipave dhe paragjykimeve qëndron në faktin se ato zakonisht krijohen nga ata që kanë pushtetin dhe zbatohen nga ata që nuk e kanë, të cilët nuk mund të kontrollojnë mënyrën se si perceptohen nga të tjerët dhe nuk mund të jenë në gjendje të ndryshojnë këto perceptime.

Duke u bazuar në përkufizimin e fjalorit të Kembrixhit, stereotipat janë “një ide e fiksuar që kanë njerëzit për dikë apo diçka, veçanërisht

kur bëhet fjalë për një ide të gabuar”; po në bazë të këtij fjalori, paragjykimet janë “një mendim i padrejtë dhe i paarsyeshëm apo ndjenjë, veçanërisht kur krijohet pa u menduar mirë, ose pa pasur njohuri të mjaftueshme”.¹

Stereotipi ka shumë karakteristika negative dhe shpesh formulohet në bazë të të dhënave të pa verifikuara, false. Stereotipat e tilla janë shumë të përshtatshëm për personalitetet stereotipike. Ata nuk duan të mendojnë dhe është më lehtë të ndjekin mendimin e imponuar nga publiku. Personaliteti stereotip nuk i dëgjon dëshirat e tij dhe përpiqet të përshtatet me pritjet e të tjerëve në mënyrë që të marrë miratimin e tyre.

Me fjalë të tjera, stereotipat janë perceptime dhe klishe, ndërsa paragjykimet janë ndjenja të paarsyeshme të frikës dhe mospëlqimit ndaj dikujt apo diçkaje.

Mediat priren të fokusohen në ngjarje dhe çështje negative – lajmet e mira përgjithësisht nuk konsiderohen të dobishme apo të vlefshme. Mediat gjithashtu janë të fiksuar te lajmet sensacionale dhe që bëjnë zhurmë, në mënyrë që të tërheqin audiencën.





GRUAJA MYSLIMANE PËRTEJ STEREOTIPAVE

Ndoshta çështja më e keqkuptuar dhe më e stereotipizuar lidhur me myslimanët dhe besimin e tyre është tema e gruas. Nga perceptimi i përgjithshëm se gratë myslimane janë të shtypura e deri te pikëpamjet më specifike rreth arsimit, të drejtave martesore dhe lirisë, stereotipat janë të shumta, të ndryshme dhe të përhapura gjerësisht.

Stereotipat negative mbi mbulesën islame kanë ndikuar në diskriminimin dhe paragjykimin e femrës myslimane. Ky popullarizim i stereotipave negative është promovuar shpeshherë nga media ose figurat publike. Kjo ka bërë që femra myslimane në shoqëri të përballet me sfida, pengesa, paragjyime, barriera etj..

Parimet themelore, qëndrimet dhe urdhrat në lidhje me rolin e gruas janë të parashtruara në Kuran dhe në traditën profetike. Ashtu si në fetë e tjera, interpretimi i burimeve të shkrimeve të shenjta ndryshon shumë në komunitete të ndryshme, në kultura të ndryshme, në rrethana të ndryshme historike, madje edhe nga individi në individ.

Disa nga stereotipat më të zakonshme për gratë myslimane janë: të shtypura, të nënshtruara, qytetare të dorës së dytë me pak ose aspak të drejta, të fshehura pas shtresave të mbulesave, të paarsimuara dhe kryesisht janë të mira vetëm për të lindur fëmijë.

Sipas një sondazhi të Gallup-it të vitit %81 ,2010 e amerikanëve të anketuar nuk pajtohen me deklaratën se shumica e myslimanëve besojnë se gratë dhe burrat duhet të kenë të drejta të barabarta.²

Burimet kryesore të këtyre stereotipave

MEDIA BOTËRORE

Meqenëse shumica e amerikanëve apo e qytetarëve evropianë nuk njohin shumë myslimanë personalisht, media shpesh është burimi kryesor i informacionit për Islamin dhe pasuesit e tij.

Kjo mund të jetë problematike, pasi mediat priren të fokusohen në ngjarje dhe çështje negative – lajmet e mira përgjithësisht nuk konsiderohen të dobishme apo të vlefshme. Mediat gjithashtu janë të fiksuara te lajmet sensacionale dhe që bëjnë zhurmë, në mënyrë që të tërheqin audiencën.

Vështirë se shesh në media histori për jetën e përditshme të myslimanëve që janë njerëz të zakonshëm, në punë ose në shkollë, e jo më histori pozitive për kontributet e myslimanëve. Kjo është veçanërisht e vërtetë për tregimet për gratë myslimane, të cilat përgjithësisht fokusohen vetëm në histori të bujshme rreth konfliktit apo dhunës, ndërkohë që rrallë transmetohen arritjet pozitive të grave myslimane në shumë fusha të jetës. Për shembull, media e ka cilësuar se një nga arsyt e luftës në Afganistan ishte dëshira për të “çliruar” gratë afgane nga talebanët, por pas rënies së talebanëve, media në përgjithësi e humbi interesin për statusin dhe avancimin e grave afgane.

HOLLIVUDI

Një burim i dytë i perceptimeve negative për gratë myslimane janë filmat e Hollivudit, të cilët priren të portretizojnë myslimanët në përgjithësi dhe gratë myslimane në veçanti, në mënyra stereotipi.

• Me një nga fotografitë e hershme të filmit “*The Sheik*” me protagonist Rudolph Valentino, Hollivudi i ka portretizuar

gratë arabe dhe myslimane ose si anëtare të një haremi, gra të shtypura të terroristëve ose si viktimë pa fytyrë që presin shpëtimin nga një hero perëndimor.³

• Një nga shembujt më të njohur të një filmi që tregon shtypjen e grave është “*Not Without My Daughter*”, historia e një gruaje amerikane të martuar me një burrë iranian, i cili befas bëhet shtypës kur ai kthehet në atdheun e tij dhe përpiket të pengojë vajzën e tij të largohet me nënën e saj. Ky film i vitit 1991 u shfaq shpesh në klasat e studimeve sociale të shkollës së mesme për të mësuar rreth Islamit dhe myslimanëve.

LIBRA

Shumë libra, si artistikë dhe jo artistikë, ndihmojnë gjithashtu në përjetësimin e stereotipave rreth grave myslimane, duke theksuar vetëm aspekte negative të trajtimit të grave ose abuzimeve të kryera në emër të Islamit, pa pranuar se kulturat ose fetë e tjera ndajnë qëndrime ose praktika të ngjashme, ose se shumë nga këto praktika janë shtrembërime ose në kundërshtim me parimet kryesore islame.

• Një shembull kryesor i një veprë artistike që është përdorur si lexim i kërkuar në shumë shkolla si shtesë mbi historinë islame është “*Shabanu*”, historia e një vajze 13-vjeçare e detyruar nga prindërit e saj që të martohet me një burrë 55-vjeçar si grua e tij e tretë për të shpëtuar familjen e saj nga rrënim. Kjo dhe vepra të tjera të trillimit thjesht përforcojnë stereotipat e zakonshme për gratë myslimane, të cilat nuk kanë lidhje me mësimet e shkrimeve të shenjta dhe as me praktikatat aktuale kulturore.⁴

RETORIKA E URREJTJES

Myslimanët dhe arabët janë stereotipizuar prej kohësh, por që nga 11 shtator 2001, islamofobia është bërë fokus popullor i individëve dhe grupeve në media, politikë dhe kulturën masive. Një komponent i kësaj fushate, si në Amerikë po ashtu edhe në Evropë, është përqendrimi te gratë myslimane dhe në aspekte të tilla si mbulesa për të ngjallur frikën nga Sheriati ose shtypja e grave. Shpeshherë konteksti i ndalimit të shamisë nuk arsyetohet me padrejtësinë që i

bëhet vajzave përmes imponimit për vënien e shamisë, por justifikohet me rrezikun e përhapjes së Islamit dhe futjen e tij brenda institucioneve shtetërore.

VEPRIMET E MYSLIMANËVE

Meqenëse myslimanët janë një grup i larmishëm njerëzish që përfaqësojnë vende dhe tradita të shumta, ata kanë një shumëllojshmëri interpretimesh dhe praktikash fetare. Për më tepër, besimet dhe praktikatat kulturore shpesh mund të ngatërrohen ose ndikojnë në besimet dhe praktikatat fetare edhe pse në shumë shoqëri myslimane ato shpesh nuk kanë të bëjnë fare me Islamit dhe madje mund të bien ndesh me kuptimet kryesore të myslimanëve të mësimave kuranore ose profetike. Këto përfshijnë praktika të tilla si vrasjet për nder, kufizimin e arsimimit të vajzave etj..

DISKURSI AKTUAL MBI ROLIN E GRAVE MYSLIMANE

Njerëzit janë qenie komplekse dhe reduktimi ose atribuimi i çdo aspekti të sjelljes së tyre ndaj fesë ose ndonjë faktori tjetër të vetëm është i pasaktë.

Diskursi aktual mbi temën e grave myslimane është shpesh problematik, sepse i mungon konteksti i duhur, i cili përfshin jo vetëm ndikimet fetare, por edhe faktorë të tillë si kultura, familja, arsimi, profesioni, statusi socio-ekonomik, si dhe situata politike. Në një vend të caktuar, të gjithë këta faktorë ndikojnë në normat dhe sjelljen.

Gratë myslimane ndryshojnë nga njëra-tjetra në këtotribute po aq sa çdo grua kudo në botë. Krahësimi, për shembull, i një gruaje profesioniste të arsimuar dhe të pasur në Malajzi me një grua që jeton në një fshat në Afganistan do të ishte krejtësisht e palogjikshme; ndërkohë që të dyja janë gra myslimane. Shumë faktorë të situatës së tyre të veçantë të jetës luajnë një rol ndoshta shumë më të madh se feja në përcaktimin e të drejtave të tyre.

Një faktor shtesë që ndikon në stereotipizimin e grave myslimane është pikëpamja e disa feministëve perëndimore se, të gjitha fetë janë patriarkale dhe për këtë arsye në thelb janë shtypëse. Supozime të tilla

Shumë libra, si artistikë dhe jo artistikë, ndihmojnë gjithashtu në përjetësimin e stereotipave rreth grave myslimane, duke theksuar vetëm aspekte negative të trajtimit të grave ose abuzimeve të kryera në emër të Islamit, pa pranuar se kulturat ose fetë e tjera ndajnë qëndrime ose praktika të ngjashme.

janë të informuara nga nocionet perëndimore të shtypjes dhe lirisë, si dhe nga vlerat perëndimore që kanë të bëjnë me rolin e gruas në familje dhe shoqëri.

Francezët që e mbështetën ligjin për ndalimin e shamisë, folën për një konflikt që, sipas tyre, ekziston ndërmjet modernizmit emancipues dhe traditës shtypëse. Ndonëse nxënëset franceze që zgjodhën të mbajnë shami, e bënë këtë zgjedhje, jo si anëtare të shoqërive apo të komuniteteve tradicionale, ato pranuan një dallim që ishte tipar i Islamit. Në terminologjinë e përdorur nga sociologu Farhad Khosrokhavar, paraqiten dy qasje mbi marrëdhëniet gjinore: qasja “e hapur” dhe ajo “e mbyllur”, ku të dyja i referohen trajtimit të trupit nga pikëpamja seksuale. Në sistemet “e mbyllura”, marrëdhëniet gjinore rregullohen nga rregullat e modestisë. “Modestia dhe nderi lidhen drejtpërdrejt me mbulimin trupor dhe mendor të gruas (të gruas si mburojë e nderit të komunitetit, si menaxhere e hapësirës private)”. Nëse nga pikëpamja tradicionale, rregulli i familjes dhe pastërtia e krejt mekanizmit social mbështetej në ndarjen mes gjinive, për

vajzat myslimane në Francë ishte në lojë vetë integriteti trupor dhe nderi i tyre. Nga ana tjetër, sistemet “e hapura” janë ato në të cilat ekspozimi i trupit nuk shihet si diçka e dëmshme. Në këto sisteme, “njëfarë soditjeje dhe ekspozimi vlerësohet pozitivisht. Gjuha e trupit është ajo që hap dyert e bashkëveprimit me gjininë tjetër”.⁵

Veshja modeste, për shembull, supozohet se është shtypëse sepse në Perëndim “integriteti apo autonomia trupore” konsiderohet si vlerë parësore dhe e padiskutueshme; prandaj, një grua myslimane që zgjedh të vishet në mënyrë modeste supozohet automatikisht si e shtypur. Këto supozime e bëjnë të vështirë përfshirjen në një dialog të vërtetë.

MBULESA VS STEREOTIPAT

Mbulesa synon ta mbrojë femrën dhe t’ia shtojë asaj vlerën dhe fisnikërinë, duke treguar se ajo është e denjë për respekt. Vënia e mbulesës është obligim nga Krijuesi, të cilën e gjejmë të ilustruar në ajetin kuranor: “*O Pejgamber, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit...*” (El Ahzab, 59).

Sipas Islamit, gruaja ka obligim të shkollohet, të menaxhojë dhe të kujdeset për pasurinë e vet, ta harxhojë atë dhe të nënshkruajë kontrata sipas interesave të veta, pa lejen e askujt. Ajo ka të drejtën e votës dhe të vetos. Padrejtësitë që i bëhen asaj nuk janë nga Kurani, por nga myslimanët që nuk kuptojnë Kuranin. Islami është në favor të lirisë së gruas. Mbulesa nuk është për ta penguar gruan, por për të ruajtur interesin e përgjithshëm të shoqërisë, nëse ai interes është në pyetje.

Gruaja myslimane arrin të përballojë trysninë globale dhe të mbijetojë me dinjitet e me nder. Një femër myslimane, e devotshme, ka si synim kryesor përmirësimin e sjelljes, të edukatës dhe të veprave të saj; të gjitha këto bëjnë që ajo të sfidojë kohën, vendin dhe këtë sistem të vlerave të instaluar padrejtësisht. Ajo grua që vendos të plotësojë urdhëresat islame dhe vendos mbulesën ka luftuar mbi të gjitha për të pasur më shumë të drejta; lufton për të mos qenë e shtypur nga interesat globale; sfidon kohën, sfidon shoqëritë maskiliste, e vendos vetë për pamjen, për qëndrimin dhe identitetin e vet.⁶



1 <https://rm.coe.int/a-perben-ky-nje-steretip-nje-mjet-per-te-luftuar-steretipet-ndaj-rom/1680901eef>

2 *Religious Perceptions in America With an In-Depth Analysis of U.S. Attitudes Toward Muslims and Islam*, Gallup World Survey in conjunction with Muslim West Facts and Coexist Foundation, 2009, 6. <http://www.gallup.com/strategicconsulting/153434/ENGLISH-First-PDF-Test.aspx>

3 [https://en.wikipedia.org/wiki/The_Sheik_\(film\)](https://en.wikipedia.org/wiki/The_Sheik_(film))

4 https://en.wikipedia.org/wiki/Shabanu,_Daughter_of_the_Wind

5 Chafiq dhe Khosrokhavar, *Femmes sous le voile*, fq. 145. Fragment i shkëputur nga libri i Joan Wallach Scott me titull: “The Politics of Veil”, (Princeton University Press 2010), fq. 151-175. Përkthyer në shqip me titullin: “Politikat e fereksesë”

6 Tujani, Klinaku, Rovena “Mbulesa islame përtej paragjyimeve”, <https://kumti.com/mbulesa-islame-pertej-paragjyimeve>

Transformimi teknologjik i njeriut – transhumanizmi dhe njeriu 2.0

Festim Rizanaj

Në fillim të shek. XXI, njerëzimi është në agimin e transformimit më të madh në historinë e tij. Lloji ynë do të çlirohet nga kafazi i gjenetikës së saj dhe do të arrijë suksese të paimagjinueshme për sa i përket inteligjencës, progresit material dhe jetëgjatësisë.

Njeriu, gjatë rrugëtimit të tij historik, ka pësuar ndryshime duke filluar nga gjuetia, bujqësia, kalimi në jetën shoqërore e zhvillimi i tregtisë, derisa e zbuloi shkrimin. Më pastaj, e zhvilloi teknologjinë dhe artin e krijoi qytete të mëdha. Nëpërmjet mjeteve të teknologjive të telekomunikacionit dhe të udhëtimit të shpejtë, njerëzit dhe civilizimet krijuan një lidhje të ngushtë. Me televizionin, telefonin dhe më vonë internetin mund të themi se doli në pah njeriu digjital. Edhe pse në të kaluarën ndryshimi ka qenë më i ngadalshëm, kohëve të fundit shohim ndryshime më të shpejta. Njeriu ka pësuar edhe ndryshime biologjike. Siç duket, në të ardhmen do të ndodhin ndryshime më radikale, për shkak se teknologjia po mundëson intervenim në biologjinë e njeriut. Një nga arsytet se pse njeriu filloi të bëjë ndryshime në aspektin biologjik ishte ideja e kurimit të disa sëmundjeve. Nëpërmjet kësaj u pa se njeriu mund t'i tejkalojë kufijtë e tij biologjikë. Në të ardhmen do të vazhdohet me intervenime për zgjatjen e jetës dhe për të jetuar më shëndetshëm.


NJERIU DHE TEKNOLOGJIA

Në fillim të shek. XXI, njerëzimi është në agimin e transformimit më të madh në historinë e tij. Lloji ynë do të çlirohet nga kafazi i gjenetikës së saj dhe do të arrijë suksese të paimagjinueshme për sa i përket inteli-

gjencës, progresit material dhe jetëgjatësisë. Në integrimin e njeriut me makinën, njohuritë dhe aftësitë që do të vendosen në trurin tonë, do të kombinohen me kapacitete të mëdha, shpejtësinë dhe aftësinë e krijimit me teknologjinë. Ku ky kombinimi përbën themelin e epokës së re të njeriut, të quajtur Singularity. Kështu do të përmbledhej libri “*The Singularity is Near: When Humans Transcend Biology*” të autorit Ray Kurzweil, i njohur si një nga baballarët e inteligjencës artificiale dhe i cili paralajmëron një njerëzim që do të integrohet me makineritë dhe inteligjencën artificiale. Nuk është ky vetëm një tekst hyrës, por është një manifest që shpall “një epokë të re” dhe “një njeri të ri” që në vitin 2005. Disa librin e vlerësojnë si “Libri i shenjtë i ndryshimit” që shpreh fatin që po përgatitet për njeriun.¹

Futuristët, teknokratët, miliarderët aventureskë dhe të ashtuquajturit profetë të Silicon Valley ëndërrojnë për një model njerëzor që do të transformohet ose edhe prodhohet përmes evolucionit artificial, duke u integruar me zhvillimet e teknologjisë, kibernetikës, algoritmeve dhe bioteknologjisë.

Ndryshimi i njeriut lidhet me dy forma: e para, intervenimi gjenetik dhe, e dyta, ndër-futja e njeriut me makinën. E dyta sikur ka filluar, ngaqë telefonat na janë bërë të pandashëm. Si duket, me makinën jemi integruar mirë, ndërsa na ka mbetur vetëm që nëpërmjet rrugëve biologjike t'i arrijmë



makinat. Në këtë drejtim veçse kanë filluar punimet. Google dhe Elon Musk, nëpërmjet punimeve, synojnë që njeriun ta lidhin drejtpërdrejt me kompjuter, me fuqinë e të menduarit të komandohet dhe të dhënat t'i dërgohen në tru. Nëse arrihet kjo, atëherë do të bëhet një ndryshim i madh, sepse për herë të parë njeriu do të arrijë në çdo çast në të gjitha të dhënat. Brenda një periudhe të shkurtër, njerëzve do t'u vendosen edhe çipat, edhe pse kjo po kundërshtohet. Por, brenda një kohë të shkurtër, me vetëdëshirë, njerëzit do të kërkojnë që t'u vendoset çipi. Sot kemi orë dore të mençur që na tregojnë pulsën, oksigjenin në gjak dhe gjumin. Hapi tjetër është që këto të dhëna t'i raportohen automatikisht mjekut. Ndërkaq, faza tjetër do të ishte kur inteligjenca artificiale do të na përcaktonte diagnozën, ashtu që nëpërmjet kësaj ndryshimi më i vogël do të vërehet dhe do të mjekohet me kohë. Në vitin 2050 pretendohet se do ta arrijmë këtë teknologji.²

Këtu bëhet fjalë edhe për transferimin e vetëdijes. Në lidhje me këtë kemi tri qasje: biologjike, unë jam truri ose pjesë e saj. Në këtë rast, vetëdija zë vend në tru dhe kështu nuk mund të transferohet në kompjuter ose robot. E dyta, unë jam diçka jomateriale, pra jam shpirti vetë. Në këtë rast nuk mund të ketë vetëdije ku nuk ka shpirt. Kështu vetëm mund t'i transferojmë kujtimet tona në makinë, por këto do të jenë vetëm regjistrime nga jeta. E treta, unë nuk jam as trup as shpirt, por jam gjendje psikologjike (si softuer). Në këtë rast unë jam një gjendje psikologjike, që e vë në funksion truri

dhe në këtë rast është e mundur që të aplikohet në makinë. Pra, vetëdija jonë mund të transferohet në makinë dhe atje mund ta vazhdojë ekzistencën.³

Nëse njeriu nuk është i obliguar që ta vazhdojë jetën në aspektin biologjik dhe dëshiron të makinizohet totalisht, atëherë përkufizimi për të do të ndryshojë dhe do të perceptohet si softuer. Në të ardhmen ekziston mundësia që njeriu të mos ketë dëshirë të jetojë brenda kornizave të trupit biologjik. Disa të tjerë, në bazë të besimeve që kanë, një gjë të tillë nuk do ta lejojnë. Rreziku qëndron se ekzistenca e njeriut si softuer krijon mundësinë e krijimit të disa kopjeve dhe kjo e hap debatin etik të ekzistencës.

Një nga emrat që u popullarizuan kohëve të fundit me pre-supozimet e tij në lidhje me të ardhmen e njeriut, Yuval Noah Harari, në librin e tij "*Homo Deus*", thekson se nëse studimet e fundit të rrënjës së qelizës arrijnë ta krijojnë embrionin, atëherë do të kemi mundësinë që të krijojmë shoqëri me super njerëz.⁴

Një problem tjetër që del në pah në momentin kur truri i njeriut lidhet me makinën është se përvojën e vërtetë jetësore do t'ia ngarkojë trurit në mënyrë artificiale. Problemi qëndron në atë se nuk do të arrijmë të bëjmë dallimin ndërmjet reales dhe virtuale. Përzjerja e së vërtetës me imaginaren do të jetë e keqja më e madhe që do t'i bëhej njeriut. Sot flasim për varësinë ndaj TV-së ose internetit, por

varësia ndaj kësaj makine do ta pamundësojë njohjen e së vërtetës.

TRANSHUMANIZMI

Transhumanizmi, versioni i shtuar dhe i radikalizuar i humanizmit, thekson se njeriu mund të lirohet nga kufijtë biologjikë, mendorë dhe psikologjikë. Transhumanizmi, një lëvizje e dytë (neo)iluminizmi, premton se praktikata e bazuara në teknologji mund ta realizojnë dhe të ndërtojnë një lloj qenie që është në përputhje me botën e teknologjizuar. Në transhumanizëm ekzistenca biologjike e njeriut është vlerësuar si me të meta. Sipas tyre, Njeriu 1.0 ka realizuar kombinimin me makinën bio-bionike, qenie-mendjemakinë, që do të mbështetet nga teknologjia. Në procesin e ri synohet të realizohen Industria 4.0 si alternativë e asaj 3.0, Jeta 3.0 (robotizim) në vend të Jeta 2.0 (digjitalizim) dhe, si alternativë e Zotit, është Homo Deus-i. Pra, po bëhet një përpjekje për të ndërtuar një njeri dhe botë të sterilizuar nga gjendja e mëparshme me llojet dhe përkufizimet e reja, “njeri i ri, jetë e re, rend i ri ekonomik dhe besim të ri”.

Transhumanizmi shpreh dëshirën për të kapërcyer të gjitha mangësitë dhe kufizimet e qenies njerëzore. Me një qëllim “të pafajshëm” së pari, hulumtimet filluan me qëllim për të trajtuar dhe kuruar sëmundjet. Me zhvillimin dhe transformimin teknologjik, kërkimi vazhdon jo vetëm për të përmirësuar, por edhe për të forcuar dhe kapërcyer. Transhumanistët janë një grup të cilët mendimet e tyre i artikulojnë si religjion shkencor. Në shëndetësi është krijimi i organeve artificiale dhe eliminimi i plakjes, ndërsa në fund ka pretendime që edhe vdekja të sfidohet. Transhumanistët thonë se njeriu do t'i plotësojë nevojat fetare me teknologji dhe kështu do të arrijë në nivelin e “zotit”. Sigurisht se këto janë mendime ekstreme, duke pasur parasysh që universi do ta ketë fundin dhe është e pamundur që njeriu të mbetet i pavdekshëm. Ndërkaq, krijimi i organeve artificiale, zgjatja e jetës dhe eliminimi i plakjes është i mundur. Këto kanë filluar të realizohen nëpërmjet qelizave rrënjë. Po ashtu nëpërmjet printerëve 3D krijohen organe njerëzore. Po ashtu, pothuajse është zgjidhur çështja e eliminimit të plakjes nëpërmjet intervenimeve gjenetike. Sigurisht që të gjitha këto, edhe pse do të mundësojnë jetëgjatësinë, nuk mund ta parandalojnë vdekjen. Në këtë kuptim transhumanizmi nuk mund ta sjellë pavdekësinë. Por, do të vijmë në një kohë ku nuk do të dallohen i moshuari më të riun.⁵

Transhumanistët besojnë se truri i njeriut do të zhvillohet njëkohësisht me inteligjencën artificiale. Bashkimi i njeriut me inteligjencën artificiale do të krijojë një singularitet dhe kështu nuk do të jemi në gjendje të dallojmë njeriun nga inteligjenca artificiale.

Transhumanistët besojnë se truri i njeriut do të zhvillohet njëkohësisht me inteligjencën artificiale. Bashkimi i njeriut me inteligjencën artificiale do të krijojë një singularitet dhe kështu nuk do të jemi në gjendje të dallojmë njeriun nga inteligjenca artificiale. Po ashtu transhumanistët besojnë se shtetet nuk do të ekzistojnë dhe do të kemi një botë globale. Disa mendojnë se kur njeriu të lidhet me kompjuter, atëherë nuk do të kemi nevojë për lider politik dhe do të kalohet në një rend ku do të merret parasysh vendimi unanim i shoqërisë. Disa të tjerë mendojnë se do të kalohet në një ultra demokraci, ku secili individ do të jetë pjesë e parlamentit dhe do ta shprehë mendimin e tij, andaj nuk do të ketë nevojë për parti përfaqësuese. Mendohet se nëpërmjet inteligjencës artificiale nevoja e ekzistencës së shtetit do të zvogëlohet. Ka mendime që do të kalohet edhe në shtete më diktatoriale. Kjo mbetet të shihet.⁶

Po ashtu, ekziston frika se do të krijohen probleme nëse elimini i njeriut ekzistues do të krijojë një tip të ri njerëzor. Mund të ekzistojë rreziku i dorëzimit të qenies njerëzore nga ajo për të cilën atë

pretendojnë që e kanë shpëtuar, “Zoti dhe biologjia e njeriut”, te teknologjia dhe kapitali. Në fakt, emra të tillë si Bostrom, Kurzweil dhe Harari, thonë se qenia njerëzore do të ndryshojë dhe do të jetë një “lloj i ri i qenies”. Në shek. XXI, qeniet njerëzore po përpiqen të shndërrohen në një entitet mbi të cilin mjetet kryesore të propagandës për këtë janë: platformat digjitale dhe informatike, video-lojërat, teknologjia multimediale dhe, veçanërisht, kinematografia.

CIVILIZIMI I PESHKUT TË KUQ

Pretendimet e lartcekura vlejnë për një të ardhme më të largët, por sot pronarët e mediave sociale dhe të internetit po e kërcënojnë shtetin. P.sh. Twitter, tash e njohur me shenjën X, nuk është vetëm një media sociale, por një media që ka ndikim të madh edhe në politikë. Google sot i kontrollon të gjitha kërkimet tona digjitale dhe nëse dëshiron mund ta kontrollojë rrjedhën e informacionit. Nëse Google ka një qëndrim politik, atëherë mund t'i fshijë të gjitha artikujt që përmbajnë qëndrim të kundërt. Në sistemet si Google informacioni është monopolizuar dhe është në gjendje të kontrollohet.

Bruno Patino, i cili e kritikon këtë gjendje të sjellë nga teknokratët e kohës sonë, të cilën e quan “Qytetërimi i



peshkut të kuq”, që njëherazi është edhe titull i librit të tij, thekson se “ne jemi kthyer në një peshk të kuq të mbyllur në kavanoz, ku kavanozi jonë janë ekranet tona”. Ekranet dhe “ekonomia e vëmendjes” janë bërë për njerëzit si kavanozi për peshkun e kuq japonez. Ky kavanoz në të cilin është mbyllur njeriu është vetëm një burg i rehatshëm, i cili është në prag të verbimit. Liria e premtuar nuk shkon përtej varësisë dhe mbikëqyrjes së krijuar nga mediat sociale dhe sistemet digjitale dhe kjo përbën një lloj të ri skllavërie, të krijuar nga teknokapitalizmi. “Qytetërimi i peshkut të kuq” e shpreh kështu atë që njerëzit në të vërtetë po përballen: “Ky kapitalizëm i ri digjital prodhon vrull që e zëvendëson zakonet me fokusin dhe kënaqësinë me varësinë. Algoritmet janë mjetet e kësaj ekonomie. Si rezultat, “njerëzit transformohen në një shoqëri të hipnotizuar, të varur nga ekranet, të cilëve u është hequr kuptimi, u janë nënshtruar verbërisht algoritmeve dhe ecin jerm me premtimin se gjithçka do të jetë mirë.”⁷

Mediat sociale, platforma të tilla si Netflix, YouTube ose Spotify, na marrin kohën e cila është e rezervuar për diçka tjetër. Ky është paradoksi. Kjo kohë, të cilën na e marrin këto platforma, është shumë e rëndësishme për të gjithë ne: koha për studime, për familje, për kulturë, për dashuri. Edhe pse ne mendojmë se nuk na ndërhyjnë shumë në jetën tonë, mediat sociale na marrin kohën që e kemi në dispozicion për t’u përqendruar në diçka specifike dhe të rëndësishme. Edhe nëse përpiqemi ta zvogëlojmë kohën tonë të kaluar në smartphone-t, kompanitë i përdorin mjetet më të mira,

kaptologjinë dhe neuroshkencat, për të tërhequr vëmendjen tonë, kështu që gjithmonë duhet t’u kthehemi ekraneve.

Që nga viti 2012, koha e kaluar në telefonat tonë inteligjentë është e dyfishuar në shumicën e vendeve në botë dhe tashme ka arritur një nivel alarmant. Si pasojë e kësaj, disa patologji janë të njohura mirë sot si nomophobia, që do të thotë frikë nga ideja për të qenë pa telefon, pastaj athazagoraphobia, e cila është frikë nga harrimi, e cila po bëhet shumë e rrezikshme dhe sjell depresion tek adoleshentët.⁸

Homo Sapiens-i, i cili beson se jeton në botën më të mirë të mundshme, është në rrugë për të hartuar një “botë” të re njerëzore 2.0, në mënyrë që t’i përmbush nevojat e veta. Kjo ekzistencë e re flet për një lloj evolucioni dhe se supozimet e vjetra në kuptimin e evolucionit janë kapërcyer. Evolucioni nuk u përfundua me Homosapiens, por ai kaloi në një fazë tjetër me atë që e prodhoi.

1 Ray Kurzweil, *The Singularity is Near: When Humans Transcend Biology*, 2005.

2 Enis Doko, “*İnsana er ya da geç çip takılacak!*”, Revista “Lacivert”, nr. 80

3 Enis Doko, “*İnsana er ya da geç çip takılacak!*”, Revista “Lacivert”, nr. 80

4 Yuval Noah Harari, “*Homo Deus: a history of tomorrow*”. 2016

5 Ahmet Dağ, “*Transhümanizm: İnsansız Dünya*”, 2020, Ketebe Yayınları.

6 Ahmet Dağ, “*Transhümanizm: İnsansız Dünya*”, 2020, Ketebe Yayınları.

7 Bruno Patino, “*The civilization of the goldfish, a short treatise on the attention market*”, 2019.

8 Ibid.

Jeta dhe vepra e Imam Kuduriut (v. 428/1037)

Blerton Bahtiri

Imam Kuduriu lindi në Bagdad në vitin 362/973. Duke pasur parasysh se babai i tij ishte dijetar dhe muhadith, ai lindi në një familje shkencore, dhe se ai lindi në një periudhë kur Bagdadi ishte në kulmin e tij në aspektin e dijes dhe shkencës.

Emri i plotë i këtij dijetari të fikhut, i cili u bë i famshëm me pseudonimin Kuduri, është Ebu'l-Husejn Ahmed b. Muhamed b. Ahmed b. Xhafer b. Hamdan el Bagdadi.¹ Nuk ka mendim të përbashkët midis autorëve të shtresave (tabakat) për qëllimin për të cilin është përdorur nisbeja kuduri. Disa thonë se ai quhej kuduri, sepse merrej me prodhimin dhe shitjen e tenxhereve, duke iu referuar kudura, që është shumësi i fjalës kidr, që do të thotë tenxhere dhe kjo është pamja e preferuar.² Edhe pse nga disa shkrimtarë të shtresave (tabakat), thuhej se kishte lidhje me një fshat të quajtur Kudure. Ky shpjegim nuk ishte i popullarizuar për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme.³ Disa autorë ose nuk e kanë përmendur shpjegimin e këtij raporti të Kuduriut ose kanë shmangur një vlerësim për këtë çështje duke thënë 'nuk e dimë pse quhet ashtu'.⁴

Imam Kuduriu lindi në Bagdad në vitin 362/973. Burimet janë dakord për këtë çështje.⁵ Duke pasur parasysh se babai i tij ishte dijetar dhe muhadith, ai lindi në një familje shkencore, dhe se ai lindi në një periudhë kur Bagdadi ishte në kulmin e tij në aspektin e dijes dhe shkencës, ku do të ishte e pamundur që Imam Kuduriu të mos të ndikohej nga ky mjedis. Periudha në të cilën jetoi Imam Kuduriu, përkon me një periudhë në të cilën ishin të pranishëm figura të njohura si Ebu Abdullah el Hakim el Nisaburi (405/1014), Imamu'l Hamejnu el Xhujebani (478/1085), Ebu'l Hasan el Maverdi (450/1058), Ebu Zejd ed Debusi (430/1039),

Hatib el Bagdadi (463/1071) dhe Ebu Ishak el Isferajini (418/1027).⁶

Imam Kuduriu, i cili u angazhua jashtëzakonisht shumë në fushën e fikhut, mori aq famë sa që gjatë kohës së tij ai u bë përfaqësuesi më i rëndësishëm i hanefive në Irak. Ai e rriti edhe më shumë famën e tij me veprën e tij të titulluar El Muhtesar. Përveç që u bë një dijetar i rëndësishëm i fikhut, ai fitoi edhe lavdërimet e dijetarëve në fushën e hadithit duke transmetuar, ndonëse në një numër të vogël, dhe u cilësua si 'saduk' në fushën e hadithit.⁷

Përderisa nuk ka asnjë diskutim që Kuduri vdiq në muajin Rexheb në vitin 1037⁸/428, disa burime tregojnë ditën si dita e pestë e muajit Rexheb.⁹ Disa burime tregojnë gjithashtu se vdiq në muajin Rexheb në ditën e pesëmbëdhjetë të atij muaji. Ditën që ai ndërroi jetë, trupi i tij u varros në varrezat e shtëpisë së tij në Derbu Ebi Halef, që ndodhen në rajonin Katiatu'r-Rebi të lagjes Kerh të Bagdadit. Më vonë, trupi i tij u transferua në varrezat në rrugën Mansur, pranë varrit të Ebu Bekr el Kuarizmit (425/1034), një dijetar hanefi.¹⁰

MËSUESIT E TIJ

1. Ubejdullah b. Muhamed el Havshebi (375/985). Emri i plotë i këtij mësuesi të Imam Kuduriut, i cili transmetohet se ka transmetuar hadith nga ai është Ubejdullah b. Muhamed b. Ahmed b. Muhamed b. Ehva b. El A'vam b. Havsheb b. Ebu'l-Husejn esh Shejbani el Havshebi. Nga El Havshebiu, për të cilin nuk ka shumë informacion në veprat Tabakat,

Imam Kuduriu transmeton një transmetim të rrallë të cilin Hattib el Bagdadi e shënon në librin e tij. Transmetimi është: “Në unazën e Profetit a.s. kishte një mbishkrim “Muhamed Resulullah”.¹¹

2. Muhamed b. Ali Suvejb el Mueddib (381/991). Emri i plotë i këtij mësuesi të Imamit është Ebu Bekër Muhamed b. Ali b. El Husejn b. Ibrahim b. Suvejd el Anberi el Muktib. Në kronikat dhe veprat historike, përmendet për jetën e Kuduriut, se nga ky dijetar ka transmetuar hadithe dhe ka marrë mësim në lëmin e hadithit.¹²

3. Muhamed b. Jahja el Xhurxhani (398/1008). Emri i plotë i tij është Ebu Abdullah Muhamed b. Jahja b. Mehdi el Xhurxhani. Konsiderohej se ishte një dijetar i mirë, një nga juristët kryesorë të medhhebit hanefi në kohën e tij, që qëndroi në Bagdad deri në vdekjen e tij.¹³

NXËNËSIT E TIJ


1. Ebu Bekr es Serhasi (439/1047). Juristi hanefi Abdurrahman b. Muhamed es Serhasi mori mësim fikh nga Kuduriu. Serahsi klasifikoi dy vepra të quajtura Muhtasarul-Muhtasar dhe Tekmiletu't-Texhrid, të lidhura me veprat e mësuesit të tij, të quajtur El Muhtasar dhe Et Texhrid. Ka vdekur në muajin Ramazan në vitin 439 hixhri.¹⁴

2. Mufaddal b. Mesud et Tenuhi (442/1064). Emri i tij i plotë është Muafaddal b. Mesud b. Muhamed b. Ebu'l-Ferexh. Fikhun e ka mësuar nga Imam Kuduriu dhe Imam Sajmeri, ndërsa hadithin e kishte mësuar nga dijetarët e Damaskut dhe të Bagdadit. Imam Tenuhi në degën e fikhut ka shkruar një reddije ndaj Imam Shafiut të quajtur *Et Tenbih*. Por kishte edhe disa libra të tjera si: *Risale fi Vuxhubi Gasli'r-rixhlejn* dhe *El Bejan ani'l-fasli fi'l-Eshribeti bejne'l-Helal ve'l-Haram*. Në sintaksë mund ta përmendim edhe librin e tij të quajtur: *Ahbaru'n-Nahivijin*.¹⁵

3. Ebu'l-Kasim el Ukberi (456/1064). Emri i tij i plotë është Ebu'l-Kasim Abdulvahid b. Ali b. Berhan el Ukberi en Nahvi. Thuhet se ky person, i cili ishte jurist hanefi, nuk ka transmetuar asnjë transmetim, megjithëse ka dëgjuar shumë hadithe. Në degën e fikhut vlen të përmendet libri i tij i titulluar *El Ihtijar*, ndërsa në sintaksë mund ta përmendim librin e titulluar *Usulu'l-Luga*.¹⁶

4. Hatib el Bagdadi (463/1070). Emri i tij i plotë është Ebu Bekër Ahmed b. Ali b. Sabit el Bagdadi. El Bagdadi, i cili filloi të mësojë shkencën që në moshë të re, nuk ishte i kënaqur me arsimimin e tij në Bagdad dhe udhëtoi në shumë vende, veçanërisht në Basra dhe Kufe. Pas përfundimit të shkollimit, ai ia kushtoi gjithë kohën shkrimit të historisë së Bagdadit për më shumë se njëzet vjet.¹⁷

Hatib el Baghdadi ka një klasifikim prej gati njëqind veprash në fushën e hadithit, metodologjisë së hadithit,




teksteve të hadithit dhe fushave të tjera, veçanërisht veprës së tij voluminoze “*Historia e Bagdadit*”.

5. Ebu Nasr el Akta' (474/1081). Emri i plotë i tij është Ebu Nasr Ahmed b. Muhamed b. Muhamed. Kur u bë kompetent në fushën e fikhut, iu qas edhe matematikës dhe shkencave të tjera. Ai u largua nga Bagdadi në vitin 430/1038 dhe u vendos në rajonin e Ehvazit, ku në këtë rajon vazhdoi si myderriz derisa vdiq.¹⁸

6. Ebu Abdullah ed Damegani el Kebir (478/1085); Emri i tij i plotë është Ebu Abdullah Muhamed b. Ali b. Muhamed b. el Husejn b. Abdulmelik. Thuhet se Damegani, i cili u ngrit në presidencën irakiane që i përkiste shkollës hanefite, kishte njohuri për jurisprudencën shafiite po aq sa një shafi. Ka vdekur në Bagdad.¹⁹

7. Ebu'l-Harith es Serahsi. Emri i plotë i tij është: Ebu'l-Harith Muhamed b. Ebu'l-Fadl Muhamed es Serahsi. Imam Kuduriu e kishte lavdëruar atë duke thënë: “Nuk ka njeri më jurist se ai në Horasan dhe Ajnu'n-Nahr”. Ai ishte një nga studentët kryesorë të Kuduriut. Kur u sëmur nga melankolia për shkak të punës së tepërt, Sarahsiu përkundër këshillës së mjekëve që ta ndalojë punën dhe aktivitetin e tij, ai vazhdoi dhe thuhet se ai u përmirësua kur rifilloi mësimet e fikhut.

Kalifi abasid,
Kadir Bilah, u
kërkoi
dijetarëve
kryesorë të
secilit prej
katër shkollave
juridike të
përgatisnin një
vepër koncize
të fikhut. Pas
kësaj, Kuduri,
një nga
hanefitë, mori
përsipër këtë
detyrë dhe
shkroi
El Muhtasar,
i cili konside-
rohet një nga
tekstet bazë të
shkollës të tij.



Ai kishte thënë: “Nëse doni që unë të përmirësohem, më lejoni të kthehem në mësimet e mia”. Thuhet se ka ndenjtur edhe në Bagdad për rreth 12 vjet.²⁰

LIBRAT E TIJ

1. El Muhtasar/ El Kitab

Kjo vepër, e cila fitoi famë të jashtëzakonshme në rrethin hanefi dhe u bë doracak i hanefive, ka bollëkun dhe prestigjin që i atribuohet Risales së Ibën Ebi Zejd el Kajravanit në medhhebin maliki. Njihet gjithashtu si El Kitab, si Muhtasar i Ishak el Xhundi. Si arsye për shkrimin e veprës tregohet historia e mëposhtme: Kalifi abasid, Kadir Bilah, u kërkoi dijetarëve kryesorë të secilit prej katër shkollave juridike të përgatisnin një vepër koncize të fikhut. Pas kësaj, Kuduri, një nga hanefitë, mori përsipër këtë detyrë dhe shkroi El Muhtasar, i cili konsiderohet një nga tekstet bazë të shkollës të tij. Maverdi (364-450), të cilit iu dha detyra nga shafitë, përgatiti një vepër të quajtur El Ikna, dhe Kadi Abdulvahhab (362-422), nga malikitë, përgatiti një përmbledhje.²¹

2. Et Texhrid; Megjithëse temat në Texhrid janë të dizajnuara sipas sistematikës klasike *furu*, ajo ndryshon nga librat e tjerë *furu* në qasjen dhe mënyrën e trajtimit dhe diskutimit të çështjeve të diskutueshme.

3. Sherhu Muhtasari'l-Kerhi; Ky transkriptim i Kuduriut është koment i bërë mbi librin muhtasar të Ebu'l-Husejn el Kerhi (340/951).²²

4. Edebu'l-Kadi ala Medhhebi Ebi Hanife.

5. Et-Takrib.

6. Mesailu'l-Hilaf bejne Ashabina.

7. Xhuz'un fi'l-Hadith.

8. Nubdhe min Menakibi Ebi Hanife.

9. Muhtasarin Xheme'ahu li'bnihi.

1 Ibën Hallikan, *Vefejatu'l-A'jan*, vell. I, fq. 78; Gazzi, Takijjuddin, *et-Tabakatu's-Senijje*, vell. II, fq.19; Ibnu'l-Esir,

el-Lubab, vell. 3 fq.19.

2 Kuduri, *et-Texhrid*, vell. I, fq.8; Kurashi, *el-Xhevahiru'l-Mudijje*, vell. 2, fq.336; Kellek Xhengiz, “Kuduri” *DIA*, vell. XXVI, fq.321.

3 Leknevi, *el-Fevâidu'l-Behijje*, fq.17; Kellek Xhengiz, “Kuduri” *DIA*, vell. XXVI, fq.321.

4 Hatib el-Bagdadi, *Tarihu Bagdad*, vell. V, fq.140; İbn Hallikan, *Vefejatu'l-A'jan*, vell. I, fq.78; Dhehebi, *Sijeru*

a'lâmi'n-nubela, vell. XIII, fq.224.

5 Gazzi, Takijjuddin, *et-Tabakatu's-Senijje*, vell. II, fq.19; Ibnu'l-Esir, *el-Lubab*, vell. II, fq. 19; İbn Hallikan, *Vefejatu'l-A'jan*, vell. I, fq.78; Hatib el-Bagdadi, *Tarihu'l-Bagdad*, vell. V. fq.140.

6 Kuduri, *et-Texhrid*, vell. I, fq.8.

7 Kurashi, *el-Xhevahiru'l-Mudijje*, vell. I, fq.93; Gazzi, Takijjuddin, *et-Tabakatu's-Senijje*, vell. II, fq.19; Kellek, Xhengiz, “Kuduri” *DIA*, vell. XXVI, fq.321.

8 Katib Çelebi, *Sullemu'l-Vusul*, vell. I. fq.200; Semani, *el-Ensab*, vell. XX, fq.352; Dhehebi, *Sijeru A'lami'n-Nubela*, vell. XXIII, fq.224.

9 Hatib el Bagdadi, *Tarihu'l-Bagdad*, vell. V, fq. 140; İbn Hallikan, *Vefejatu'l-A'jan*, vell. I, fq.78.

10 Kuduri, *et-Texhrid*, vell. I, fq.8; İbn Hallikan, *Vefejatu'l-A'jan*, vell. I, fq.78; Kellek, Xhengiz, “Kuduri” *DIA*, vell. XXVI, fq.321.

11 Hatib el Bagdadi, *Tarihu'l-Bagdad*, vell. XX, fq.360.

12 Kellek, Xhengiz, “Kuduri” *DIA*, vell. XXVI, fq.321.

13 Hatib el Bagdadi, *Tarihu'l-Bagdad*, vell. IV, fq.683.

14 Zirikli, *el-A'lam*, vell. III, fq.326; Katib Çelebi, *Sullemu'l-Vusul*, vell. II, fq.267.

15 Katib Çelebi, *Sullemu'l-Vusul*, vell. III, fq.347;

Kurashi, *el-Xhevahiru'l-Mudijje*, vell. II, fq.179.

16 Dhehebi, *Sijeru A'lami'n-Nubela*, vell. XIII, fq. 343.

17 Kandemir, M. Jashar, “Hatib el-Bagdadi” *DIA*, vell. XVI, fq.452-460.

18 Kurashi, *el-Xhevahiru'l-Mudijje*, vell. I, fq.312.

19 Kurashi, *el-Xhevahiru'l-Mudijje*, vell. III, fq.269-270.

20 Kuduri, *et-Texhrid*, vell. I, fq.11.

21 El Hamevi, Jakut, *Mu'xhemu'l-Udeba*, vell. V, fq.1956.

22 Kellek, Xhengiz, “Kuduri” *DIA*, vell. XVI, fq.321; Katib Çelebi, *Keshfu'z-Zunun*, vell. II, fq.1634.

Një jetë kushtuar fesë

ISLAM EF. (SADIK) PEPIQ, IMAMI 72-VJEÇAR QË PËR DECENIE ME RADHË ISHTE NË SHËRBIM TË XHAMISË

Mihana Goga

Islam ef. (Sadik) Pepiq lindi më 01.11.1951 në fshatin Shipshanik të komunës së Tuzit, në një familje me tradita fetare e liri-dashëse nga fisi Pepiq, që është një ndër fiset më të mëdha në komunën e Tuzit. Është i martuar me znj. Fife, me të cilën kanë tre fëmijë: vajzat, Sanellën e Sellmën dhe djalë, Kenanin. Shkollën fillore e përfundoi në IP SHF “MAHMUT LEKIQ” dhe gjatë asaj kohe, saktësisht në moshën 8-vjeçare, hyri në mejtepin e xhamisë “Qazim Begova” në qendër të Tuzit, ku mësoi nga hoxha, Rexhep ef. Lika. Në këtë mejtep ka përfunduar Ilmihal 1, Ilmihal 2 dhe shkronjat e Kuranit.

Në vitin 1968 përfundoi shkollën fillore dhe planifikoi të udhëtonte në Amerikë me kushërinjtë e tij, mirëpo i ndikuar nga prindërit, sidomos nga nëna e tij, Hanifeja, e cila ishte e bija e Rexh ef. Brahimit (imamit që kishte shërbyer 50 vjet pa pagesë në fshatin Dinoshë), e cila e ushqeu me edukatë fetare e me besim tek Allahu xh.sh., i lind dëshira që të niste rrugën e edukimit, të besimit e të arsimimit fetar islam. Nëna e tij dinte shumë xhuza të Kuranit në mendje, sa që shpeshherë Islam efendiun e përcillte, e ndihmonte dhe e korrigjonte gjatë leximit.

Në mejtep arriti rezultate të mira, u tregua fëmijë i zgjuar dhe i etur për dije fetare. Në vitin 1969, vazhdoi të ndiqte programin për përgatitje të provimeve të medresesë nga imami, Idriz ef. Demiri në Tivar, në xhaminë “Omer Bashiq”. Ky program ishte dy vjet, mirëpo Islam ef. e përfundoi për një vit. Në Tivar ka banuar së bashku me Osman Zagen dhe çdo ditë kanë shkuar të ndjekin mësimet

fetare në lëndët Kuran, fikh, hadith, gjuhë arabe.

Në vitin 1970 u regjistrua në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë, ku u mirëprit shumë mirë nga profesorët Sherif Ahmeti, i cili ligjëronte lëndën e akaidit, pastaj mulla Reshiti, i cili ligjëronte lëndën e fikhut, Selim Maloku, i cili ligjëronte lëndën e gjuhës arabe, e në vitin e fundit edhe nga profesor Qazim Qazimi, që i ligjëroi lëndën e gjuhës arabe.

“Të gjithë nxënësit e Malit të Zi, profesorët dhe i gjithë stafi i Medresesë më kanë nderuar e afruar afër vetes, e Medreseja mu bë fole e ngrohtë mësimi e edukimi” – kujton me mallëngjim hoxha. Përveç mësimet në Medrese, ai kishte dëshirë të merrej edhe me aktivitete sportive, ku pasion e kishte futbollin. Ai tregon se gjatë asaj kohe luanin çdo ditë dhe kishin formuar një ekip. Ekipi ishte i organizuar mirë dhe kishin luajtur me të gjitha shkollat e mesme në Prishtinë ku korren fitore në të gjitha lojërat derisa erdhën në finale me shkollën e mjekësisë në stadiumin e Flamurtarit. Aty ishin pjesëmarrës më shumë se një mijë njerëz dhe ekipi i tyre fitoi lojën. Ky është kujtimi më i këndshëm i hoxhës që sa herë kujton Prishtinën, kujton fitoren që arriti gjatë kohës sa ishte nxënës në Medrese.

Pasi përfundoi Medresenë, në vitin 1973, kthehet në vendlindje, ku filloi punën si imam në xhaminë e Dinoshes. Sipas sistemit të atëhershëm një vit pas, në gusht të 1974, shkoi në ushtri në Slloveni. Pasi përfundoi ushtrinë, hoxha shprehu interesimin për punësim. Në vitin 1975, shkoi në Bashkësinë Islame dhe kërkoi që të punësohet, Shyqyri Bakalli, kryetari i atëhershëm i propozoi që atë xhuma

“Të gjithë nxënësit e Malit të Zi, profesorët dhe i gjithë stafi i Medresesë më kanë nderuar e afruar afër vetes, e Medreseja mu bë fole e ngrohtë mësimi e edukimi” – kujton me mallëngjim hoxha.



Në foto objekti për të cilin bëhet fjalë

të shkonte në Plevle që ta falte namazin e xhumasë. Të nesërmen hoxha planifikoi të shkonte në Plevle, por po atë ditë ndërroi jetë Shyqyri ef. Bakalli. Atëherë hoxha u punësua në xhaminë kryesore në Podgoricë “Starodoganjske” si imam, duke zëvendësuar Halil ef. Seferoviq, i cili ishte ushtrues detyre i kryetarit. Hoxha punoi si imam një vit e tetë muaj aty, dhe përveç xhumave i falte pesë kohët e namazit, mësonte nxënësit në mekteb dhe kryente të gjitha shërbimet fetare që ishin të nevojshme.

Në tetor të vitit 1977, u emërua imam në Plevle, në xhaminë “Haxhizekerija” në periudhën dy vjeçare, pastaj në xhaminë “Rizvanije” ku shërbeu plot nëntë vjet e gjysmë deri në vitin 1987. Aty i falte pesë kohët e namazit. Pasi që xhamia kishte nevojë për renovim, hoxha i nderuar angazhohet dhe kërkon ndihmë për renovimin e xhamisë të cilën e përfundoi me sukses.

Mulla Islami shërbeu me pasion, tregoi vullnet e aftësi, ishte korrekt dhe i rregullt në namaze, jepte shembull të mirë te besimtarët. Para tyre gjithnjë shkonte i përgatitur. Kërkonte rregull dhe disiplinë.

Gjatë kohës sa ishte imam në Plevle, i inspiruar nga shoku i tij, Shaqir Ismaili, së bashku regjistrojnë me korrespondencë shkollën e lartë pedagogjike në Gjakovë në drejtimin histori-geografi, të cilën e përfundojnë me sukses dhe në vitin 1981 diplomojnë, ku marrin titullin arsimtar i historisë dhe gjeografisë.

Në vitin 1987, rikthehet në Tuz si imam në xhaminë “Qazim Begova” dhe njëherësh emërohet kryeimam. Ai po ashtu ka qenë anëtar i Kuvendit të Bashkësisë Islame në Mal të Zi për gjashtë mandate nga katër vjet dhe sekretar i Shoqatës së Ulemave të Malit të Zi për dy mandate nga katër vjet. Në xhaminë që shërbeu hoxha filloi renovimin e saj që

nga themeli, duke rinovuar kështu të gjitha muret, pullazin e ri, tjegullat e reja. Ai gjeti mbështetje nga diaspora, posaçërisht nga Ismet dhe Kemal Pepiq, të cilët i dërguan njëzetë mijë dollar për renovimin e xhamisë.

Gjatë kësaj kohe ishin edhe dy xhamia të vjetra në Vllanjë e në Vrane, të cilat i kanë rrënuar nga themeli dhe i kanë rindërtuar të reja. Në punën e tij 36-vjeçare ka ndërtuar xhaminë “Nizamska” në Tuz së bashku me ndihmën e turqve, xhaminë në Karabushko, xhaminë në Shipshanik, xhaminë në Kodrabudani me ndihmën e mërgimtarëve nga diaspora, posaçërisht nga Kalifornia dhe Nju Jorku. Hoxha i nderuar nuk e shfrytëzoi asnjë pushim vjetor, vetëm e vetëm që të jetë afër xhemit gjithherë dhe në këtë periudhë -48vjeçare asnjë kohë e namazit nuk i ka ikur pa e falur në xhami, për çka e falënderon Allahun xh.sh.. Gjithashtu ka mbajtur ligjërime për vlerën e gruas në Islam dhe ka këshilluar që ato të vijnë në xhami, saqë tani numri i pjesëmarrësve shkon deri në pesëdhjetë veta. Në mesin e shumë nxënësve të suksesshëm që veprojnë sot janë edhe shumë profesoresha, doktoresha, besimtare të suksesshme.

Në vitin 1994, hoxha udhëtoi në Kaliforni dhe Nju Jork, që të vizitonte xhemin. Një muaj Ramazan mbajti ligjërime fetare. Atje i njoftoi për një hajrat – vakëf, që quhet “SARAJ-M”, e që kishte nevojë për renovim dhe ndërtim edhe të një kati, ku hoxha tuboi të holla dhe arriti ta përfundonte me sukses këtë projekt.

Po ashtu, Organizata Humanitare “Ille”, në krye me drejtorin Kenan Pepiq, kanë mbështetur gjithherë të gjitha aktivitetet e hoxhës, qoftë me zekat, qoftë me ndihma për nevojtarë, me sponsorizimin e shumë iftareve me qëllimin e vetëm që të arrihet kënaqësia e Zotit xh.sh., ndihmë të cilën e vazhdon edhe sot.

Me emocione ai rrëfen që këtë Ramazan, nipi i tij, Azizi, medresist fali namazet e teravive në vendin ku gjyshi tij nisi misionin jetësor. Ai po ashtu po ndjek mësimin e hifzit, për çka hoxha ndihet i plotësuar dhe falënderues ndaj Allahut xh.sh., që traditën po e vazhdon edhe nipi i tij.¹

Gjatë këtyre viteve puna e tij vlerësohet. Ai predikon me pasion dhe kompetencë. Ligjëratat i jep saktë, bindëse e kuptueshëm. Ishte korrekt në detyrë sa që asnjë namaz i sabahut nuk e ka lënë pa e fal në xhami me xhemit. Gëzon respekt dhe autoritet dhe gjithë jetën e tij interesohej për riparimin dhe mirëmbajtjen e xhamive në komunën e Tuzit.

¹ Intervista është zhvilluar në mjediset e Qendrës Kulturore-Informative “Malësia”, në xhaminë “Qazim Begova” dhe në lokalit “Saraj-M” në Tuz, më 14 dhe 15 shtator 2023.

Nënshkruesit e Pavarësisë së Shqipërisë dhe uniteti i qëndrimeve të tyre në aktin e pavarësisë

Agon Krasniqi

HYRJJE

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë është një akt që shënon triumfin e delegatëve dhe popullit shqiptar në lidhje me qenësinë dhe identitetin shqiptar mbi integritetin territorial të Shqipërisë, e cila e kishte ruajtur këtë integritet përmes organizimit dhe administrimit të vilajeteve shqiptare në kohën e Perandorisë Osmane. Ky triumf shënoi edhe mbrojtjen historike të shqiptarëve, kundrejt rrezikut të shteteve fqinje, shtete këto që kishin për qëllim ekspansionin në tokat shqiptare. Si rezultat që viti 1912 rezultoi me fillimin e luftës ballkanike, ishte fillimi i rrugës për finalizim, në lidhje me mëvetësinë e popullit shqiptar. Kjo rezultoi që shtetet ballkanike kishin për qëllim pushtimin e tokave shqiptare, toka këto që sundoheshin nga Perandoria Osmane, por viteve të fundit perandoria kishte rënë sa i përket fuqisë politike, ekonomike dhe ushtarake dhe si rezultat i kësaj kishte lindur nevoja e krijimit të shtetit shqiptar, si formë mbijetese kundrejt shteteve ballkanike. Ky formim i shtetit kishte mbështetje sa i përket statusit të vilajeteve dhe demografisë në zonat ku shqiptarët do formonin shtetin e tyre. Ishin pikërisht vilajetet shqiptare dhe demografia faktorët kyçë të domosdoshmërisë së formimit të shtetit shqiptar dhe një formë thelbësore e rrugës së promovimit të popullit dhe shtetit të ri shqiptar në Evropë dhe më gjerë.

Uniteti i qëndrimeve politike të delegatëve shqiptarë ishte faktor kyç i formimit të shtetit. Pavarësisht se në mesin e delegatëve kishte

ndarje sa i përket aspektit religjioz, bashkimi i tyre në kontekstin politik mbi formimin e shtetit shqiptar ishte unik.

SHPALLJA E PAVARËSISË DHE UNITETI POLITIK I NËNSHKRUESVE


Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë u bë me 28 nëntor 1912, në shtëpinë e Xhemil Bej Vlorës. Kuvendi Kombëtar i Vlorës u bë në prezencën e katërdhjetë delegatëve, që pas leximit të shpalljes së pavarësisë nga ana e Ismail Qemalit, do të nënshkruanin deklaratën e pavarësisë së Shqipërisë. Këta nënshkrues nuk ishin liderë të zonave të tyre ku jetonin, megjithatë gëzonin autoritet, çka i bëri ata që të jenë pjesë e Kuvendit Kombëtar.¹ Pas nënshkrimit të deklaratës së pavarësisë së Shqipërisë, rezultoi edhe mbajtja e 7 mbledhjeve të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, mbledhje këto që u mbajtën nga 28 nëntori gjerë më 7 dhjetor të vitit 1912², ku kishin për qëllim caktimin e qeverisë shqiptare dhe organizimit të shtetit të ri shqiptar.³

Pjesëmarrja e Kuvendit Kombëtar të Vlorës, që shpalli pavarësinë e Shqipërisë korrespondon me të gjitha zonat shqiptare, duke përfshirë edhe qytetet që ndodheshin të pushtuara nga ushtritë serbe, malazeze dhe greke, si rezultat i luftërave ballkanike. Kjo bëri që ky kuvend të kishte karakterin e një asambleje mbarëshqiptare.⁴ Kjo asamble është tregues i qartë që uniteti i shqiptarëve ishte për shpëtimin e tokave shqiptare nga qëllimet ekspansioniste të shteteve ballkanike.

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë u bë me 28 nëntor 1912, në shtëpinë e Xhemil Bej Vlorës. Kuvendi Kombëtar i Vlorës u bë në prezencën e katërdhjetë delegatëve, që pas leximit të shpalljes së pavarësisë nga ana e Ismail Qemalit, do të nënshkruanin deklaratën e pavarësisë së Shqipërisë.

Ky unitet i nënshkruesve paraqitet për shkak të disa çështjeve; si çështje e parë konsiderohet rezistenca e bashkuar e shqiptarëve pa dallim bindjeve fetare kundër rrezikut të shteteve ballkanike. Si çështje e dytë shënohet kërkesa e bashkuar e shqiptarëve sa i përket mendimit politik që të njihej situacioni politik, demografik dhe administrativ mbi formimin e shtetit shqiptar, pasi që formimi i shtetit shqiptar nuk ishte cenim i perandorisë, pasi që cenimi vinte pikërisht

Uniteti politik i disa nënshkruesve si: Bedri Pejani, Dom Nikollë Kaçorri, Abdi Bej Toptani, Salih Gjuka, Mustafë Kruja, Rexhep Mitrovica, vërehet kur ata i drejtohen perandorit Austro-Hungarez, Jozefit, me një letër që t'i ndihmonte shqiptarët kundrejt sulmeve të shteteve ballkanike. Ideja e këtyre nënshkruesve ishte që të ruheshin kufijtë e vilajeteve shqiptare dhe të bëhej konstituimi i tyre në një shtet autonom nën Perandorinë Osmane. Megjithatë si rezultat që dobësimi osman ishte një pasqyrë e përgjithshme në këtë kohë, marrë parasysh edhe humbjet e mëparshme të osmanëve si në Libi, kjo politikë do të ndryshohej dhe uniteti i nënshkruesve të pavarësisë do ishte për shpëputje të përgjithshme nga perandoria, duke shënuar edhe fundin e



Ismail Qemali	Luigj Gurakuqi	Nikollë Kaçorri
Jani Minga	Jorgji Karbunara	Abdi Toptani
Abaz Dilaveri	Zihni Abaz Kanina	Elmas Boçe
Murad Toptani	Vehbi Agolli	Spiro Ilo
Thanas Floqi	Ferit Vokopola	Lef Nosi
Hajredin Cakrani	Mustafa Kruja	Mit'hat Frashëri
Ymer Deliallisi	Bedri Pejani	Dhimitër Berati
Qazim Kokoshi	Veli Harxhi	Aristidh Ruçi
Dr. H. Myrtezai	Rexhep Mitrovica	Shefqet Daiu
Dhimitër Tutulani	Nebi Sefa Lushnja	Zyhdi Ohri
Salih Gjuka	Xhelal Koprëncka	Qemal Karaosmani
Iliaz Bej Vrioni	Dhimitër Mborja	Dhimitër Zografi
Pandeli Cale	Qemal Mullaj	Xhemal Deliallisi dhe Nuri Sojliu

Nënshkruesit e Pavarësisë së Shqipërisë

sundimit osman në trevat shqiptare. Kjo dëshmohej edhe nga intervista e botuar në gazetën “Zeit” në Vjenën e Prenk Bibdodës, ku thekson për unitetin e përbashkët ndërmjet shqiptarëve myslimanë dhe katolikë.⁶

Bashkimi i mendimit politik të nënshkruesve të pavarësisë dallohet edhe në mbledhjen e mbajtur në Bukuresht më 5 nëntor të vitit 1912. Misionarët që më pas do të ishin nënshkruesit e pavarësisë si: Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Dhimitër Zografi, Dhimitër Berati, etj., e paraqitën mendimin e përbashkët mbi qëllimin e shteteve ballkanike për trojet shqiptare. Ishin tri pika të mendimit të bashkuar politik që u ndërmorën në Bukuresht: krijimin e një komiteti drejtues që kishte atributet e një qeverie përfaqësuese, ndërtimi i një komisioni i përbërë nga shqiptarë të ditur dhe të njohur të cilët do dilnin në Evropë në mbrojtje të drejtave të kombit shqiptar.

Së fundi, uniteti politik i nënshkruesve vërehet edhe në bashkimin e tyre përreth misionit të Ismail Qemalit në takim me Bertholdin, takim ky që rezultoi me vendimin se a do kishte autonomi për shtetin shqiptar apo pavarësi. Ishte pikërisht ky takim që e bëri Ismail Qemalin figurë qendrore të pavarësisë dhe të parin e nënshkruesve të pavarësisë. Kjo më pas vërehet edhe me formimin e qeverisë së parë shqiptare në krye me Ismail Qemalin.

PËRVJETORI I PAVARËSISË SË SHQIPËRISË (28 NËNTOR 1913).⁷

Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë⁸


Vlen të theksohet se në faqen e dytë të deklaratës së pavarësisë së Shqipërisë, kemi nënshkruesit si: Mustafë Kruja, Ferit Vokopola, Ymer Deliallisi, Xhemal Deliallisi, Sefa Lushnja, Zyhdi Ohri.⁹

Nga telegrami që Ismail Qemali i dërgon Perandorisë Osmane dhe fuqive të mëdha, ai njofton shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe thekson se: “Kuvendi Kombëtar, i përbërë prej delegatësh nga të gjitha anët e Shqipërisë pa dallim feje, të mbledhur sot në qytetin e Vlorës, shpalli pavarësinë politike të Shqipërisë [...], dhe formoi një qeveri të përkohshme me detyrën e mbrojtjes së të drejtave të popullit shqiptar, të kanosur nga rreziku i shfarosjes prej ushtrisë serbe.”¹⁰ Kështu uniteti politik i shqiptarëve, në krye me qeverinë e përkohshme të Ismail Qemalit, ishte treguesi kryesor i krijimit dhe formësimit të shtetit të ri shqiptar.

UNITETI POLITIK I NËNSHKRUESVE DHE DELEGATËVE TË TJERË NË MBLEDHJET E KUVENDIT KOMBËTAR TË VLORËS

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Kuvendi Kombëtar i Vlorës hapi mbledhjen e parë.¹¹ Në tërësi, u mbajtën 7 mbledhje në datat ndërmjet 28 nëntorit – 7 dhjetorit të vitit 1912. Mbajtja e këtyre mbledhjeve që filloi pikërisht pas shpalljes së pavarësisë, kishte për qëllim formimin e qeverisë së përkohshme shqiptare¹² dhe organizimin e shtetit të ri shqiptar. Uniteti i nënshkruesve dhe delegatëve të tjerë ka përbashkësi në disa pika, megjithatë në disa pika të tjera ka ndasi politike.

Mbledhja e parë e Kuvendit Kombëtar i hapi punimet dy orë pas shpalljes së pavarësisë, në shtëpinë e Xhemil Beut. Në mbledhjen e parë delegatët shqiptarë u pajtuan njëzëri që Ismail Qemali të ishte kryetar i Kuvendit, ndërsa shkronjës i parë dhe i dytë të ishte Luigj Gurakuqi dhe Shefqet Daiu. Në mbledhjen e dytë të Kuvendit Kombëtar që u mbajt me 30 nëntor, delegatët kishin pajtueshmëri në formimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Brendshme, Ushtrisë dhe Sigurisë, Ministrisë së Përbotëshme, Kursimit, Drejtësisë. Zgjedhja e këtyre bëhej nga ana e kryeministrit. Në anën



tjetër si rezultat që Ismail Qemali u zgjodh kryeministër i Qeverisë së përkohshme, pozita e kryetarit të kuvendit i kaloi Myfti Vehbi Efendiut dhe u bë formimi i pleqësisë me përbërje prej 18 anëtarësh. Në mbledhjen e tretë të 1 dhjetorit, delegatët u pajtuan për delegacionin që do shkonte në kancelaritë evropiane. Në mbledhjen e katërt të 4 dhjetorit, Ismail Qemali propozoi kabinetin qeveritar me ministrat si: Mehmet Pashë Tetova, Myfit Bej Libohova, Aziz Pashë Efendiut, Abdi Bej Toptani dhe Mit'hat Frashëri. Këtu shohim ndasi ndërmjet delegatëve, pasi që nuk pajtohen me kabinetin qeveritar të Ismail Qemalit si rezultat që të gjithë ishin myslimanë. Kjo u kundërshtua nga Dud Karbunara, Pandeli Cale, Dhimitër Berati dhe Qemal Bej Elbasani. Në mbledhjen e pestë të mbajtur me 4 dhjetor, Ismail Qemali propozoi zgjedhjen e 8 ministrave (katër myslimanë dhe katër katolikë). Në anën tjetër përzgjedhja e kabinetit u realizua përmes votimit, ku u zgjodh kabineti qeveritar me përbërje si: *Ismail Qemali, kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme, zv.kryeministër Dom Nikollë Kaçorri, ministër i Brendshëm, Myfid Neki Beu, ministër i Luftës, Mehmet Rushdi Pasha, ministër i Drejtësisë, Petro Poga, ministër i Financave, Abdi bej Toptani, ministër i Arsimit, Luigj Gurakuqi, ministër i Punëve Botërore, Mit'hat Frashëri, ministër i Bujqësisë, Pandeli Cale, ministër i Telegrafës, Lef Nosi*. Në mbledhjen e gjashtë të 6 dhjetorit u diskutua për përfaqësuesit e çështjes shqiptare në Evropë, dhe në mbledhjen e shtatë të 7 dhjetorit u diskutua

mbi marrëdhëniet ndërmjet pleqësisë dhe qeverisë, çështjen fetare ku u formua myftinia shqiptare e shkëputur nga shehul-islami osman dhe aspekte të tjera të organizimit shtetëror.¹³

- 1 Valentina Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, (Tiranë: Albas, 2014), f. 21.
- 2 Shpuza, Gazmend., et al. *Historia e Popullit Shqiptar III. Periudha e pavarësisë 28 nëntor 1912 – 7 prill 1939*, (Tiranë: Toena, 2007), f. 17.
- 3 Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, f. 24.
- 4 Kristaq Prifti., et al. *Historia e Popullit Shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX – 1912*, (Tiranë: Toena, 2002), f. 511.
- 5 Zhvillimi i luftërave ballkanike ishte një koalicion i shteteve ballkanike si: Serbia, Greqia, Bullgaria, Mali i Zi kundër Perandorisë Osmane. Shih: Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, (Tiranë: Çabej, 1997), f. 390.
- 6 Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, (Tiranë: Uett Press, 2012), f. 433.
- 7 Fotografia e njohur e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, në fakt është realizuar në 1 vjetorin e pavarësisë, në shtëpinë e Xhemil Bej Vlorës, ku i kishte mbajtur punimet Kuvendi Kombëtar. Shih: Arben Puto, *Shqipëria Politika 1912-1939*, (Tiranë: Toena, 2009), f. 37.
- 8 Fotografia origjinale e deklaratës së pavarësisë së Shqipërisë, e gjendur në fototekën Marubi. Shih: Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, f. 465.
- 9 Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, f. 465.
- 10 Ismail Qemali, *Kujtime*, (Tiranë: Toena, 2009), f. 418.
- 11 Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë gjatë shek. XX*, (Tiranë: Ideart, 2004), f. 58.
- 12 Barbara Jelavich dhe Charles Jelavich, *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804-1912*, (Tiranë: Dituria, f. 212.
- 13 Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, f. 455-463.

AMBASADORI I TURQISË UROI MYFTIUN TËRNAVA



Më 23 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, z. Tunc Angili, i cili shoqërohej nga atasheu për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Bunjamin Albayrak.

Në këtë takim, ambasadori z. Angili, uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e

tij edhe për një mandat në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar punë të mbarë, të suksesshme e të bereqetshme. Ai tha se një bashkëpunim i mirë i deritanishëm ndërmjet dy institucioneve duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen, për çka shprehu gatishmërinë e tij për një gjë të tillë.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë, falënderoi ambasadorin z. Angili dhe atasheun z. Albayrak për urimet dhe për bashkëpunimin e mirë që kanë pasur deri më tani si institucione me Bashkësinë Islame të Kosovës. Ai tha se vetëm të bashkuar mund t'i çojmë proceset përpara dhe se vetëm kështu mund të kontribuojmë për të mirën e qytetarëve tanë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFIN E UNDP-SË NË KOSOVË, Z. NUNO QUEIROS



Më 13 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim shefin e UNDP-së në Kosovë, z. Nuno Queiros.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje z. Queiros në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e ri. Ai më pas

e njohu atë me historikun, punën dhe aktivitetet që zhvillon ky institucion. Myftiu Tërnavë, më pas foli edhe për bashkëpunimin me UNDP-në në sfera të ndryshme, sidomos në dialogun ndërfetar dhe ndëretnik.

Nga ana e tij, shefi i UNDP-së në Kosovë, z. Queiros, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për gatish-

mërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut që të kenë një bashkëpunim të mirë me organizatat dhe misionet diplomatike në vend, e në veçanti me UNDP-në. Ai çmoi lart kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë në proceset e ndryshme në të cilat ka kaluar Kosova, e në veçanti për kontributin e dhënë në dialogun ndërfetar dhe ndëretnik.

U PËRURUA OBJEKTI PËR SHËRBIME FETARE NË SHTIME

Më 3 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me përfaqësues të Këshillit të Bashkësisë Islame të Shtimes dhe besimtarë të shumtë përuruan objektin e ri të Xhamia e Re në Shtime. Përveç përurimit të objektit të ri, në Xhaminë e Re të këtij qyteti me anë të një manifestimi kulturor u shënua Muaji i Mevludit, i cili u pasurua me ligjëratë, ilahi dhe lexim të Kuranit.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë mbajti ligjëratë kushtuar porosive të Pejgamberit a.s..

Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Shtimes, Skender Baftiu, tha se porositë e Pejgamberit a.s. duhet të ndiqen për shkak se ai është shembulli më i mirë.



U PËRURUA XHAMIA E RE NË VETERNIK TË PRISHTINËS

Më 6 tetor 2023, besimtarë të shumtë, imamë dhe përfaqësuesit më të lartë të Bashkësisë Islame morën pjesë në përurimin e xhamisë në Veternik.

Xhamia në hyrje të kryeqytetit përveç se do t'i përmbushë kërkesat e besimtarëve, do të jetë edhe simbol i Prishtinës. Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë tha se përveç faljes së namazeve, kjo xhami do ta zbukurojë Prishtinën. Kjo ditë u vlerësua e veçantë për gjithë besimtarët për shkak se një xhami e tillë ka qenë e domosdoshme. Myftiu Tërnavë mbajti edhe hytben xhumasë, ku foli për rëndësinë e ndërtimit të xhamive. Kjo xhami kishte filluar ndërtimin vite më parë, ndërsa, tash e 5 vite falen namazet në të.



U PËRURUA XHAMIA "MEDINA" NË PRISHTINË

Më 13 tetor 2023, është inaugurua xhamia "Medina", në Prishtinë, aty ku familja Stublla dhuroi tokën dhe ishte kyçe në ndërtimin e xhamisë. Në përurimin e kësaj xhamie morën pjesë besimtarë të shumtë, imamë, por edhe përfaqësues lokal të KBI-së.

Myftiu Naim ef. Tërnavë, u shpreh jashtëzakonisht i lumtur që besimtarët me vetë iniciativë kanë ndërtuar një xhami të tillë.

Nga familja Stublla falënderuan edhe bizneset dhe familjet e tjera që participuan në ndërtimin e kësaj xhamie, gjë që sipas tyre dëshmon nevojën dhe dashurinë e madhe për ndërtimin e kësaj xhamie.

Hytben e parë të xhumasë në këtë xhami e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili përmendi rëndësinë e ndërtimit të xhamive si dhe përçoi mesazhe për unitet, solidaritet dhe harmoni mes njëri-tjetrit.



U MBAJT MANIFESTIM ME RASTIN E MUAJIT TË MEVLUDIT

Më 9 tetor 2023, për nder të muajit të Mevludit, KBI në Ferizaj, organizoi manifestim të Mevludit. Në këtë manifestim ligjërator kryesore e mbajti Myftiu Naim ef. Tërnava, ndërsa mysafir special ishte reisi i Bashkësisë Fetare Islame, Shaqir ef. Fetahu.

Programi filloi me leximin e disa pjesëve nga Kurani fisnik, të cilat i këndoi Armend ef. Beqiri.

Më pas një fjalë përshëndetëse para të pranishmëve e mbajti kryetari i Këshillit të BI-së së Ferizajt, Nexhmedin ef. Bajrami.

Këtë manifestim e përshëndeti edhe reisi i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili thase kujtimi i personalitetit të Muhamedit a.s. është tejet i nevojshëm për çdo kohë dhe çdo vend. Ai tha se Muhamedi a.s. është shembulli më i mirë që duhet ndjekur dhe kjo është dëshmuar edhe nga bota mbarë.

Në ligjëratën e tij kushtuar Pejgamberit Muhamed a.s., Myftiu Tërnava, ndër të tjera veçoi domosdoshmërinë e kujtimit të lindjes dhe jetës së Pejgamberit a.s. për besimtarët e këtyre



trojeve. “Ne si myslimanë duhet të jemi shumë krenarë që i përkasim kësaj feje, e cila është e plotë dhe e përsosur.”

“Muhamedi a.s. është një shembull që ne asnjëherë nuk duhet t'i largohemi mësimëve të tij, ai na ka mësuar se si të sillemi me familjen dhe me shoqërinë në përgjithësi. Ardhjen e tij, Allahu xh.sh. e kishte paralajmëruar edhe në librat e tjerë të zbritur te pejgamberët e tjerë.”

Myftiu Tërnava duke folur për dërgimin e Pejgamberit a.s. nga ana e Zotit, tha se ai ishte dhe mbetet mëshirë për të gjitha botët dhe për mbarë krijesat.

Më pas programi vazhdoi me këndimin e disa pjesëve nga Kurani nga hafëzi Mujdin ef. Limani, me këndimin e disa pjesëve nga Mevludi, të kënduara nga imami Adem ef. Hoxha, si dhe me këndimin e ilahive nga Armend Beqiri, Miraxh Islami dhe Artioli Behluli.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSDREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË VAKËFIT TË DIJANETIT

Më 11 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim zëvendës-drejtorin e Përgjithshëm të Vakëfit të Dijanetit të Turqisë, z. Mehmet Eginç, i cili shoqërohej nga atasheu për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë, z. Bunjamin Albayrak.

Myftiu Tërnava fillimisht i uroi z. Eginç mirëseardhje në Bashkësinë Islame të Kosovës, e më pas e njohu atë me veprimtarinë e këtij institucioni, me theks të veçantë për veprimtarinë në fushën humanitare, për çka e falënderoi mysafirin për kontributin e vazhdueshëm të Dijanetit të Turqisë dhe të organizatave të ndryshme turke, të cilat në vazhdimësi kanë ndihmuar vendin tonë sa herë që është kërkuar një gjë e tillë. Ai nuk la pa përmendur edhe



financimin e ndërtimit të Xhamisë Qendrore, si projektin më të madh deri më tani, i cili është duke u realizuar nga Vakëfi i Dijanetit të Turqisë. Myftiu Tërnava shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, që të vazhdojë edhe në të ardhmen bashkëpunimi i mirë ndërmjet BIK-ut dhe Dijanetit.

Nga ana e tij, zëvendës-drejtori Eginç, falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen, duke shprehur kështu interesimin dhe gatishmërinë që të vazhdohet edhe më tutje bashkëpunimi me institucionin e BIK-ut dhe ndihmesa në fusha të ndryshme.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË GJILANIT, Z. ALBAN HYSENIN

Më 11 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Komunës së Gjilanit, z. Alban Hysenin.

Temë kryesore e këtij takimi ishte bashkëpunimi ndërmjet institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, më konkretisht Këshillit të BI-së së Gjilanit dhe Komunës së Gjilanit, që udhëhiqet nga z. Hyseni, e të cilin Myftiu Tërnavë e falënderoi për gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve infra-



strukturore të qytetarëve të Gjilanit në përgjithësi. Myftiu Tërnavë tha se ne, si institucion, jemi përherë të

gatshëm që të kemi bashkëpunim të mirëfilltë me të gjithë kryetarët e komunave pa dallim.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË GRUP IMAMËSH NGA MYFTINIA E BERATIT

Më 11 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një grup imamësh nga Myftinia e Beratit, të cilët udhëhiqeshin nga zëvendësmyftiu i Beratit, Bilbil ef. Talla. Në shoqëri të tyre ishte edhe aktivisti e autori i njohur, Burhanudin ef. Fili.

Myftiu Tërnavë i njohu imamët e Beratit me aktivitetet e institucionit të Bashkësisë Islame, si dhe me rolin dhe kontributin që ka ky institucion në mbarëvajtjen e jetës fetare në Kosovë. Ai tha se si institucion kemi një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me të gjitha institucionet e



vendit, por edhe me institucionet simotra në Shqipëri dhe Maqedoni. Ai i inkurajoi imamët që të vazhdojnë kontributin e tyre për mirëqenien e besimtarëve, duke theksuar se këtë e kemi amanet nga i Madhi Zot.

Nga ana e tyre, në emër të Myftinisë së Beratit, zëvendësmyftiu Talla, e falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, si dhe më pas e njohu atë me veprimtarinë e Myftinisë dhe për aktivitetet që zhvillon ajo.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA DREJTORI I ORGANIZATËS “QATAR CHARITY”

Më 12 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, u prit në takim nga drejtori i organizatës “Qatar Charity”, z. Esam Dabab.

Në këtë takim Myftiu Tërnavë e njohu nikoqirin me punën dhe angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame në fusha të ndryshme, e në veçanti me punën humanitare të Shoqatës Humanitare Bamiërse “Bereqeti”, e cila funksionon në kuadër të BIK-ut,



dhe e cila, sot në forma të ndryshme është pranë çdo familjeje nevojtare.

Nga ana e tij, drejtori Esam Dabab, falënderoi Myftiun Tërnavë për punën dhe bashkëpunimin e mirë që kanë dy institucionet, duke shprehur kështu

dëshirën dhe vullnetin për të thelluar edhe më bashkëpunimin në fusha të ndryshme.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe infrastruktura e objekteve fetare në vend, e për të cilat organizata “Qatar

Charity” vazhdon të jetë aktive në këtë drejtim. Bashkësia Islame e Kosovës dhe “Qatar Charity” bashkëpunojnë ndërmjet vete në çështjet humanitare, në ndërtimin e xhamive dhe projekte të tjera me rëndësi.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ATASHEUN PËR ÇËSHTJE ARSIMORE PRANË AMBASADËS SË TURQISË, Z. SERAFETTIN TURAN

Më 13 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim lamtumirës atasheun për Çështje Arsimore pranë Ambasadës së Turqisë në Kosovë, z. Serafettin Turan.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që edhe në këtë takim lamtumirës ta falënderoi z. Turan dhe nëpërmes tij gjithë shtetin e Turqisë për përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë për Kosovën në procese të ndryshme, e në veçanti e falënderoi atë për kontributin e tij dhe të Ambasadës së Turqisë të dhënë në fushën e arsimit, me theks të veçantë ndihmat që janë dhënë për institucionet e arsimit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Medresenë “Alaud-din” dhe Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Myftiu Tërnavë me këtë rast, i uroi shëndet dhe punë të suksesshme në misionet dhe punët e ardhshme në të cilat angazhohet.



Nga ana e tij, z. Turan, falënderoi Myftiun Tërnavë për bashkëpunimin e mirë të deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me Ambasadën e Turqisë, duke shprehur kështu kënaqësinë e tij që ka pasur rastin të bashkëpunojë me të. Ai tha se një

bashkëpunim i tillë duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë, i ndau z. Turan një mirënjohje në shenjë kontributi për punën dhe angazhimin e tij si atashe për Çështje Arsimore.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË FERIZAJT, Z. AGIM ALIU

Më 18 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin në fusha të ndryshme ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës, më konkretisht të Këshillit të BI-së së Ferizajt dhe Komunës së Ferizajt, për çka Myftiu Tërnavë e falënderoi me këtë rast kryetarin Aliu për gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që të kontribuojnë në këtë drejtim.

Kryetari Aliu tha se si institucion do të jemi përherë në gatishmëri që të jemi së bashku në projekte të ndryshme me interes për qytetarët e vendit në



përgjithësi, e në veçanti për qytetarët e komunës të cilën ai e udhëheq.

U KONSTITUA KUVENDI I RI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS



Më 21 tetor 2023, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e tij konstituive, me ç'rast u konstitua me sukses Kuvendi i ri në përbërje prej 31 anëtarëve të ri. Delegatët e ri të posa certifikuar propozuan për kryetar të Kuvendit, Ajni Sinani dhe Jashar Salihun, si dhe për nënkryetar, Rrahim Aliun dhe Jetish Berishën. Me anë të votave të fshehta, kryetar i Kuvendit të Bashkësisë të Kosovës u

zgjodh Ajni Sinani, ndërsa nënkryetar Rrahim Aliu.

Anëtarët e komisioneve të Kuvendit të BIK-ut u zgjodhën:

- Komisioni Administrativo-juridik: Kujtim Bislimaj, Vehbi Shatri, Ajhan Begiri dhe Enes Goga – rezervë.
- Komisioni Fetaro-arsimor: Sead Kelmendi, Iljaz Mustafa, Jashar Salihu dhe Besnik Arifi – rezervë.

- Komisioni për parashpresa dhe ankesa: Idriz Xhigoli, Burim Arifi, Xhafer Ahmeti dhe Blerim Musliu – rezervë.
- Komisioni Financiar: Nehmedin Dernjani, Xhafer Fejziu, Smajl Mustafa dhe Eset Qerimi – rezervë.
- Komisioni Kushtetues: Haki Hoxha, Islam Cakaj, Jetish Berisha, Fadil Idrizi, Lulëzim Kastrati dhe Abedin Osmani – rezervë.



KRYETARI I VUSHTRRISË, Z. FERIT IDRIZI UROI MYFTIUN TËRNAVA



Më 25 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizin.

Në këtë takim u diskutua për bashkëpunimin e mirë që ka Bashkësia Islame e Kosovës, më konkretisht Këshilli i BI-së së Vushtrrisë me

Komunën e Vushtrrisë, e cila udhëhiqet nga z. Idrizi, për çka Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin e Komunës për gatishmërinë e tij që të jetë pranë kërkesave të qytetarëve të Vushtrrisë.

Ndërkaq, kryetari Idrizi, fillimisht uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij edhe për një mandat në krye të

Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme, e me këtë rast, edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të Komunës që ai e udhëheq për një bashkëpunim të mirë me institucionin e BIK-ut, në mënyrë që të jetë gjithnjë në shërbim të qytetarëve.

KRYETARI I PRISHTINËS, Z. PËRPARIM RAMA UROI MYFTIUN TËRNAVA



Më 27 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, i cili shoqërohej nga nënkryetari Alban Zogaj.

Kryetari Rama shfrytëzoi rastin që të uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij edhe për një mandat në krye të

Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai tha se Komuna e Prishtinës mbetet e përkushtuar që të vazhdojë bashkëpunimin e mirë që ka me Bashkësinë Islame të Kosovës.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, ndër të tjera falënderoi kryetarin Rama dhe nënkryetarin Zogaj për urimet e tyre,

duke rikonfirmuar kështu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që të kontribuojnë për qytetarët e këtij vendi, duke shtuar dhe duke vazhduar bashkëpunimin e mirë që ka me të gjithë kryetarët e komunave pa dallim, në funksion të realizimit të kërkesave të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të besimtarëve të vendit.

MYFTIU TËRNAVA TAKOI KOORDINATORËT E SHOQATËS “BEREQETI”



Më 27 tetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, takoi koordinatoret e Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, e cila vepron në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Gjatë këtij takimi Myftiu Tërnavë, përgëzoi koordinatoret për punën e bërë, mirëpo kërkoi të angazhohen

edhe më shumë që të jenë pranë secilës familje nevojtare në çdo cep të Kosovës që ka nevojë për dorën e “Bereqetit”. Veç të tjerash, gjatë këtij takimi u diskutua për projektet e tjera që synojnë të jenë në shërbim të familjeve nevojtare.

Nga ana e tyre koordinatoret e “Bereqetit” të cilët i përfaqësojnë të gjithë Këshillat e BI-së në teritorin e

Kosovës, shfrytëzuan rastin që të urojnë Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij edhe për një mandat në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ata falënderuan Myftiun Tërnavë për përkrahjen e vazhdueshme që çdoherë u ka dhënë në iniciativat dhe projektet e tyre.

REAGIM

Dënojmë ashpër sulmin terrorist, i cili ndodhi mëngjesin e sotëm në Ankara të Turqisë. Në këto momente, Bashkësia Islame e Kosovës dhe populli i Kosovës mbështet dhe solidarizohet me popullin vëlla turk dhe me Qeverinë e Turqisë. Lusim Zotin e Madhëruar që policët e plagosur në këtë sulm të gjejnë shërim sa më të shpejtë!

*Prishtinë, më 1 tetor 2023
Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë*



REAGIM

Jam i tmerruar e i trishtuar pas lajmit për bombardimin dhe granatimin e spitalit në Gaza, ku humbën jetën qindra qytetarë të pambrojtur e të pafajshëm, gra, fëmijë, të sëmurë dhe të plagosur.

Dënojmë në formën më të ashpër këtë veprim, i cili është krim kundër njerëzimit. Ftoj botën demokratike e qytetëruese, që të ndërmarrë hapa e të veprojnë me shpejtësi në parandalimin e një kasaphaneje në Gaza, për të cilën do të jemi përgjegjës që të gjithë.

Duhet gjetur mundësitë e premisat për ndaljen e luftimeve, kthimin në dialog e marrëveshje, si dhe rrugën për jetë në paqe e qetësi për të dy popujt.

Të ndalojmë dhunën, të parandalojmë holokaustin e ri!

*Prishtinë, më 18 tetor 2023
Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë*



TAKIMET E DREJTORIT TË DREJTORISË SË DIASPORËS, EKREM EF. SIMNICËS

Më 23 tetor 2023, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim kryetarin e Bashkësisë Islame Shqiptare në Suedi, z. Armend Hasanin.

Drejtori Simnica e njohu z. Hasani me aktivitetet e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë me aktivitetet që zhvillon Drejtoria e Diasporës. Nga ana e tij, kryetari Hasani e njohu drejtorin Simnica me aktivitetet që zhvillon Qendra e tyre, por edhe qendrat e tjera që janë nën ombrellën e saj. Ai përmes drejtorit Simnica uroi për rizgjedhjen e Myftiut Tërnavë edhe për një mandat në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme.

Ndërkaq, më 26 tetor 2023, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim imamin dhe themeluesin e Qendrës Islame në Solothurn të Zvicrës, z. Ekrem Raqipi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e mirë që ka Drejtoria e Diasporës me qendrat islame në tërë diasporën, si dhe për mundësitë e thellimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE “FETVAJA DHE SFIDAT E MIJËVJEÇARIT TË TRETË”



Më 18 dhe 19 tetor 2023, në Kajro të Egjiptit, u mbajt Konferenca Ndërkombëtare “Fetva dhe Sfidat e Mijëvjeçarit të Tretë”, e organizuar nën përkujdesjen e Sekretariatit të Përgjithshëm të Institucioneve dhe Organeve të Fetvasë në Botë dhe nën patronazhin e presidentit të Republikës së Egjiptit, Abdel Fattah el-Sisi.

Në edicionin e saj të tetë, morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga

organizata ndërkombëtare, ministra, ambasadorë, shtetarë dhe myfti të lartë nga njëqind vende të botës. Konferenca përfaqëson një pikënisje të rëndësishme për diskutimin e mekanizmave për përballimin e sfidave të mijëvjeçarit të tretë në të gjitha nivelet dhe fushat, si dhe mëton të shpjegojë rëndësinë së fetvasë në këtë drejtim, duke marrë parasysh plotësimin e nevojave të individëve, sidomos me sfidat me të cilat përballet bota.

Konferenca filloi punimet nën hijen e zhvillimeve të fundit në Palestinë, ku të pranishmit dënuan dhunën e ditëve të fundit në ato vende, e në veçanti sulmin mbi spitalin në Gaza, i cili shkaktoi viktima civile të shumta.

Në këtë Konferencë, në emër të Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, Bashkësinë Islame të Kosovës po e përfaqëson shefi i kabinetit të Myftiut, mr. Besim ef. Mehmeti.

DEPARTAMENTI I GRUAS SHËNOI MUAJIN E MEVLUDIT ME AKTIVITETE TË NDRYSHME

Departamenti i Gruas i Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur një cikël të ligjëratave për nder të muajit të Mevludit-ditëlindjes së Muhamedit a.s.. Temat e ligjëruara ishin: “Profeti, alejhi selam si prind”; “Profeti, alejhi selam në raport me shokët e tij”; “Mëshira dhe butësia e Profetit a.s.”; “Morali i Profetit a.s.”; “Pozita e Profetit a.s. në Kuran”; “Profeti a.s. dhe gratë e tij”; “Profeti a.s. dhe trajtimi i gruas”

Qëllimi i të gjitha këtyre ligjëratave ishte që të përkujtohet figura më e dashur e Zotit, Muhamedi a.s., i cili ishte dhe mbetet shembulli më i mirë për njerëzimin në të gjitha aspektet e jetës.

“Çdo njeri i suksesshëm në këtë botë, ka pasur edhe cilësi jo të mira, ndërsa kur flasim për Pejgamberin a.s., nuk mund të themi të njëjtën gjë, ngase ai u dallua nga të gjithë njerëzit me çdo cilësi të mirë” – tha ndër të tjera në një nga ligjëratat znj. Vaxhide Bunjaku.

“Pejgamberi a.s. ka qenë i suksesshëm dhe i mirë fillimisht me Zotin e tij, pastaj me familjen e tij, e pastaj edhe me shoqërinë dhe njerëzit përreth, e jo e kundërta siç po ndodh me disa sot, të cilët janë të mirë me shoqërinë e me të tjerët,

mirëpo nuk janë të mirë me Zotin e familjen e tij” – tha ndër të tjera në një nga ligjëratat znj. Florentina Tërmmkolli.

Përveç ligjëratës kryesore, në këtë organizim janë shfaqur edhe pika artistike si: poezi, ilahi, monologë, recitale, e punime të ndryshme të përgatitura nga nxënësit që ndjekin mësim-besimin në xhamitë e vendit. Komunitat në të cilat janë mbajtur këto aktivitete ishin: Prishtina, Prizreni, Podujeva, Gjilani, Shtime, Dragashi, Rahoveci, Malisheva e Fushë Kosova.

Organizimi kryesor është mbajtur në Prishtinë, në Medresenë “Alauddin”, në bashkëpunim me Fakultetin e Studimeve Islame dhe Medresesë “Alauddin”.

Ligjëratën kryesore e mbajti dr. Violetë Smajlaj, kurse me fjalë rasti u paraqitën udhëheqësja e DG-së, Vaxhide Bunjaku dhe profesoresha e FSI-së, Besa Ismaili. Programi u shoqërua me këndimin e salavateve, pjesëve nga Kurani, poezive, ilahive e monologëve.

Me këto aktivitete, Departamenti i Gruas, përmbylli ciklin e ligjëratave për nder të muajit të Mevludit.



BIOGRAFIA E MYFTIUT, NAIM EF. TËRNAVA



Naim Tërnavë lindi më 7 janar 1961, në fshatin Lismir të Komunës së Fushë Kosovës. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, kurse të mesmen Medresenë “Alaudin” në Prishtinë, më 1978/79.

Studimet i mbaroi më 1984, në Universitetin “Al-Azhar” të Kajros, në drejtimin “Usuluddin” (Apolojetikë dhe Filozofi islame), kurse studimet postdiplomike në Universitetin e Hapur Amerikan të Kajros, më 2003.

Gjatë viteve 1984-1995, shërbeu si imam në xhaminë e fshatit të tij të lindjes, në Lismir.

Në vitin 1985 u emërua pedagog i lëndës së Akaidit, dhe më pastaj edhe i Filozofisë islame, në Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë. Ndërsa, për dy mandate (1995-2003), ishte drejtor i Medresesë “Alaudin”.

Nga viti akademik 1994/95 deri në vitin 2019/20 ligjëroi lëndën e Akaidit dhe Filozofisë islame në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Nga fillimi i viteve të ‘90-ta ka ushtruar shumë detyra dhe funksione me rëndësi, në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Për dy mandate (1990-1998) ka qenë anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës 1998/99, ishte kryetar i Këshillit të Emergjencës së BIK-ut, njëherësh edhe anëtar i Kryesisë së Këshillit Republikan për Ndihmë Emergjente (KRNE).

Për tre mandate ka qenë anëtarë i Redaksisë së revistës “Dituria Islame”.

Një mandat (1999 - 2003) ka qenë kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Më 2003 zgjidhet kryetar dhe Myfti i Bashkësisë Islame të Kosovës. Në këtë detyrë është rizgjedhur edhe më 2008, 2013, 2018 dhe tani, më 2023.

Më 2005 është zgjedhur nënkryetar i Këshillit të Lartë Islamik për Evropë dhe Azi, me seli në Stamboll.

Qendra Mbretërore për Studime dhe Hulumtime Islame me seli në Aman, për dymbëdhjetë vjet rresht (2009-2022) e ka përzgjedhur në mesin e 500 personaliteteve më me ndikim në Botën Islame.

Më 2015 zgjedhet anëtar i Sekretariatit të Lartë të Botës Islame për Fetva, me seli në Kajro.

Ka marrë pjesë në shumë konferenca, seminare, kongrese, simpoziume e forume, brenda dhe jashtë Kosovës.

Për kontributin e tij në shumë fusha, i janë ndarë mirënjohje e çmime nga organizata, institucione dhe forume të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Është autor i disa veprave dhe monografive nga shkenca e akaidit dhe filozofisë islame. Po ashtu është autor i shumë punimeve e kontributeve shkencore e kulturore, të botuara në periodikun e vendit dhe jashtë tij.

BIOGRAFIA E KRYETARIT TË KUVENDIT TË BIK-UT, AJNI EF. SINANI



Ajni Sinani lindi më 13 nëntor 1962, në Zaplluxhe të Dragashit. Ka mbaruar

studimet në Universitetin Islam “Al Azhar” të Kajros, Fakultetin e Studimeve Islame dhe Arabe, në vitin 1998. Ka magjistruar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Prishtinës për të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, më 27 mars 2009, kurse ka doktoruar në vitin 2016.

Ka punuar për shtatë vjet në Shqipëri dhe ka ligjëruar të Drejtën Islame (fikh) dhe Gjuhën Arabe në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” të Shkodrës (Shqipëri). Ka drejtuar më shumë se 100 emisione të titulluara “Karvani” në televizionin “Besa” të Prizrenit (Kosovë). Ka qenë redaktor i gazetës “Besa”, Prizren, gjithashtu bashkëpunëtor i revistës “Paqja”, Prishtinë. Ndërsa për tri mandate ka

qenë edhe kryeredaktor i revistës “Dituria Islame” që botohet nga Bashkësia Islame e Kosovës.

Ai tashmë ligjëron dhe është profesor i rregullt në Fakultetin e Studimeve Islame të Prishtinës. Është autori i tre librave në gjuhën shqipe. Ka përkthyer disa libra në gjuhën shqipe. Është autor i shumë shkrimeve në gazeta vendore dhe në të huaja. Ka recensuar mbi 30 libra. Në vitin 1994 në Kajro ka mbikëqyrur ribotimin e përkthimit të Kuranit të Shenjtë në gjuhën shqipe dhe atë boshnjake. Po ashtu ka marrë pjesë në shumë konferenca e simpoziume në Kosovë dhe jashtë.

SHQIPËRI, O JETËGJATË,
TY TË KEMI MËMË E ATË
DHE PËR TY DO TË LUFTOJMË
GJERSA TË TË TRASHËGOJMË

Naim Frasheri



DITURIA ISLAME • Nr. 396 Nëntor 2023